

Intervistë në portalin më të madh gjerman për kulturën, Kultur-Port.De, më 23 janar 2023, me rastin e botimin në gjuhën gjermane të romanit "Secili çmendet sipas mënyrës së vet"

## STEFAN ÇAPALIKU: Si një pasqyrë gazmore e komunizmit absurd dhe tragjik

Intervistoi prof. Dagmar Reichardt



EPISODI I SHTATË:

## KRONIKË DHE ETNOGRAFI NË SHKRIMTARINË E ARTUR SPANJOLLIT

Nga Dr. Fabio M. Rocchi

Shkrimtaria e Artur Spanjollit, aktiv që nga fillimi i viteve 2000 dhe autor produktiv i romaneve në gjuhën italiane, duket se kurrë nuk është larguar realisht nga vendlindja. Në shumë raste, zëri i saj ka gjetur një vendbanim natyral në një hapësirë të banuar nga disa arketipe të së shkuarës shqiptare dhe atje është ndalur, thuajse donte t'i sodiste, sikur e vetmja mundësi për ta rikthyer në jetë atë të kaluar të ishte nëpërmjet rrëfimit nga afër duke përdorur një ekspertizë prej reporteri.

### KUNDRIME DHE SHËNIME RRETH PROZËS SË SHKRIMTARIT YLLJET ALIÇKA

Nga Akademik Gjovalin Shkurtaj

### LETËRSIA SHQIPE NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT NË KAJRO

(fq. 16)



(fq. 12)

### SHËNIME MBI LIBRAT

#### RIZBULIMI STUDIMOR I VEPRËS SË HAFIZ ALI KORÇËS

Nga Sali Bashota

(fq. 4)

Shënime për poemën e Skënder Buçpapës  
"Vetëm të vdekurit pendohen"

#### PËRMASAT E PËRGJËRIMEVE

Nga Arben Kallamata

(fq. 5)

Romani "Alpinisti" i autorit Eqrem Basha

#### LUFTA ME VETVETEN SI PJESË E RRUGËTIMIT

Nga Halim Halimi

(fq. 7)

#### FATI INDIVIDUAL, SI FAT KOLEKTIV NË VEPRËN "LUM LUMI" TË ALI PODRIMJES

Nga Arbër Malota

(fq. 10)

#### KOHA DHE "SHENJAT" ARTISTIKE TË FAIK BALLANCËS

Vrojtime nga Xhahid Bushati

(fq. 8)

### AMELIA ROSSELLI Tërë bota është e ve

Përgatiti dhe përktheu Arben Dedja

(fq. 18)

Në vitet nëntëdhjetë boton "Diario ottuso", libri i saj i vetëm në prozë (përveç studimeve), një prozë tejet e zymtë dhe eksperimentale. Mania e persekutimit e ndoqi tërë jetën (në fund të viteve tetëdhjetë, për shembull, i kërkoi stehim politik Gorbaçovit), deri atë 11 shkurt fatal të vitit 1996.

Fragmente nga libri i këngëtares së famshme

### Celine Dion JETA IME SI NJË ËNDËRR

Përktheu nga anglishtja Afërdita Cesula



(fq. 22)

### BIBLIOTEKË

Shkëlqim Çela

(fq. 14)

Shtegu apalash

Robert Hayden

(fq. 20)

O Dedalus, Fluturo Drejt Shtëpisë  
(Përktheu Gëzim Basha)

Neviana Shehi

(fq. 19)

Dy tregime

Vlora Ademi

(fq. 21)

Katërdhetë e pak

Botim i ri nga Minerva

### ETHAN KROSS

Zëri në kokën tonë: Pse është i rëndësishëm  
dhe si të përfitojmë prej tij?

(fq. 15)

### ZIAUDIN KODRA PËR LETËRSINË ARBËRESHE

Nga Ymer Çiraku

Ziaudin Kodra (1909-1965) është nga studiuesit e njohur të letërsisë arbëreshe në Shqipëri. Sidomos për një farë kohe, pikërisht në vitet e para të pas luftës, ai do të jetë më aktiv në studimin dhe përcjelljen e vlerave të saj.

(fq. 6)

*Si do ta përmbledhni ose karakterizoni përmbajtjen, zhanrin (ose formatin) dhe mesazhin (d.m.th. qëllimin) – veçanërisht në një kuptim global, filozofik dhe/ose ndërkulturor – të romanit tuaj “Secili çmendet simbas mënyrës së vet” për ata që nuk e kanë lexuar ende ose për ata që do donin ende ta lexonin? Për çfarë bëhet fjalë? Dhe pse një lexues i ri duhet ta lexojë absolutisht këtë libër tuajin?*

“Secili çmendet simbas mënyrës së vet” nuk është një roman i artikuluar në mënyrë akademike, ai është më shumë një belbëzim në pikëpamje të ligjërimit letrar. Është belbëzimi i një fëmije (unë) që përpiqet të tregojë kujtimet e një fëmijërie të gëzueshme në tragjizmin e vet.

Në tekstin original në gjuhën shqipe romani nuk ka asnjë folje. Rri pezull një gjendje jovepruese. Ngjan me një cikël fotografish. Fotoqrafoj veten, më pas nënën, me pas dajën, mandej rojet, mandej burgun. Kjo është kujtesa ime e parë. Burgu. Burgu i kujtesës.

Më pas romani fillon të bëjë zoom out dhe të përfshijë brenda vetes më shumë informacione vizive, më shumë njerëz, më shumë lëndë. Bëhet veprues. Po rritem.

Por sigurisht që jeta të ofron përpara situata nga më mediokret apo nga më interesantet, qofshin këto edhe dramatike, për të mos thënë tragjike. Unë e konsideroj veten me fat që nisa të ndërroj gjësohem si njeri kur në mjedisin, atje ku linda, ndodhën njëra pas tjetrës dy ngjarje të çuditshme: 1. Autoritetet komuniste vendosën ta shpallin Shqipërinë vend ateist dhe nisën të shkatërronin kisha dhe xhamia (Kumbanarja e kishës franceskane, që kishim ngjitur me shtëpinë u rrëzua), 2. Im atë solli nga jashtë shteti televizorin e parë në mëhallë.

Këto dy ngjarje e ndajnë romanin tim në tri pjesë: “Para” (ardhjes së televizorit), “Gjatë” (kohës kur mund të shikonim kanalet e huaja televizive) dhe “Mbas” (Ndalimit të valëve nga autoritet komuniste).

Televizori propozon një estetikë të re, që ka të bëjë me mënyrën sesi përthyeret globalja te lokalja apo me mënyrën sesi interpretohen ngjarjet e mëdha botërore në një provincë, siç qe Shkodra, qyteti im i asaj kohe.

Mendoj se romani veç tjerave është edhe një pasqyrë gazmore e komunizmit absurd dhe tragjik.

*Me rastin e prezantimit të përkthimit në gjermanisht të romanit “Secili çmendet simbas mënyrës së vet” në Buchhändlerkeller në Berlin më 17. 03. 2022 thatë se “Jeta është më magjike se arti”. Çfarë ka kaq “magjike” në Shqipëri? Apo cila është “magjia” e Shqipërisë?*

Unë, që kam lindur dhe jam rritur në kohën e komunizmit dhe që po jetoj tranzicionin e stërzgatur dhe absurd, po ju them se ndjehem me fat. Si shkrimtar nuk ka dhuratë më të madhe sesa të jetosh nënjë epokë interesante. Prandaj jam ndër ata që besoj se jeta është ku e ku më përpara letërsisë dhe arteve të tjera. Vecanërisht në këtë vend të vogël, që quhet Shqipëri, jeta ka prodhuar dhe vazhdon të prodhojë shumë histori. Histori pa fund. Dhe kur themi histori, këtu te ne, më së shumti

*Intervistë në portalin më të madh gjerman për kulturën, Kultur-Port.De, më 23 janar 2023, me rastin e botimit në gjuhën gjermane të romanit “Secili çmendet sipas mënyrës së vet”*

## STEFAN ÇAPALIKU: Si një pasqyrë gazmore e komunizmit absurd dhe tragjik

*Intervistoi prof. Dagmar Reichardt*

kuptohen dramat jetësore. Shqipëria është një vend që mund të përkufizohet ose nëpërmjet përdorimit të lidhëzave kundërshtuese “as kështu e as ashtu” ose nëpërmjet lidhëzave bashkënduese “edhe kështu, edhe ashtu”. Kjo gjendje e ndërmjetme: as Lindje dhe as Përrëndim, edhe Lindje edhe Përrëndim; edhe vend malor, edhe bregdetar; edhe popull blegtor, por edhe bujk; edhe musliman edhe i krishterë; me një gjuhë që nuk është as latine e as greke, as sllave e as anglosaksone; e të tjera antinomi si këto e bëjnë atë një burim të pashtershëm “çudishë”...

*Romani, i strukturuar në tre pjesë*

*(“para”, “gjatë” dhe “pas”), përfundon me kapitullin e 21-të të pjesës së tretë, kur Gjoni - xhaxhai i rrëfimtari të ri, që ishte verbuar kur familja kishte blerë televizorin, një mjet informimi dhe argëtimi i futur në Shqipëri rreth vitit 1967, duket se ishte “çmendur”. Çfarë lidhje ka çmenduria me historinë e Shqipërisë dhe në çfarë kuptimi e përcakton epokën postmoderne, edhe pas vitit 1985, vit në të cilin përfundon romani juaj?*

Në fakt unë dua të dëshmoj se koha ishte e çmendur. Njerëzit normal raportoheshin me këtë kohë në mënyra nga më të çuditshmet për të siguruar mbijetesën, në përpjekje për të ruajtur



edhe dinjitetin. Jam përpjekur t'i qasem një kategori personazhesh që përbënin kulturën e undergroundit. Personazhet e mi përgjithësisht janë ato që gjithë jetën kanë ndenjur me mutëra, por nuk i vjen era.

Mjafton besoj të përmend disa raste për ta kuptuar më mirë procesin e kësaj “çmendurie simbas mënyrës së vet”: Kemi në roman poetin Zef Zorba përshebull, i cili bën teatër në shtëpinë e tij, në prani të 5-6 spektatorëve dhe vë në skenë kryevepra të letërsisë botërore. A nuk tingëllon ky si i “çmendur” në sy të njerëzve “normalë”?! Apo mund të përmend rastin e Nuh Sahatcisë, që ia ruan sahatin e dorës atij ushtarit gjerman edhe kur lufta kishte mbaruar dhe dukej sikur gjithcka kishte marrë fund.

Viti 1985 është vendosur si terminal sepse është viti kur vdes Enver Hoxha, diktatori i përgjakshëm, njeriu që kishte ideuar një Shqipëri asisioji.

*Çfarë ju magjeps nga fotografia? Cila është lidhja midis fotografisë dhe shkrimit? Si do ta kontekstualizoni realitetin në këtë trekëndësh mes letërsisë dhe artit fotografik? Çfarë është për ju “realiteti” dhe si mund të “rrëfëhet”, veçanërisht në media dhe formatet e ndryshme artistike? Duke qenë se ju jeni një artist që ndërthur shumë disiplina të ndryshme kulturore - një “jack i të gjitha zanateve” apo gjithë-artistik, jeni marrë me kanale të ndryshme të komunikimit kulturor nga letërsia te fotografia dhe piktura, por edhe teatri dhe argëtimi: çfarë funksioni kanë mediat në riprodhimin e realitetit? Në “Secili çmendet simbas mënyrës së vet” cili është kuptimi i medias, televizionit? Në epokën trans-postmoderne dhe dixhitale, sipas jush, në cilin drejtim po shkojmë?*

Unë jam tejet i lidhur me fotografinë dhe kam lindur në qytetin ku zë fill fotografia shqiptare, që më 1856. Aso kohe një djalosh italian i quajtur Pietro Marubbi vjen në Shqipëri së bashku me dhomën e tij të fshehtë (camera obscura) dhe nis të fotoqrafojë gjithcka. Prej atij momenti e mbrapa fotografia kthehet në një medium të cmueshëm. Kësisoj edhe tani.

Mendoj se zor të ketë pasë një kohë më të përshtatshme sesa karantina kolektive, për shkak të covid-19, për t'u marrë me albumet fotografike, e sidomos me ato foto, që për një arësye a një tjetër, nuk kanë qenë pjesë e albumeve. Në ato caste kam kuptuar më mirë sesi funksionon memorja personale në sferën



kulturore dhe si lidhet kujtesa personale ose individuale me format e përbashkëta të kujtesës.

Shqyrtimi i kujtesës me anë të fotografive ofron një rrugë veçanërisht produktive për të kuptuar aspektet sociale dhe kulturore të epokës sonë. Pra ekziston një histori e joshjes së letërsisë nga fotografia.

Siç dihet emri “Fotografi” vjen nga greqishtja prej fjalës dritë dhe laps, që së bashku krijojnë kuptimin “vizatim me dritë”. Mandej, është ende e paqartë, se pse në shumë gjuhë të reja hyri me kuptimin “dritëshkronjë”. Në këtë pagëzim të dytë ajo anoi më shumë te ngjashmëria me shkrimin. Këtë ngjashmëri me shkrimin do mund ta lexojmë edhe si afinitet me letërsinë.

Riprodhimi i realitetit sipas procedurave fotografike, përbën një dëshmi të rëndësishmëmbi natyrën, jetën dhe vdekjen, ndërkohë që në shoqërinë tonë vihet re një amnezi e përgjithshme. Mirëpo sado e trishtë të ketë qenë e shkuara ajo prapëseprapë është e jona. Ka ndodhur dje dhe “dje” është një ëndërr që nuk do të kthehet më.

Ajo që unë me dëshpërim vë re është se në rrafshin global po zbatohet një projekt famëkeq i rithemelimit të së shkuarës.

*Si është situata sot në Shqipëri pas diktaturës së Enver Hoxhës (1908-1985) dhe pas shembjes së ideologjisë komuniste? Si ka ndryshuar vendi juaj pas fëmijërisë suaj? Çfarë traumash ju është dashur të kapërceni në Shqipëri që nga viti 1990? Çfarë ka ndodhur me komunizmin në Shqipërinë e sotme: si është zhvilluar situata politike? Cilat ishin ndryshimet thelbësore? Çfarë efekti pati në kulturën shqiptare shembja e Murit të Berlinit? Dhe çfarë do të dëshironit të ndryshonit edhe sot në Shqipëri në nivel social, intelektual, kulturor etj.?*

Kjo pyetje në fakt përfshinë një koleksion problemesh, për sqarimin e të cilave nuk do mjaftonte një natë dimri. Por ajo cfarë shkurtazi mund të them është se ne jetojmë në ndryshim.

I ashtuquajtur “tranzicion politik shqiptar” ka krijuar një njeri të vetin: Një njeri ëndërrimtar, aventurier, të dëshpëruar, nervoz, vecanërisht nervoz, të paduruar dhe lumturisht të gënjyer. Është një njeri i dalë nga një sistem i tmerrshëm, që e kish mësuar të fliste ulët. Është njeriu i gjendur papritmas brenda një lirie të pamatë dhe absurde, ku mund të bësh çdo gjë dhe nuk ia del të bësh asgjë. Është ai që do të europeanizohet me çdo kusht. Është njeriu që përballon dy tranzicione njëherësh, atë biologjik dhe atë politik. Është njeriu që ka shkëmbyer rrugën më të mirë me rrugën më të shkurtër për të ardhur në Europë. Është njeriu i prerë në besë, i zhgënjyer, i fyer dhe i rrahur në thelbin e vet ekzistencial. Është djaloshi i therur në bark, gjatë një zënke idiote në një tavernë në cep të rrugicës, që vrapon, duke mbajtur zorrët në duar. Është ai që nuk do të vdesë, edhe pse askush nuk e pret te dera e spitalit.

*Duke qenë tashmë anëtare e Bashkimit Evropian (BE) që nga viti 2013, Kroacia është anëtare e Eurozonës dhe zonës Shengen nga 1 janari 2023. Pra, ndërsa tani në Kroaci ju tashmë paguani me euro, çfarë dinamike shihni sot në*



*gadishullin Ballkanik në përgjithësi dhe si është situata në Shqipëri, e cila është zyrtarisht kandidate për anëtarësim në BE që nga viti 2014? Në korrik 2022 BE filloi negociatat e pranimit të Shqipërisë: çfarë roli novator mund të luajë kultura për Evropën në të ardhmen e afërt? Si e shihni zhvillimin e Ballkanit në kuadër të një “Shqipërie të Re” – ndoshta së shpejti anëtare e BE-së – dhe çfarë i ofron kultura*

*shqiptare identitetit hibrid, transkulturor të Europës, i cili është “suspenduar” “midis “Kontinentit evropian, Rusisë dhe Lindjes së Afërt? Apo e shihni Shqipërinë të “fiksuar” në rolin e saj historik, mesdhetar si një koloni e lashtë greko-romake? Pra, cila është historia pas Shqipërisë “tuaj” përtej historisë kuazi-autobiografike, të cilën lexuesi mund ta zbulojë duke lexuar romanin tënd?*



Unë jam shkrimtar, dëshmitar i rrëzimit të sistemit komunist dhe i ndryshimeve të mëdha qofshin ato për mirë apo për keq. Jam njeriu që kam humbë durimin duke pritur hyrjen në Evropë.

E dua Evropën dhe jam gati të luftoj për të. (Kuptohet, jo me pushkë se jam pacifist dhe frikacak i madh ose frikacak dhe pacifist i shquar). Ndërkohë sa më shumë kam njohur Evropën aq më pak kam përbuzur orientin. Evropa është e dashura ime. Dhe ajo cfarë çmoj më shumë nga e dashura ime është Mesdheu, beli i saj. Jam mesdhetar. Dua detin, ullinjtë, muzikën, domatet, poezitë, ishujt, verën dhe lëkurën e nxirë prej diellit pingul.

Ndërkaq ajo që më shkakton problem në raportin politik me Evropën nuk është vendi im, përkundrazi, i falem nderit Zotit, që më ka lindur në një vend kësisoj me katër stinë dhe me këtë diversitet absolut natyror. Ajo që më shkakton problem disa herë është sjellja njerëzore. Është mënyra sesi njerëzit e nëpërkëmbin këtë dhuratë, sesi nuk e cmojnë, sesi e keqpërdorin, sesi dashurinë për të e shprehin në formë propagande dhe sesi nuk arrijnë realisht ta shikojnë veten në një perspektivë evropiane zhvillimi.

Por ne tashmë kemi një brez të ri të mrekullueshëm e të selitur ndër shkollat më të mira evropiane. Ne vazhdojmë të kemi të fortë familjen dhe ndjenjat e sakrificës absolute për të ardhmen e fëmijëve tanë. Fëmijët tanë janë integruar në Europë shumë kohë më parë sesa shteti shqiptar.

*7. Si e shihni ju, konkretisht, raportin mes kulturës ruse dhe shqiptare? A ka ndoshta një thënie proverbiale apo një shaka shqiptare që e pasqyron atë? Si mundet humori, ironia, sarkazma apo komika të ndihmojë që situata aktuale të jetë më e tretshme? Si lidhet gjendja shpirtërore me jetën tuaj të brendshme, psikikën dhe botëkuptimin tuaj?*

Unë vi nga kryeqyteti i humorit shqiptar. Jam autor i dy librave me barceleta: “Një antologji e vogël e jetës” dhe “Barceletat e komunizmit shqiptar” dhe vendosa t’i shkruaj këto libra, vecanërisht mbasiqë kuptova se e shkuara po na rrëshqiste si rëra nga gishtërinjtë.

Në lidhje me raportet e kulturës sonë me kulturën ruse po ju tregoj një barceletë, në fakt një batutë të vertetë, e thënë nga një ish bashkëqytetar i imi në fund të viteve ’50, kur Shqipëria vazhdonte të bënte pjesë në vendet satelite të ish Bashkimit Sovietik. Në ato vite varfëria qe e thellë. Kishim ende krizë buke. Ishte darkë dhe zotëria në fjalë po kthehej në shtëpi me një bukë misri që e kish prerë në mes, e kisha palosur dhe e kish futur ndën sjetull, si të qe fletore.

- Hë zoti Filip, prej nga po vini kështu?

- Nga kursi i rusishtes, - tha Filipi dhe tregoi bukën e trashë e të ftohtë që po ia conte fëmijëve.

Humori politik shqiptar është i jashtzakonshëm. Ne kemi prodhuar humor me shumicë dhe duhet thënë që në kohën e komunizmit njerëzit janë burgosën ngaqë nuk kanë mundur të rrinë pa treguar në publik një barceletë kundër regjimit.

Besoj se është interesante për

(Vijon në fq. 5)

## Hyrje

Studimet e sotme letrare, të cilat mbështeten në trajtimin e veprimtarisë së autorëve të panjohur për lexuesin, gjithsesi, janë të rëndësishme jo vetëm për qëllimin kryesor që kanë, por edhe për rezultatin shkencor që sjellin. Pa dyshim, vlera e tyre dëshmohet kur ato shkruhen për t'i funksionalizuar dhe karakterizuar dukuritë apo fenomenet letrare apo kur bëhen pikë referimi, pikërisht me cilësime dhe vlerësime të qëndrueshme dhe argumentuese kritike për autorë të veçantë, siç është rasti me monografinë letrare për Hafiz Ali Korçën.

Gjithsesi, shenjat e tilla, qoftë në konceptin studimor apo qoftë në metodën shkencore, janë të pranishme në veprën studimore “Hafiz Ali Korça, jeta dhe veprat” të Ismail Ahmedit, profesorit universitar, studiuesit, përkthyesit letrar, autorit të disa veprave në shqip dhe arabisht.

Për më tepër, këto shenja janë paraqitur dhe konkretizuar me përkushtim të rrallë nga studiuesi i kësaj monografie, në radhë të parë, duke sjellë pikëpamje interesante përbrenda sfondit të kritikës letrare, madje duke e zgjeruar dhe pasuruar vështrimin për njohjen dhe studimin e krijimtarisë së Hafiz Ali Korçës në përgjithësi.

Monografitë e tilla letrare i kanë përparësitë e tyre edhe me të dhënat bio-bibliografike, pastaj për të tërhequr vëmendjen për vlerën dhe rëndësinë e krijimtarisë së një autori, por edhe për ta njohur periudhën e zhvillimit të kulturës dhe letërsisë kombëtare.

## Monografia letrare: Karakterizime dhe konkretizime

Në kompletin e veprave prej tetë vëllimesh, të autorit Ismail Ahmedit, botuar nga Shtëpia Botuese “Logos-A” (Shkup, 2020), në mesin e shumë veprave të tjera që u përkasin llojeve dhe zhanreve të ndryshme letrare, shkencore dhe përkthimore, gjithsesi, shquhet studimi monografik për Hafiz Ali Korçën.

Projekti studimor i Ismail Ahmedit për ta trajtuar veprimtarinë e Hafiz Ali Korçës është realizuar me përkushtim, dije dhe invencion. Ky fakt, dëshmon për vlerën dhe rëndësinë që ka një studim i tillë për studimet letrare, sidomos kur trajtohet krijimtaria e një personaliteti për të cilin deri më tani ka njohuri të pakta apo kanë munguar studime të karakterit monografik.

Portreti atdhetar, letrar, iluminist, fetar etj., i Hafiz Ali Korçës, i realizuar përmes qasjes së Ismail Ahmedit krijon mundësinë e analizës, interpretimit dhe vlerësimit kritik, për t'i njohur idetë dhe pikëpamjet e Korçës, në njërin anë, si dhe për t'i trajtuar veprat e tij të shumta, në anën tjetër.

Hafiz Ali Korça veprimtar dhe krijues është trajtuar në studimin monografik të Ismail Ahmedit në shumë fusha: kontributi i tij në shërbim të atdheut, kontributi i tij në fushën e letërsisë, kontributi i tij për alfabetin e gjuhës shqipe; pastaj angazhimi në fushën e arsimit kombëtar dhe në arsimin fetar, por edhe në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare, në fushën e publicistikës etj.

Në pjesën e dytë të studimit monografik për veprën e Korçës, Ahmedit i funksionalizon kërkimet e tij në trajtimin e shëmbëlltyrës së Korçës në fushën arsimore dhe edukative, kryesisht në përpilimin e teksteve shkollore, pastaj të abetaresë, alfabetit arabisht, si dhe të gramatikës së parë të gjuhës arabe të botuar në shqip.

Duke i studiuar disa nga pikëpamjet më të rëndësishme të Hafiz Ali Korçës, autori i kësaj monografie, i artikulon idetë e tij kryesore në relacion me tekstin dhe kontekstin e çështjeve dhe problemeve të trajtuara. Një lexim dhe interpretim i tillë mbështetet në shumë të dhëna dhe fakte, të cilat përqendrohen përbrenda misionit dhe veprimtarisë së Korçës, aty ku vlerësohet kontributi i tij i veçantë arsimor, edukativ e fetar.

RIZBULIMI  
STUDIMORI I VEPRËS  
SË HAFIZ ALI KORÇËS

Nga Sali Bashota

## Analiza letrare dhe vlerësim kritik

Në kaptinën e parë të pjesës së tretë të veprës monografike për Hafiz Ali Korçën, studiuesi Ahmedit vë në dukje veçori dhe tipare të tematikës kombëtare, të ndërlidhura me veprën “Shtat ëndrat e Shqipërisë”. Këtu analizohet një vëllim poetik i veçantë i Hafiz Ali Korçës, siç është “Shtat ëndrat e Shqipërisë”, për të cilin kanë munguar deri më tani interpretime dhe vlerësime kritike.

Ahmedit bën një interpretim analitik, në njërin anë dhe një interpretim krahasimtar, në anën tjetër, duke e fuqizuar konceptin e tij shkrimor në evidentimin dhe në karakterizimin e poetikës së Korçës, të përbërësve ligjërime, në pikëshikim me poezinë romantike shqipe, pra me poetët: Naimi, Mjedja, Asdreni, Shiroka etj., për të shkuar më tutje në karakterizimin e veprës së Korçës, si vepër me rëndësi, letrare, kulturore dhe kombëtare.

Domethënia e vlerësimit kritik në analizën e poezive të Korçës, sikur e ndërton një komunikim letrar për një vepër të panjohur, duke e fuqizuar komponenten e

interpretimit përmes trajtimit të temës së atdheut. Studiuesi evidenton, karakterizon, sistemon dhe vlerëson çështje dhe probleme, por edhe fenomene dhe dukuri, të cilat janë të pranishme në poezinë e Korçës.

Gjithashtu, në fokus të interpretimit është edhe rrjedha historike, gjendja reale e kombit, konvergjenca kombëtare, por edhe veçoritë e sentimentalizmit dhe të romantizmit.

Më tutje, në kaptinën e dytë të kësaj pjese, trajtohet tematika islame në veprën letrare të Hafiz Ali Korçës, me një përqendrim te Mevludi, si dhe te prania e temës së Kur'anit në poemën “Jusufi me Zelihanë”. Studiuesi, Ismail Ahmedit ka arritur ta trajtojë më gjerësisht veprën letrare të Korçës, duke u mbështetur në rrafshet dhe dimensionet e ndryshme, kryesisht te motivet dhe temat e veprave me tematikë fetare, por edhe të veprave të caktuara letrare. Kështu, funksionalizohet komunikimi edhe me kultura të tjera, të cilat kanë ndikuar në formimin e personalitetit të Hafiz Ali Korçës.

Pjesa e katërt e veprës monografike për Hafiz Ali Korçën përfshin veprimtarinë



përkthyes nga letërsia persiane. Pra, ka të bëjë me veprimtarinë e Hafiz Ali Korçës si përkthyes, cili shquhet me përkthimin e veprave të letërsisë mesjetare persiane, siç është përkthimi i dy kryeveprave të letërsisë botërore: “Gjylistani A Trëndafilishta” e Sadi-ut dhe “Rubaijati, katroret” e Umer Khajamit.

Studiuesi, me analizën dhe interpretimin e tij kritik është përqendruar që t'i trajtojë veç e veç karakteristikat e përkthimit të këtyre dy veprave nga Korça, si dhe të merret me krahasime të modeleve të përkthimit të Korçës me përkthyes të tjerë, duke u nisur nga kriteret themelore për të mbërritur tek analiza mikrostrukture e teksteve të shqyrtuara. Kjo kaptinë, në të vërtetë, është një ndër pjesët më interesante që ka të bëjë me veprimtarinë përkthimore të Hafiz Ali Korçës.

Po kështu, veprimtaria e Hafiz Ali Korçës është e rëndësishme edhe në fushën e publicistikës. Edhe këtu shquhet kontributi i tij në paraqitjen dhe në sensibilizimin e ideve, në komentimin e tyre ashtu të ndërlidhura me primesën kombëtare e fetare, si dhe për lirinë e mendimit, por edhe për çështje të kulturës e të qytetërimit.


Monografia letrare e Ismail Ahmedit për Hafiz Ali Korçën shquhet edhe për koncepte të argumentuara teoriko-letrare, si dhe për trajtimin e vlerave metrike e ritmike të poezisë së Korçës. Studiuesi jep një pamje të veprimtarisë së përgjithshme të Korçës, duke filluar që nga akti i frymëzimit poetik i veprave të Korçës, pastaj te zgjedhja e motivit, akti i krijimit poetik, gjuha poetike, ritmi i poezisë, rima, metri, si dhe te struktura rrokjesore, figuracioni poetik etj.

## Përfundim

Vepra studimore me karakter monografik e Ismail Ahmedit, është sistemuar dhe funksionalizuar përmes kriterëve të qarta shkencore, të cilat dëshmojnë për një argumentim të qëndrueshëm të pikëpamjeve kritike. Kështu, në nivelin e artikullimit të ligjërit kritik portretizohet shëmbëlltyra e Korçës në disa rrafshet të interpretimit, si dhe zbërthehen çështje dhe fenomene, të cilat u përkasin rrethanave të caktuara kohore, ku veprimtaria e Korçës shquhet për veçantitë dhe botëpërjetimin e synimeve atdhetare. Në fakt, autoriteti i tij dëshmon për një personalitet që me jetën dhe veprën e tij është ndër të rrallët në letërsinë dhe kulturën shqipe.

Në anën tjetër, lënda e pasur që trajtohet, pastaj depërtimi në thelbin e motiveve dhe temave të veprave me karakter letrar e fetar, kodet e komunikimit, mesazhi i veprave etj., ofrojnë mundësinë për të njohur autorin, si dhe vlerën letrare dhe estetike të krijimtarisë së tij në përgjithësi.

Libri “Hafiz Ali Korça, jeta dhe veprat” e Ismail Ahmedit, pa dyshim, është një rizbulim studimor i veprës së Korçës. Në këtë mënyrë, historia, gjuha, identiteti, kultura, edukimi, religjioni etj., të cilat janë të pranishme në veprat e Korçës, në interpretimin të Ismail Ahmedit trajtohen dhe argumentohen me pasion të veçantë, duke dëshmuar vlerën dhe rëndësinë e kësaj monografie letrare.



(Shënime për poemën e Skënder Buçpapaj “Vetëm të vdekurit pendohen”)

## PËRMASAT E PËRGJËRIMEVE

Nga Arben Kallamata

Skënder Buçpapaj është nga ata poetë që shkruan sepse ka diçka për të thënë, gjen një mënyrë krejt origjinale për ta shprehur dhe e përcjell me gjuhë të pastër, të kthjellët e të bukur shqipe. Prandaj kur vihesh të lexosh poemën “Vetëm të vdekurit pendohen” e ke të vështirë ta ndalësh frymën pa mbërritur në faqen e fundit.

Dikush mund të hidhet të thotë që poemat janë forma paksa klasike shprehjeje dhe të vështira për t’u ndjekur nga lexuesi modern. Buçpapaj ta hedh poshtë menjëherë mendimin me zhdërvjelltësinë e të komunikimit, me bashkëkohësinë e ideve, me modernizmin e formës dhe të përmbajtjes (dhe me fjalën “modernizëm” nuk nënkuptoj aspak poza të një intelektualizmi artificial, por risi, origjinalitet).

Vetëm të Vdekurit Pendohen është konceptuar në thelb si përmbledhje bashkëbisedimesh me nënën, të cilat poeti i quan aq bukur “përgjërata”. Sikur vetëm këtu të ishte ndalur, libri për mua do të kishte qënë kryevepër për mënyrën fine dhe jashtëzakonisht prekëse me të cilën shprehet dashuria dhe dhimbja për nënën. Por poema e Buçpapaj zgjerohet pafund në hapësirë për të përfshirë jo vetëm personazhe, por edhe ngjarje, edhe histori, edhe fillosofi, edhe letërsi, edhe folklor, edhe kulturë. Me një fjalë, për të përfshirë gjerësisht jetë.

Skënderi ka aftësinë ta mbërthejë dhe ta tërheqë lexuesin në një gjithësi magjepsëse malesh të lartë e pyjesh të dendur, livadhesh të gjelbra, përrënsh të vrulshëm që kapërcehen me ura të ngushta mbi të cilat kalojnë njerëz me përmasa të jashtëzakonshme por gjithsesi reale. Lexuesi harron krejt që këta janë njerëzit përreth jetës së poetit, nëna, babai, daja, gjyshi, gjyshja, motrat, nusët e fshatit, sepse ata përzihen krejt natyrshëm në mënyrë fillosofike me Sokratin dhe Niçen, poetikisht me Lorkën, Ginsbergun, Rembonë, Eluarin; vizualisht me Dalinë që të përshëndet qysh në kopertinën e librit. Pastaj përzjehen me personazhe biblikë dhe epikë, që nga heronjtë e Homerit e deri te banorët e përhershëm të eposit të malësisë shqiptare.

Libri ka të vdekurin në titull, por është një klithmë poetiko-filosofoke për jetën, sepse Skënderi di t’i japë edhe jetës, edhe vdekjes përmasat e duhura hapësinore dhe kohore. Njerëzit që gjallojnë poemën janë po aq të vdekur sa edhe të gjallë, aq sa të duket sikur kufiri midis jetës dhe mosjetës nuk ka pikë rëndësie. Ata janë po aq në ëndërr sa edhe në realitet. Me ose pa vetëdije nga ana e poetit, kjo e bën poemën të tingëllojë krejtësisht universale, jashtë përmasave kohëzgjatëse të një jete njerëzore.

Dikur, tridhjetë-e-ca vjet të shkuara, kur punonim bashkë në redaksinë e gazetës “Drita”, kam pasur fatin të dëgjoj drejtpërdrejt përshkrimet e Skënderit për vendlindjen tij, kullotat malësisë, bjeshkët, barinjtë që kaheerë kapërcenin malet për t’i dimëruar bagëtitë në fushat e Gjakovës. Ishin rrëfime fantastike, që më janë ngulitur në mendje. Skënderi kishte aftësinë që mallin dhe admirimin e tij për malësinë e Tropojës të ta ngjiste edhe ty që e dëgjoje, por që s’kishte qënë asnjëherë atje. “Vetëm të vdekurit pendohen” është dëshmia se ai është poet i mirëfilltë, me aftësinë që mallin dhe admirimin e tij t’ia përçojë, t’ia ngjisë edhe lexuesit. Uroj që sa më shumë vetë të dijnë të përfitojnë nga kjo aftësi e tij. Jo vetëm që do të kënaqen, por edhe do të mësojnë shumë

(Vijon nga fq. 3)

shembull të përmend këtu një nga ato barceleta që shpotisin qëndrimin e sistemit të kaluar ndaj shkrimtarit. Një ditë një i burgosur politik shkon në bibliotekën e burgut për të marrë një titull dhe i thotë oficerit që kujdesej për librat:

-Më falni! A e keni librin...?

-Jo. Librin nuk e kemi, por kemi autorin, - i përgjigjet ai.

*Duke e krahasuar veten me komunitetet dhe diasporat e shqiptarëve në Itali, u befasova nga kohezioni social që ata demonstrojnë si brenda grupit të tyre lokal, ashtu edhe midis një grupi vendas dhe një mysafiri të përkohshëm shqiptar që vjen nga jashtë. Më bëri përshtypje fakti sesi shqiptarët ndihmojnë njëri-tjetrin. Ky esprit de corps apo ndjenja e përkatësisë reciproke të shqiptarëve në Itali shprehet edhe në dialektin e tyre, arbërisht: a e flisni? Është e lehtë për ta mësuar? Një botim tjetër i juaji i kushtohet piktorit Renzo Collura (1920-1989): si mund të ndihmojë arti për të mbijetuar në dhunën, mizoritë e luftës dhe jetës, duke krijuar, ndoshta, një realitet “të ri”?*

Më duket se ne shqiptarët bashkë me hungarezët jemi të vetmet popuj që kemi më shumë banorë jashtë kufinjve zyrtarë të shtetit se brenda tij. Pra ne, në Shqipëri, jemi një ishull me shqiptarë që laget rrotull nga një det me shqiptarë. Nëse në Shqipëri jetojnë rreth 3 milion shqiptarë etnikë dhe në Kosovë 2 milion të tjerë, rreth e rrotull gjenden edhe të paktën 5 milion të tjerë.

Në Italinë e jugut kemi diasporën tonë historike, të ikur që nga koha e okupacionit tirk mbi Shqipërinë, pra diku nga shekulli i XVI-XVII. Ato kanë ruajtur për mrekulli gjuhën, kostumet, këngët dhe gjithcka tjetër që përbën identitetin kulturor shqiptar. Shqiptarët ruajnë me fanatizëm të madh zakonet e mikpritjes dhe ritualet e besës. Besa është institucion primordial i shqiptarëve kudo që ndodhen.

Shembulli madh i kësaj ishte strehimi i më shumë se 25000 ushtarëve italianë gjatë Luftës së Dytë të mbetur në Shqipëri mbas kapitullimit. Me këtë moment është i lidhur edhe libri që ju citoni për piktorin sicilian të humbur nëpër Shqipëri, si dhe romani im “Mbyllur për pushime”.

Në të dy këto libra jam përpjekur ta shikoj historinë me sytë e humbësve, duke dhënë kështu një tjetër perspektivë të historisë dhe duke e bërë atë të mësojë nga letërsia.

*Romani juaj “Secili cmendet simbas mënyrës së vet” doli në Gjermani në fillim të vitit të kaluar. Çfarë eksperiencash keni pasë ndërkohë në Gjermani apo me publikun gjerman? Keni hasur ndonjë veçori në lidhje me tregun gjerman të librit apo keni ndonjë reagim befasues për librin tuaj nga publiku (cilat)? Kur keni qënë për herë të parë në jetën tuaj në zonën gjermanishtfolëse (ku)?*

Për herë të parë në Gjermani shkela në shkurt të vitit 1993. Udhëtova nga Praga për në Mynih. Kishte borë dhe gjithçka më dukej si një pemë e madhe e Vitit të Ri. Më kujtohej gjithashtu poema e madhe e Heinrich Heine “Ein Wintermärchen” që e kisha lexuar në universitet. Kontakti i dytë qe në vitin

1999 kur pashë për të parën herë Panairin e Librit në Frankfurt dhe më pastaj me Gjermaninë më ka lidhur shumë festivali ndërkombëtar i teatrit “Neuen stücke aus Europa” që zhvillohej fillimisht në Bon e pastaj në Wiesbaden. Ajo ishte një bienale e madhe e teatrit bashkëkohor evropian dhe unë isha i pranishëm nga viti 2000 deri më 2012, si patron për Shqipërinë. Në vitin 2010 në këtë festival u shfaq drama ime “Allegretto Albania” e cila u prit shumë mirë, vecanërisht nga Forumi i Kritikëve, që e rreshtuan atë të parën në klasifikim. Për këtë rast gazeta Frankfurter Allgemeinen, më 28.6.2010 do të shkruante: “Stefan Çapaliku schreibt eine absurde komische Parabel auf die postkommunistische Zeit in einem Landeie Albanien”.

Sa i takon romant tim në gjermanisht i falem nderit përkthyeses sime zonjës Zuzana Finger dhe botuesit “Transit” Verlag. Deri tani kam mbedhë fjalë të mira nga mjaft kritikë, si p.sh: “Anhand fein gezeichneter Figuren und mit oftmals ironisch-sarkastischem Duktus liefert er zugleich eine brillante Studie der politischen Verhältnisse und einer archaischen Familienstruktur, an der alle politischen Zwänge scheinbar abprallen.” (LifePR. Bonn, 03.02.2022)

*Cilat janë projektet tua të reja? Çfarë jeni duke shkruar në këtë moment? A është planifikuar një përkthim i ri në gjermanisht? Veprat tua në poezi dhe prozë, duke përfshirë shumë drama dhe gjithashtu ese akademike, janë përkthyer, përveç në gjermanisht, edhe në anglisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, polonisht, bullgarisht, serbisht, maqedonisht dhe turqisht: përkthimet janë në vazhdim niveli transnacional dhe në cilën gjuhë jeni më të lexuar jashtë Shqipërisë?*

Për momentin po mbaroj së shkruari romanin tim më të ri me titull “Thashethemet e mbasbukës”, një roman alternativ dhe eksperimental në të cilën përpiqem të bëj bashkë fotografinë me letërsinë (imago & verbum). Në gjermanisht Zuzane Finger po përkthen romanin tim të parafundit “Një ëngjëll veshë me frak”, i cili pritet të botohet nga i njëjti botues në Berlin,”Transit Verlag”. Ky roman gjithashtu është përkthyer edhe në frëngjisht dhe italisht. Shpresoj shumë të krijoj miqësi edhe më të thella dhe të sinqerta me lexuesin në gjermanisht.

Ju falenderoj shumë për këtë hapësirë që po më krijoni.

Interviewesja, Dagmar Reichard, është Profesoreshë e Studimeve Transkulturore dhe Industrisë së Medias në Departamentin e Sociologjisë në Akademinë Letoneze të Kulturës në Riga. Autore e mbi 300 vëllimeve dhe eseve akademike mbi studimet bashkëkohore italiane, studimet socio-kulturore dhe literaturën krahasuese. Çmimet: Medalja e XXV Certamen Ciceronianum Arpinas (2005), Çmimi Ndërkombëtar XXXIV Flaiano për Studimet Italiane (2007), Anëtare e jashtme e Institutit Mbretëror Hollandez të Romës (2015), Prix Erica (2020). Profesoreshë e ftuar në universitete të ndryshme në Gjermani, Austri dhe Itali. Anëtare e PEN International (Exil PEN - PEN Zentrum deutschsprachiger Autoren im Ausland).



Ziaudin Kodra (1909-1965) është nga studiuesit e njohur të letërsisë arbëreshe në Shqipëri. Sidomos për një farë kohe, pikërisht në vitet e para të pas luftës, ai do të jetë më aktiv në studimin dhe përcjelljen e vlerave të saj. Duhet kujtuar se kësaj kohe, ishte krijuar një boshllëk i ndjeshëm në këtë fushë të studimeve. Namik Ressuli, Karl Gurakuqi, Rosolin Petrotta e bashkë me ta Ernest Koliqi, me kontribute të shquara në studimin e letërsisë arbëreshe, për rrethana të njohura politike, ishin larguar përfundimisht nga Shqipëria dhe studimet e tyre mbi letërsinë dhe botën arbëreshe në përgjithësi, ata i vijuan suksesshëm në aulat universitare dhe mjediset arbëreshe në Itali. Kuptohet, duke lënë një boshllëk të ndjeshëm në Shqipëri, aq më tepër se këtu, do të ishte i ndaluar dhe i anatemuar qarkullimi i kontributit të tyre.

Kurse At Justin Rrota, ai që do të sillte për herë të parë në atdhe kopjet fotografike të origjinalit të veprës “Meshari” të Buzukut (1929), me studimet e tij të njohura edhe për autorët e hershëm arbëreshë si L. Matrënga, J. Variboba, vijonte të ishte në Shqipëri. Porse duhet kujtuar se tashmë, në vitet e një moshe të thyer, ai ishte tërhequr në Kuvendin e Fretënve Françeskanë, duke u marrë kryesisht me hulumtimin e çështjeve gjuhësore, deri kur ndërron jetë më 1964.

Pra, Z. Kodra, mund të thuhet se për një kohë, do të mbetej pothuaj ndër të vetmit, që u muar me studimin e kësaj letërsie, duke qënë autor i kapitujve të zgjeruar për letërsinë arbëreshe te vepra e njohur “Historia e letërsisë shqipe” (1959, I,II), si dhe i disa shkrimeve për De Radën, Santorin, Gavril Darën (i Riu) etj., të botuara këto në shtypin e kohës. Ndërkohë, duket se dora dorës, po vinte një radhë studiuesish të tjerë, që do ta rroknin në prerje të ndryshme historiografike studimin e kësaj letërsie si: Dh. S. Shuteriqi, J. Kastrati, K. Kodra, A. N. Berisha, Sh Sinani, A. Xhiku, N. Jorgaqi, E. Kabashi etj.

I ardhur nga zona e Dibrës së Madhe, si kishte mbaruar studimet në liceun e Korçës, Z. Kodra u diplomua për letërsi e filozofi në Firenze. Në vitet 1939-1944, për qëndrimin e tij antifashist, qëndroi si i internuar në Itali. Nuk na rezulton ndonjë e dhënë e shtjelluar biografike, por krahas njohjes së gjuhës e letërsisë italiane, në mjaft vitet e qëndrimit të tij në Itali, atje me siguri që do të ketë patur edhe kontakte me mjediset arbëreshe, prej nga i lindi edhe ai interesim dhe pasion i ngulët për ta njohur e studiuar atë.

Këto studime të autorit, vështuar nga sot, pas jo pak dekada vitesh, duhet kuptuar se ato mbartin vlera brenda kohës dhe kontekstit, kur ato u shkruan e u botuan, si dhe brenda metodës së zgjedhur dhe ndjekur prej tij. Pasi dihet se për letërsinë arbëreshe, nuk kanë rreshtur deri më sot studime të shumta nga një varg autorësh arbëreshë dhe shqiptarë, me këndvështrime gjithnjë e më të thella dhe me pikëvështrime të larmishme metodologjike. Kjo larmi studimore, doemos që lidhet me vet vlerat e shumëfishta, që vazhdon të sugjerojë kjo letërsi tejet sugjestionuese dhe me vlera pasuruese estetike e kulturologjike për letërsinë shqipe.

Në studimet e tij, krahas vlerave të tjera, ky studiues çmon rolin e rëndësishëm të folklorit në ngjizjen e letërsisë arbëreshe. Kjo krijimtari popullore, do të rezultonte të ishte shtrati i sigurt për të ruajtur në shekuj identitetin e këtij komuniteti. Dhe letërsia e krijuar në këto mjedise, gjeti te kjo krijimtari popullore jo vetëm një thesar të pasur identitar, por edhe tematik dhe estetik. Prandaj nuk është e

# ZIAUDIN KODRA PËR LETËRSINË ARBËRESHE

Nga Ymer Çiraku

rastësishme, që pothuaj tërë shkrimtarët arbëreshë, ishin edhe mbledhës të zellshëm të folklorit. Përmes tij, ata dëshmonin tërheqjen konstante ndaj vlerave identitare, si dhe gjenin rastin të projektonin manifestin letrar të artit të tyre.

Në vlerësim të këtij roli të folklorit në letërsinë arbëreshe, në vitin 1957, Z. Kodra botoi përmbledhjen “Poezija popullore arbëreshe”, me rreth 200 faqe. Siç shkruan autori në hyrje, ato krijime janë mbledhur dhe përshtatur e vënë në gjuhën e sotme shqipe prej tij. Vështuar sidomos prej kohëve të sotme, besoj se do të “kërciste” kjo rrugë e ndjekur për “përshtatje” në shqipen e sotme. Por duhet vënë re se autori, në fakt nuk ndërhyr në strukturën e teksteve, veçse kryesisht sa vendos fjalën gjegjëse të shqipes së sotme - ndaj atyre fjalëve që kanë kuptim tejet të ngushtë në variantin arbërisht. Pra, në tekste ka ndërhyrje nga aspekti kryesisht leksikor. Dhe për më tepër, i vendos përballë të dy variantet e teksteve, duke krijuar kështu mundësinë, që ato krijime të shijohen të pandara për lexuesin dhe njëkohësisht, pse jo, për të krijuar mundësinë e njohjes, ambientimit dhe pastaj edhe të aktivizimit dora dorës të leksikut arbëresh - në një rreth të interesuar folësish të shqipes. Autori nuk shënon se në cilat katunde arbëreshe janë mbledhur këto krijime, apo prej cilave dorëshkrime dhe botime, janë vjelur ato prej tij. Sigurisht, që do të ishte vlerë e shtuar për studiuesit e tjerë, përcjellja e këtij informacioni identifikues.

Duhet kujtuar se ndër arbëreshët, është një traditë e hershme ajo e mbledhjes, botimit dhe studimit të folklorit të atyre anëve, duke nisur qysh nga shek 17-të me autorë si N. Filja e më pas me Xh. Avati, V. Dorsa. Dh. Kamarda, J. De Rada, A. Santori, Z. Skiroi, G. Dara, Ll. Perrone dhe mjaft të tjerë, duke e vazhduar këtë traditë, deri në ditët e sotme.

Për të shijuar bukurinë e këtyre krijimeve popullore arbëreshe, po shënoj më poshtë në variante të shkurtuara 3 prej poezive lirike. E para, është ajo e titulluar “Mëkati i dashurisë”. Nga një anë është vajza që dëshiron të takojë djalin (trimin) e zemrës dhe nga ana tjetër nëna, që e pengon të bijën prej merakut që ka. Djali i thotë të dashurës që t’i bëjnë asaj “kurthin”, sikur ai del për gjah dhe vajza për ca shkarpa, e ata të mund që të takohen fare “rastësisht”, diku larg katundit.

...vasha më të dalur drita,  
Muar litarin dhe sëpatën  
Dolli atje lart përroit,  
Mënjëherë bashkë me trimin.  
Atje brodhën shumë a pak,  
Brodhën gjithë ditën e lume,  
Pastaj aty afër mbrëmjes  
Vasha u ngrit e mori malin  
E më bëri ca karthija,

Trimi mori fushave,  
E më vrau gjah të pasur,  
Kur u kthye në shpi në mbrëmje,  
Vashën e qortoi e jëma:  
-Bijë ç`që vonesa jote? -  
-Më zuri ferri këmbëzin -  
-Djegtë zjarri atë ferr -  
-Djegtë tij, mëma ime,  
Si deshe ti pjakun tënd,  
Unë dua trimin e ri.

Poezia e dytë popullore titullohet “Lëngimi i dashurisë”. Një i ri i molisur nga dashuria për vajzën, hiqte shpirt, duke u dergjur në shtrat. E ëma e tij, vendos atëhere që të niset tek shtëpia e së bukurës, për t’i dhënë lajmin për ç’hiqte biri i saj për të. Dhe vajza, gjithë helm e lë qëndisjen dhe me shportë në dorë, zbret në kopësjat dhe e mbush atë me degë ulliri, ullinj të zinj, ftonj të bardhë e mollë të ëmbla, vesh këmbishë e hollë të linjtë, brezin e argjendë, fundin e artë, këpucët e “mundashta” dhe, e mbështjellë nga poeti anonim me këtë dekor të harlisur “frutash” sensuale, niset drejt e në atë shtëpi:

...në shtëpi të të dashurit,  
Gjeti priftëra e jatronj,  
Priftëra që e psalnin,  
Gra të mbledhura për vajtim  
-O ju priftëra, bujarë,  
Rreshiti e ljemni të shkonj,  
Të shoh të sëmurmin,  
Çë ju duket se vdes -  
Trimit si i ra ndër veshë  
Ai zë si një muzikë,  
Ndër veshë e ndër zemrët,  
Mbi ata hapi sizit  
E më shikoi vashëzën  
Vasha sipër ju livar,  
Butë e daljë m`i folji trimit:  
-Trim se çë më do ka vasha,  
Njota vasha më të sjell,  
Trim, hidhu e ngru.  
Trimi tha: - Vashëz, u dua  
Se këtu të rri me mua,  
U të ljetin vashë parraisi  
Të më flaç e të më shikosh,  
Borë çë ftohën e shëron.

Pra, teksti mbyllet me një metaforë të formatit referencial mbi dashurinë. Ajo është ndërtuar kuptimisht në model kundërtshënës: “Borë çë ftohën e shëron”. Pra, ajo, dashuria, ndodh të jetë e bashkëshoqëruar njëherazi me efektet e haresë dhe vuajtjes, të dritës dhe territ, të lindjes dhe shkatërrimit, të kthjellësisë dhe marrëzisë, të rënies dhe triumfit. Duke ia mbërritur përmes kësaj rruge golgote, në ekuilibrin dhe paqen këndëllese mes të dashuruarve.

Në krijimin e tretë “Kënka e pjakut”, përcillet motivi i etjes së njeriut për ta ruajtur fort zjarrin e dashurisë edhe para sfidave të moshës. Është dilema tronditëse, e cila vjen qysh nga “Epi i Gilgameshit”



dhe nga tërë mitologjitë e qytetërimeve të lashta, për mos nginjien e njeriut me jetë e me dashuri. “Robi plakët kur do vet...”, kujton një këngë e njohur popullore, e dëgjuar aq shpesh edhe sot, që në fakt, më shumë se mosdorëzimin e njeriut para destinit biologjik, dëshmon në fakt, sado drojshëm, praninë e të kundërtës. Një temë e trajtuar aq mjeshtërisht kjo, edhe nga Kuteli, tek novela “E madhe është gjëma e mëkatit”. Këtij motivi i është avitur edhe Poeti i liqerit, Lasgushi, tek novela e tij provokuese mbi një dashuri aq të dëshiruar, të kërkuar e të realizuar ndritshëm e rrezikshëm njëherazi, ndaj limiteve njerëzore.

Në krijimin arbëresh, si në një aventurë baladeske kalorsiake, përshkruhet nisja e nëntë të rinjve që të gjenin nëntë vasha të bukura arbëreshe. Udhës i takon plaku (pjaku) dhe mes çudisë e shpotisë së të rinjve, dëshiron edhe ai që të shkojë me ta në kërkim të pasionit. Si ecën gjatë, ata mbërritën në qytet, ku morën vashat e zgjedhura. Sipas tekstit të këngës, “më e bardha e më e njoma, ajo plakut i takoi”. U nisën të dy për udhë e diku, qëndruan të pushojnë. Plakun e lodhur, e zuri gjumi dhe:

Vajza q`ish shumë` e zgjuar  
Nxuari skjep e kreut saj  
E i mbullti sizit;  
Zgjidhi brezin nka mesi  
E m`i ljidhi duarzit,  
Duarzit e këmbëzit  
Kur m`u zgjua pjaku,  
Vasha kish kapuar malj  
Atë majl e jatërin...

Pra, vasha e bukur dhe e mënçur, iku e kaptoi malin për te fati i saj. Dhe kur e pa veten ashtu plaku, aq i madh ishte dëshpërimi i tij, sa shkuli nga marrazi i braktisjes mjekrën e tij të bardhë dhe na u zbardhua tërë dheu (“zbardhulloi dhethi”). Dhe nga lotët që derdhi, erdh` e u shtua përroi, që rridhte aty pranë tij. Rapsodi apo bardi anonim, këtu ka ndërtuar një strukturë dramatike rrëfimore, të ndërthurrur me tone gazmore, qortimi dhe zhgënjimi, si dhe me figura stilistike të befta dhe sugjestionuese.

Prej letërsisë arbëreshe, një studiues i zellshëm si Z. Kodra, ka arritur të sjellë e dëshmojë kumtet shpirtërore të një komuniteti të larguar prej shekujsh nga toka e të parëve, por që e mbajtën përherë gjallë kujtimin e saj. Siç e ka theksuar Eqrem Çabej, në këtë letërsi, krahas ndikimeve prej lëvizjeve letrare vendase, atje ku u vendosën arbëreshët, është fort e dukshme dhe e pranishme vatra shqiptare, jeta e përditshme nëpër fusha e ara, nëpër bregore e vreshta, me skenat idilike ndaj kroit. Duke e marrë me vete këtë vatër, edhe kur vanë e jetuan nëpër qytetet e mëdha të Italisë.

**Odiseada e aplinistit**

Modalitetet e veprave kanonike në të vërtetë mirëfilli përbëjnë pamjen estetike dhe vlerën e identitetit esencial të letërsisë. Duke qenë ndryshe autorët qëndrojnë brenda letërsisë, duke qenë të njëjtë shuhen brenda letërsisë. Nevoja për heterogjenitet dhe individualitete unike krijuese të letërsisë, ka afirmuar përpjekjen dhe interesimin për të prodhuar letërsi inovative, por asnjëherë të shkëputur tërësisht me traditën e shkrimit në aspektin historik. Autori e matë vetën dhe e peshon në lidhjen e ngushtë që e krijon me traditën.

Romani “Alpinisti” i autorit Eqrem Basha, një vepër kanonike që zhvillon dhe integron dimensione specifike të jetës, shoqërisë, literaturës dhe mitit duke i shkrirë në koekzistencë për krijimin e një përmbajtjeje që shtreson një semantikë domethënëse e polivalente. Leximi i romanit ofron pamje dhe interpretime të ndryshme si vlerë e etabluar artistike e estetike në pikëpyetjet fundamentale që i shtron si probleme të natyrës filozofike/ekzistenciale e ontike të qenies në relacion me botën e realitetin.

Rëndësia e kuptimit të këtij romani ndërlihet ngusht me kuptimin dhe njohjen që ia bëjmë karakterit protagonistit të veprës, alpinistit. Alpinisti projektohet dhe modelohet si figurë bosht rreth të cilit dhe me të cilin zhvillohet dhe modifikohet tema dhe ngjarja e veprës. Në vazhden e këtij leximi duhet çmuar dhe afirmuar kuptimi objektiv i mundshëm i kësaj vepre. Kuptimi të cilin e nxjerrim e riaktualizojmë ose që është aktual dhe na flet e na mëson edhe sot, jo në mënyrë tendencioze por artistike e letrare.

Vepra në tërësi realizon veçori të shumta të cilat zhvillohen si ato stilistike, rrëfimore, semantike, estetike që paraqesin një tablo të tërësishme të romanit si zhvillim në planin strukturor/formal.

Gadamer pohonte se “çdo epokë duhet ta kuptojë një tekst të transmetuar në mënyrën e vet, sepse teksti është pjesë e gjithë traditës, për të cilën epoka ka interes objektiv, dhe në të cilën ajo kërkon të kuptojë vetveten”. Mbi këtë konstatim ne nënkuptojmë se Gadamer i interferohej teksteve dhe veprave të cilat kanë arritur të shndërrohen në vlera universale dhe koha e tyre është kohë zero. I flasin në çdo kohë dhe në çdo vend njeriut nga fillet e gjerë më sot. A posteriori ne veprën “Alpinisti” e cilësojmë si të tillë, ngaqë kur ne e marrim ta lexojmë ajo na ofron një kënaqësi estetike dhe na intrigon me semantikën e tekstit e cila ngrit pikëpyetje fundamentale, të cilat e kanë përcjellur dhe e përcjellin njeriun në vazhdimësi.

Modelimi i karakterit të alpinistit që përbën një interesim të madh për ne, bëhet me një kujdes dhe venerim të mirëmenduar duke i dhënë veçori e afinitete të një individi të kultivuar, racional dhe me një gjykim të mprehtë. Situata, gjendja shpirtrore dhe emocionale e tij, relacioni i tij me botë dhe realitetin është sfidë dhe rrugëtim me të cilin ballafaqohet çdo individ i shëndoshë brenda një shoqërie. Emërtimi ynë si odiseada e alpinistit na rikthen në fillet e literaturës me personazhin e Ulisit me të cilin krijon analogji çdo njeri në rrugëtimin e tij të gjatë e të mundimshëm, atë që e bëri Ulisi drejt Itakës. Parë në krahasim të këtyre dy protagonistëve për rrugëtimet e tyre të ndryshme specifikojmë pikat e afrive mes tyre; a do të duhet të jetë finok njeriu me patjetër për të arritur në cak? Apo realiteti i ri modern e bashkëkohorë e ka modifikuar një realitet të ri dhe alpinisti duhet të operojë me mekanizma tjerë?

Bota e jashtme është gjithmonë sfiduese dhe e mistershme, ajo duhet të njihet duhet të eksplorohet me dyshime, meditime që dërgojnë në shpjegime të caktuara konstante e relative. Bota e brendshme e alpinistit është e konstruktuar në mënyrë të detajshme, intuitive e meditative, të cilën e njohim kryesisht në sprovat ku ai lëvizë në rrugën e njohjes dhe në realizimin e ambicieve të veta.

**Romani “Alpinisti” i autorit Eqrem Basha**

# LUFTA ME VETVETEN SI PJESË E RRUGËTIMIT

*Nga Halim Halimi*

Vetmia është karakteristikë bazë e sjelljes dhe qëndrimit të personazhit që vjen si parim se; çdo gjë duhet menduar në vete, vjen nga vetja dhe vendoset në vete. Gjithçka që vjen e imponohet nga jashtë duhet të merret me rezervë, kontestohet dhe shpeshherë të refuzohet në mënyrë kategorike.

Realiteti me të cilën ballafaqohet alpinisti para nisjes së aventurës është manipulativ i vrazhdë i sajuar nga turma, opinionet e turmës, gjykimi i turmës, pengesat e vazhdueshme deri tek ato institucionale administrative. Këtë rezistencë të tyre të një realiteti ku e vërteta dhe e drejta manipulohet, për alpinistin duhej të menjanohej në dy mënyra, e para; me vetëdijen e qenies mbi të vërtetën dhe të drejtën që garanton rrugëtimin jashta çdo reference trilluese e dyta; refuzimi nëpërmjet ironisë dhe heshtjes si një maksimum e vjetër “*jeto dhe lëri të jetojnë*”, këto i japin mundësinë e zhvillimit dhe ecjes tutje. E gjitha kjo paraqet idenë e autorit se; turmat në mungesë të njohjes e të shpjeguarit krijojnë mite, dhe i mbrojnë me fanatizëm ato si në rastin e alpinistit i cili paraqet rrezikun e shpërbërjes të atij realiteti, andaj mundohen ti bëhen pengesë e nisjes drejt majës së mistershme.

Individi me formim dhe përvojë vetanake të urtisë, gjithmonë e thyen “*mitin e gënjeshtërs*” cilido që të jetë ai, me dijen, vetminë, guximin për të lëvizur drejt të panjohurës;

“*Vetëm do t'i qepej Vajzës dhe vetëm do të kullandriste atje kulmin e kësaj bote. Tek shkathësia dhe dinakëria e zhvirgërimit nuk donte dhe nuk do të kishte dëshmitarë*”. Ky kuptim na ndërlidhë me traditën e zbulimit dhe punës individuale të njeriut që ka qenë gjithmonë fryt i një studimi, vetmohimi për arritje të rezultateve të caktuara.

Kuptimi i aventurës së alpinistit mund të zhvendoset dhe shihet në dy pamje; rrugëtimi i njeriut drejt njohjes së vetvetës nëpërmjet sprovave dhe dhimbjes e cila është interne dhe mundimshme, dhe rrugëtim drejt arritjes së destinacionit jetësor që ia vendosim vetës. Për të dyja rastet rrugëtimi është i vështirë; rrugëtim që kërkon gjallërinë, aktivitetin dhe dinamikën.

Për secilën rrugë që e zgjedhim duhet pasur mjeshttrinë e saj, durimin dhe maturinë dhe zotësinë individuale:

“*Ndër mjeshtrit fanatikë vetmia ishte shkalla më e lartë e përkushtimit dhe e esnafërisë*”.

Ne nuk mund ta njohim botën pa bërë hapa drejt saj, në të cilën e masim vetën se sa peshojmë me këmbënguljen dhe vendosmërinë tonë; për alpinistin problematika më madhore ishin njerëzit dhe tejkalimi i paragjykimit të tyre, që nuk zgjat dorën për ndihmë por vetëm bën mjegull dhe tym për paqartësi dhe demoralizim.

Rrugëtimi sigurohet nga të kuptuarit dhe të gjykuarit e pastër se a duhet vazhduar a duhet hequr dorë; ngase mosdorzimi nuk është çdoherë profitabil kur nuk ka se çka të arrihet; Heidegger pohonte se “*të kuptuarit nuk është një aktivitet njerëzor autonom, a historik, por një ndërmjetës, përmes të cilit bota vjen tek njeriu i cili, në një farë kuptimi, karakterizon qenien e tij*”.

Vazhda e lëvizjes drejt majës e bënte alpinistin të mendoj gjëra nga më të ndryshmet duke e ditur që sado e vështirë të ishte rruga drejt majës ishte punë mes tij dhe shkëmbit, raport i konsideruar më i lehtë se me njerëzit. Ndaj vetëdija se këto vështirësi do i prodhonin kënaqësi dhe lumturi një ditë e mbushte me entuziazëm dhe forcë të vullnetit.

Lufta me vetvetën ishte pjesë e rrugëtim

që na dërgon drejt mohimit të natyrës së tij instiktive njerzore; të kureshtjes në depërtimin e mistershëm të Shkëmbit të Vashës, në krijimin e qetësisë shpirtrore, evitimi i ëndërrave, menaxhim i emocioneve të ndryshme e veçmas frikës.

Metafora më e madhe e romanit është përshkrimi i rrugës dhe emërtimi i shkëmbit, të cilën autori e emërton si; Shkëmbi i Vashës, me konstrukt e attribute të personalizimit të vashës së skalitur në gurë. Çdo detaj gjatë rrugëtimit të alpinistit na ngritë pikëpyetje të mëdha, se gjithmonë vendi i ngecjes së alpinistëve paraprak ishte në pjesë të caktuara të vashës, e kjo e prodhon simbolikën e vet, se ku ndalen njerzit kur duan të njohin dikë a diçka?! Portretimi i Shkëmbit të Vashës realizohet me gjitha tiparet fizike të vajzës. Njohja është gjithmonë vetëm dëshirë e kureshtje se alpinistët që donin të njihnin majën e shkëmbit ose dorëzoheshin në fillim ose aty nga mesi dhe koka gjithmonë mbetej mister që paraqitet me mjegullën. Kjo figurë flet dhe shtreson kuptime të pafundme konotative që variojnë në forma të ndryshme.

Profesionist e peng i vetvetes alpinisti ikën e bën hapa përpara, di që do e thyej një mit, di që po ecën mbi ambicie viganësh dhe i rezervuar para befasisë të rrugës nga ato të pritshmërive e deri tek ato spontanet që ndonjëherë devijojnë gjithçka.

Njeriu lidhet me atë që do dhe në mënyrë graduale të kohës ky pasion e pushton duke u bërë substancial për të e jetën e tij. Ajo që për dikë është kopallë, dikë e mban në jetë, konteksti shpjegon çdo ndjesi dhe qëndrim që ndjeket në jetë. Lidhja e alpinistit me alpinizmin dhe pushtimin e majës jepet me një finesë e kreativitet të naltë:

“*Nuk ndahet sukcesi me tjetrin, siç nuk ndahet as gruaja, as e dashura, maja pushtohet vetëm dhe vetëm një emër duhet të shënohet më në krye. Alpinizmi është arti më egoist dhe më egocentrik që ekziston. Aty do ta realizosh vetveten do të dëshmosh forcën dhe burrinë tënde. Nëse ke koqe, do të ecësh përpara, nëse s'ke, do të merresh me të tjera gjëra, do të endësh lart e poshtë jetën e varfër e të dështuar dhe do të arsyetohesh me interesa të vogla, banale dhe me një ushqim kllakë e të zaijtë*”.


Nëse nisemi nga ajo që pohonte Harold Bloom se “*kritika letrare nuk duhet të jetë edhe aq teorike porse eksperimentale dhe pragmatike*”, në citimin e fundit nga romani pasqyrohet dhe reflektohet një vendosshmëri dhe kurajo për lexuesin tejet pragmatike, kujt do t'i fliste më shumë ky fragment se njeriut bashkëkohor në sensin universal të shoqërisë së sotme. Me një optimizëm të theksuar e të mirëmenduar, autori lëvizë nga poshtë – lart, nga terri drejt dritës, drejt majës, drejt idealit jetësor.

Teoria ekzistencialiste mbi jetën se a mundet të zgjedhë njeriu për atë se çka duhet të jetë në jetë, modifikohet fund e krye në vepër që e përcjell si dyshim ekzistencial/ontik në kriza e ankthe që prodhojnë gjendje nga më të frikshmet e ballafaqimit të njeriut me vdekjen:

“*Për të pushtuar majën, duhet të mendosh njëherë vdekjen. Duhet ta kuptosh se jeta është një kartë cigareje, një fluskë sapuni, një fjalë goje, një bisht i hollë qelqi në gotën e brishtë që mban në dorë dhe që mund të ta thyejë para syve edhe një psherëtimë e papritur*”.

Rrjedha e gjithë gnosistit dhe e jetës jepet përmbledhurazi në një aventurë të rrezikshme të alpinistit që i flet shumë njeriut për caqet e tij në jetë, por mbi gjithë këtë tabor dhe gjithë këtë shtrirje të jetës në botë çka do të ngelet përtej saj, pyetja e madhe filozofike me pak fjalë e përmbyllë gjithë rrugëtimin e asaj që nuk shpjegohet dot. Se çka dhe çfarë pastaj pas gjithë kësaj ?

“*Ai vërtet ishte bërë mësymësi më i shkathët në pushtimin e të papushtueshmeve, por mësymjeve të tij dukej se po u afrohej kulmi. Një ditë do të vinte maja e majave dhe ai kësaj i ishte trembur*”.



Të jesh udhëtar – dhe shkrimtarët shpesh janë udhëtarë – do të thotë të të kujtohet gjithnjë njëkohëshmëria e ngjarjeve, në botën e vetvetes dhe në botën tjetër, të cilën e ke vizatuar. Një përgjigje e parë ndaj këtij perceptimi të dhëmbshëm mund të qëndrojë në atë që mund të themi: është çështje e ndjesisë, e kufijve të fuqisë sonë përfytyruese. Po ashtu do të mund të thuhej se nuk është e “natyrshme” që përherë t’ia kujtosh vetes se bota është e madhe. Se njera ndodh për aq kohë sa do të ndodhë tjetra. E saktë. Por, pikërisht për këtë na duhet *letërsia* – për të zgjeruar botën tonë.

SUSAN SONTAG,

Mënyra sesi hyn në fushën e letrave, në atë tempull të mllavdishëm, të mundimshëm, gjurmëlënës e fisnik, mbetet një nga rrugët më interesante, më të vështira e me shumë të panjohura për një krijues, ku në startin e tij zë fill A-ja. Po ç’është A-ja? Çelësi, Jetëshkrimi i Krijuesit. Kur flasim për Jetëshkrimin e Krijuesit, në mes të tjerave shenjojmë edhe laboratorin e tij krijues, edhe ‘të pathënat’ e tij...

Kështu, duke ndjekur tipologjinë e shkrimtarëve të talentuar, ndalojmë tek ato të pakët. Por... përsëri ecim, vazhdojmë të ecim... dhe ndalojmë tek ato edhe më të pakët, te ato që quhen fenomene letrare. Personalisht, këto të fundit, në vështrimin tim, i kam quajtur të dinjitetshmit. I tillë në letërsi hyri Migjeni i Madh, për të cilin Kuteli shkroi kështu: “Nuk kish aso kohe as 27 vjet... po ç’janë vjetët përpara talentit? Ç’janë vjetët përpara zjarrit që rreh së brendshmi? Ç’janë vjetët përpara një shpirti të madh? Asgjë! Dhe pikërisht kjo asgjë nuk e ndaloi Migjenin të jetë poet megjithëse ish i ri fort. Poet sepse e njomi penën jo me trajtat konvencionale të një arti konvencional, po në një tërësi të merranin e dhembjes së të gjithëve, për të mjerët e të mjeruarit, me një gjenezitetet e sulm të pa shoq.”<sup>1</sup>

Hyri Migjeni i Madh!

U deshën afërsisht 35 vjet, që po dinjitetshëm, pra, si fenomen letrar, të hynte Faik Ballanca me prozën e tij të magjishme e moderne. Ashtu si për Migjenin, edhe për Faik Ballancën, letrat shqipe ndjenë dhimbje, u kurrën e pësuan humbje. E zvogëlimi i hapësirave, është vdekjeprurës për artin letrar.

Po përmend disa nga titujt e librave të Faikut, për të kuptuar marrëdhëniet e tij me kohën që jetoi e pasjetoi, ndoshta për të kuptuar edhe kohën e shkrimtarit të vërtetë, që ai krijoi në lëndën artistike, si: “Rrëmbimi” (tregime, 1970), “Mbasditë të lagura” (tregime, 1971), “Katër orë larg shtëpisë” (novela, 1972), “Letra Anonime” (tregime e novela, 1973), “Pritësit e rrufeve” (tregime e novela, 1975), “Tregime të zgjedhura” (1976), si dhe disa botime pas vdekjes “Perëndia e shtëpisë” (1985), “Nomeja e largët” (roman, 1989), “Kënga e fundit e Marko Boçarit” (novelë, 2002), “Mbama pak pallton, çun” (tregime të zgjedhura, 2003), etj. Po t’i vërejmë me kujdes, këta tituj kanë një apo disa të përbashkëta mes tyre, ndonëse në aspektin formal autori bën komunikimin e parë me lexuesin. Në këto tituj nuk është e vështirë të dallosh edhe simbolikat e largësisë e të moskomunikimit, të cilat janë brengosëse e tronditëse, dëshpëruese e tragjike. E ndodhte në një kohë..., kur Faik Ballanca me talentin e tij fin përpiquej, lodhej, mendohej, stërmendohej dhe sillte mjeshtërisht rrëfime ngjarësh përmes subjektsh interesante, gdhendte personazhe deri në filigram me artin e tij magjik. E përsëris: magjik! Jo më kot poetja dhe studiuesja Dr. Mimoza Ahmeti ka një vështrim interesant e të panjohur për krijimtarinë e Ballancës, dhe në veçanti për romanin “Nomeja e largët”. Ajo shprehet: “E befasuar nga cilësia imazhiniste e gjenuine e prozës së Faik Ballancës,.... Këto imazhe të poetizuara të natyrës shqiptare, krijojnë ide rreth saj dhe na përsosin, duke na bërë më të ndjeshëm në mënyrën sesi e përthithim botën, vendin tonë ndaj të cilit jemi shpesh inertë.

Psikogjeografia është e përhapur në tërë lëndën e këtij autori, si diçka shumë e veçantë për letërsinë shqipe.”<sup>2</sup>

E ndodhte në një kohë..., kur Faik Ballanca me talentin e tij befasues u falte personazheve tok me shpirtin e krijimit edhe shpirtin e tij human. Sepse “Proza e Faik Ballancës, është kryesisht prozë e personazheve. Faik Ballancës i intereson më shumë personazhi se sa ngjarja. Atij i duket më e rëndësishme bota e brendshme, psikologjia dhe mënyra si personazhi e përjeton dhe e përballon problemin, intrigën se sa vetë problemi apo intriga. Personazhet janë ata që e bëjnë tregimin. Numri i personazheve në prozën e Faik Ballancës është i madh dhe përfshihen karaktere e tipa të ndryshëm që të mbeten në kujtesë për shumë kohë. Këto personazhe punojnë, vuajnë, qeshin, gabojnë, ëndërrojnë, shpifin, vrasin, vdesin ashtu si në jetën reale. Autori nuk i himnizon, por as nuk i paragjykon ato.”<sup>3</sup>

Te personazhet, shkrimtari Ballanca shpaloste dije, vetëdije e nënvetëdije nga bota e personazheve që lëviznin nëpër hapësirat e krijimeve të tij, duke shpërfaqur gjithashtu

1 Buzo, Nadire: Kuteli, kontributi i panjohur i shkrimtarit e kritikut të letërsisë, Rilindasi, suplement i Shqiptarja.com, 07.05.2017, f. 14.

2 Ahmeti, Dr. Mimoza: Peizazhet e qumështa të Faik Ballancës – psikogjeografi në art!, gazeta MAPO, e shtunë e diel 8 – 9 prill 2017, f. 21.

3 Qormemeti (Berisha), Bleta: Faik Ballanca, si e çoi në vetëvrasje plenumi famëkeq i vitit 1973, gazeta Nacional, e diel, 05.03.2017, f. 21.

# KOHA DHE “SHENJAT” ARTISTIKE TË FAIK BALLANCËS

*Vrojtime nga Xhahid Bushati*

natyra, karaktere, psikologji, dramë, etj. Kjo ndodhte në një kohë kur shkrimtari po gdhendte kohën e vet...Ky moment i rëndësishëm në procesin krijues të prozatorit Ballanca, më kujton një thënie të Balzakut: “Shkrimtari është... një kronikan i madh i konflikteve njerëzore.”<sup>4</sup> Thënie, që mendoj se i shkon për shtat krijimtarisë së Faik Ballancës. Krijimtari, ku “Surrealizmi poetik dhe kompozicioni piktoral i Faik Ballancës janë një ushqim shqisor i jashtëzakonshëm terapeutik, me frymëmarrjen e natyrës, pemët, shtazët, yjet, malet, hënën në rrokullimat dritore mes natës; me gra, burra, fëmijë, prej gjestesh e besimesh ende natyrale, por me një distancë të vetëmjaftueshme dallimi e përqendrimi drejt vetes, autoriteti i së cilës, vetja, frymëzon zbulimin.”<sup>5</sup>

Po ç’po ndodhte në të vërtetë me të dhe me hapësirat letrare e krijuese të tij?.. Jo më kot, një mjeshtër i tregimit shqiptar siç ishte Vath Koreshi thoshte kështu për Faik Ballancën (Në fakt, Mjeshtri fliste për Mjeshtrin...) “Jo rrallë më ndodh që, duke lexuar tregime të Faik Ballancës, më vjen zëri i tij gjithmonë i shtruar dhe i mbushur me magjinë e zemrës dhe mendjes së tij aq të mprehtë. Faiku ngjallet sa herë, sepse gjithmonë ne kemi nevojë të na plotësojë me diçka që na mungon. Kur jemi të padrejtë, ai na ofron ndershmërinë e tij, kur na tut jeta, ai na bën më të guximshëm. Ai di të na shtyjë gjithmonë që të bëhemi më shumë njerëz, më shumë shokë dhe më shumë të mençur. ... Sigurisht një shkrimtar i përmasave të tilla të shtyn të flasësh për shumë e shumë gjëra. Unë kisha për të bërë këtu një zbërthim të disa vlerave artistike të tregimeve të Faikut, po më rrëmben ideja se këto cilësi të shkrimtarit si talent, rrjedhin nga shumë cilësi të shkrimtarit si njeri.”<sup>6</sup>

E kujtoj dhe tani atë njeri njerëzor, që quhej Faik Ballanca.

4 Balzak, De Honore: Shkrimtari duhet të shtrojë dhe të zgjidhë probleme të rëndësishme, Zëri i rinisë, 21.07.1986, përgatiti: Thanas Mustaqi.

5 Ahmeti, Dr. Mimoza: Peizazhet e qumështa të Faik Ballancës – psikogjeografi në art!, gazeta MAPO, e shtunë e diel 8 – 9 prill 2017, f. 21.

6 Ballanca, Faik: “Mbama pak pallton, çun!” (tregime të zgjedhura), Toena, Tiranë, 2003; Mendime dhe vlerësime për veprën e shkrimtarit Faik Ballanca, f. 319.

## FAIK BALLANCA

### Nomeja e largët



OnufriRoman

E kam, si tani para syve ecjen e tij paksa të shpejtë, dobësinë e trupit e të fytyrës si fragment bringe e drame, sytë shprehës që fshehnin një buzëqeshje të lodhur. Shpesh më dukej sikur rendte drejt një humbëtie të pafat, e herë drejt një panteoni të mermertë lavdie, që sigurisht, krijues të rrallë e kanë këtë fat. Shpesh, Faiku i ngjante një muzgu të kaltër, i bukur në ardhje, por misterioz në vetvete dhe po ashtu në ikje. Ai (Faiku, - nënvizimi im Xh. B.) edhe... “Në qoftë se bënte një zgjedhje, në dukje edhe të pamundshme, s’dinte të kthehej prapa. Edhe kur nuk e arrinte, ruante thellë vetes inatin që një ditë do ta mposhte. Para së gjithash ai sfidonte vetveten. Natyrës së tij, që ishte treguar disi e kursyer në krahasim me dëshirat, ai i bënte sfidën e kalitjes fizike. Në mos e ndryshonte dot trupin imcak, të paktën ta bënte muskuloz.”<sup>7</sup>

Nuk e di pse ecjen e tij e kam krahasuar gjithnjë me ecjen e poetit Frederik Rreshpja. Gjithnjë e kam menduar këtë krahasim ecjeje, të këtyre dy njerëzve që mbartnin një botë të pasur, sepse e kishin realisht, në shpirt botën e pasur e të vyer. Kjo pasuri e rrallë me dimensione vlerash qe fatmirë për letërsinë shqipe, por qe fatkeqe, sepse u krijua dhe u zhvillua në një kohë me sundimin e një perandorie tragjike, dhe tragjikisht u përball me të shkrimtari. Tragjikisht u përball talenti i tij. Tragjizmi, ndaj krijuesve të vërtetë, ndaj atyre që ishin fenomene letrare, ishte aleati më i ngushtë e më besnik, më i “dashtuni” që metoda famëkeqe e realizmit socialist u ofronte këtyre fenomeneve.

Duke u kthyer vite më parë e, duke u ndalur e ecur edhe në vitet në vazhdim..., përftesat e mësipërme (që përmenda lidhur me metodën... dhe perandorinë...) nisën lëvizjen e tyre në kohë e në hapësirë, përgjatë kohës, e cila “lëvizte” dhe “jetonte” sa te krijuesi, aq dhe te antikrijuesi. Në imazhin tim, këto dy nocione u bënë herë të afërta, e herë të largëta, sa herë i kaloja pranë e sa herë më kalonte pranë, aty, te ndërtesa e Lidhjes së Shkrimtarëve, ku ishte dhe revista “Nëntori”, ku punonte si redaktor, e unë atëhere isha student dhe botoja vjershat e para te kjo revistë.

Më vonë, pas ca viteve, lexova romanin “Nomeja e largët” (1989, botimi i parë). Teksti i sapolexuar më dha një shumësi përshtypjesh e mbresash të pashlyeshme, shpesh të çuditëshme e befasuese. Më bënte përshtypje mënyra e rrëfimit, struktura e romanit, vizatimi i personazheve, konceptet estetike që reflektonin në vepër dhe e “qëndisnin” atë, etj., e etj. Më sillej ndërmend teksa ballafaqohesha me tekstin, tipi i një letërsie jokonformiste brenda letërsisë socrealiste. Dukuri e pakët, dritë e mision i shumëndërruar... (për at’kohë e realitet kohe...). Më bënin përshtypje disa raporte, si: tema e vdekjes si model letrar i shqipes, si çlirim nga jeta e personazhit, e vetë personazhit si humbje, e personazhit si flijim emancipues, etj., etj. Këtu, dua t’i jemi mirënjohës studiuesit Spiro Gjoni për analizën e thukët që i ka bërë kësaj vepre dhe krijimtarisë së tij letrare, në monografinë autoriale me titull: “Paradigmat e një një krijimtarie”, për të cilën studiuesja Prof. dr. Klara Kodra thotë: “... është një monografi e llojit integral që synon të rrokë tërë krijimtarinë e një shkrimtari dhe në fakt të një shkrimtari origjinal bashkëkohor për të cilin mungon një studim i plotë i nivelit shkencor”<sup>8</sup>.

Duke vazhduar bashkëbisedimin me këtë vepër, se si më dukej kjo “Nomeja e largët”, herë si një jehonë e afërt, herë si një jehonë e largët, eherë, herë, edhe si një tufë xixëllonjash që ndriçonin qiellin e një nate edhe kur ajo s’do. Nuk e di për kë, ‘kjo e afërt dhe e largët’?.. Për shkrimtarin, për lexuesin... për... Po pse koha reale kërkonte heshtjen e magjisë së krijimeve të Faikut?.. Sigurisht, ishte mënyra e saj për të krijuar një vdekje të heshtur, por që në të vërtetë ishte ajo që po heshtoej e sfidohej nga lavdia e letërsisë së vërtetë që bënte e krijonte talenti i Faik Ballancës, që realisht letërsia shqipe i kishte me pakicë.

Për romanin “Nomeja e largët”, të vetmin roman, rreth kohës së botimit, rreth kohës së shkrimtarit, rreth kohës së kohës, shkrimtari Teodor Laço rrëfen në këtë mënyrë: “Ndërkohë po mblidheshin re të zeza mbi atë që, edhe në ato ditë, ishte mundimi i tij më i madh dhe më i ëmbël krijues, romanin “Nomeja e largët”. Ishte një gjetje interesante që më parë ia kishin pritur mirë në novelën “Katër orë larg shtëpisë” dhe e kishin nxitur që ta bënte roman. Ai e ndiente se në një roman në dy kohë disi mungonte gjerësia dhe ngjyrimet e botës fshatare, prandaj bashkë me shokun e tij të ngushtë Pandeli Koçin, bënë ca inkursione në fshatrat e Tepelenës.

Kjo ndodhi në ato ditë kur kërkoheshin shembuj për të pranuar tezat mbi ndikimet e huaja. “Nomeja...” e Faikut u erdhi shumë për shtat drejtuesve të Shtëpisë Botuese për të provuar se dhe ata ishin të proekupuar për ndikimet liberale, pavarësisht se, meqë ishin sita e fundit, aty kishte më pak gjasa që të botoheshin vepra të gabuara. Fakti që autori i romanit qe një shkrimtar që punonte në Lidhje, ishte njëfarësoj goditje prapa krahëve për vetë Lidhjen. Drejtuesit e saj, meqë Faiku nuk ishte në Parti, vendosën që romani të diskutohej në organizatën profesionale, ku bënin pjesë të gjithë, dhe u ngarkua Kadareja, unë dhe shkrimtari i ri

7 Laço, Teodor: Një jetë e djegur si meteor, gaz. Panorama, 05.03.2016.

8 Kodra, Prof. dr. Klara: Ballanca një shkrimtar modern i shkatërruar nga diktatura, gaz. Nacional, 08.10.2017, f.22.

F. K., i emëruar në Lidhje para pak kohe. E lexuam shpejt, Kadareja u shpreh menjëherë: “Ç’gabime ka aty? Asnjë gabim nuk ka. Ata të Shtëpisë Botuese janë të shkrehur nga trutë. Shkruaje ti, meqë jemi të një mendimi, thuaji edhe F-së.” Dhe ashtu bëmë. Por F. donte të dilte me një recensë më vete. Meqë mendimi ynë ishte pozitiv dhe romani nuk kishte lajthitje ideore, u vendos të mos diskutohej fare dhe iu përcoll dërguesve. Faiku fluturonte. Por s’qe e thënë përfundimisht. Sepse vërtet Shtëpia Botuese u tërhoq nga akuzat e rënda ideore, por i dha autorit një përgjigjelesheli, për ta ripunuar veprën “thellë”, duke bërë edhe sugjerime skematike që kërkonin ndërhyrje, të cilat shmangnin linjën me origjinalin e romanit...”<sup>9</sup>

Më vonë, përsëri pas ca viteve, emri i Faik Ballancës do më shfaqej si një befasim i bukur, teksa më ra në duar libri me tregime të zgjedhura “Mbama pak pallton, çun!”. Botim i Botimeve Toena, Tiranë, 2013; zgjedhur e redaktuar nga Pandeli Koçi, i cili hap pas hapi të jetës, por edhe në atë të pasvdekjes, me shumë devocion e fisnikëri kërkoi, mblodhi e studioi krijimtarinë letrare të Faik Ballancës. Duke e njohur atë në thellësi e në gjerësi, me të drejtë ai thotë: “Fatmirësisht sot mund të pranojmë se pjesa dërrmuese e prozës së Faik Ballancës na paraqitet e freskët në thelbin e saj palcor. Ajo na flet me gjuhën e njeriut që e do njeriun dhe që mirësia i rrjedh nga shpirti nëpërmjet artit.”<sup>10</sup>

Përsëri parapëlqej t’i rikthehem nocionit **Kohë** si shenjë e si embleinë jetën e shkrimtarit Faik Ballanca. Ajo (Koha...) gjeti pasqyrim nërrëfimet e thjeshta, të qarta, tërheqëse, me plot të papritura të prozës së tij ngarkuar me jetë personazhesh, me dilema psikologjike, me konflikte shpesh të ashpër e tragjike. Duke u ndalur te kjo e fundit, disa personazhe tragjikë më kujtojnë tragjizmin e vetëautorit. Ky njëjtësim, sigurisht ka porcionet dhe raportet e veta, por ka edhe të përbashkëtën se jetojnë, ngaqë kanë jetën e autorit të fshehur mrekullisht e artistikisht brenda lëkurës së tyre. Dhe po ta kërkojmë burimin e gjejmë në “Falë talentit të lindur, intuitës artistike, ndjeshmërisë dhe syrit të mprehtë prej shkrimtari, Faik Ballanca arriti të na sjellë realitetin shqiptar të asaj kohe duke e prekur atë, duke e studiuar thellë dhe duke kuptuar anën më të fshehtë e më të bukur të gjërave. Faiku si krijues kishte aftësinë të zbulonte gjëra që për një sy të zakonshëm ishin të padukshme. Ndërtoi fabula dhe subjekte mbi ngjarje të thjeshta, të zakonshme e të përditshme, duke i transformuar në lëndë letrare për të na i sjellë pastaj si vepra artistike që lexohen me ëndje edhe sot.”<sup>11</sup>

Ndryshe nga shumë krijues, Faiku i takonte moshës së pranverës. Pse ishte i tillë, krijimet e para, si ato të prozës, ashtu edhe reportazhet, nisën udhën e tyre fillimisht në faqet e gazetës “Zëri i rinisë”. Që nga libri i parë me tregime me një titull ngacmues, kureshtar e provokues “Rrëmbimi”, e në vijimësi me libra të tjerë,deri sa pati jetë, (por edhe pas vdekjes), të ndjek mrekullia e të lexuarit nga befasitë e shkrimtarisë së autorit. Mendoj se në pemën e zhanreve të tregimit e të novelës së tij, ai ishte i mirëseardhur dhe ulej pa frikë si zogu i pranverës dhe po pa frikë, mund të ndërtonte një fole me gjelbërim pylli për të thurrur ëndrrat e së ardhshmes aty.

Faiku ishte një krijues tragjik. I tillë në të vërtetë?!.. Jo. Kohë pas kohe, ca njerëz e ca institucione të asaj kohe ia injektuan, me pa të drejtë, tragjizmin. Dhe... “Sa më shumë kalojnë vitet, aq më shumë më sugjestionon një prej tyre: humbja e sfidës, zhgënjimi prej disfatës. Ai ndoshta nuk e dinte çdo të thotë të dalësh i mundur nga një betejë që e përjeton dita-ditës si sfidën më të madhe të jetës. Kjo sfidë quhej: ‘Nomeja e largët’. Vini re se si në dy variantet novela “Katër orë larg shtëpisë” dhe “Nomeja e largët”, sikur ky terren i vështirë ishte largësia që duhej mposhtur. Sfida e romanit po ndeshej me një mur heshtjeje, dhe kjo ishte e rrezikshme. Sepse kjo ndodhte në klimën e ndëshkimeve për të ashtuquajturat ndikime të huaja. Ishte klima që të priste krahët dhe sado sfidant i lindur dhe kryeneç, as ai s’mund të fluturonte pa krahë.

Pas kësaj, jeta na ndau...

Dikush më tha se Lidhja kishte dhënë urdhër që asnjë të mos shkonte për ngushëllim dhe për varrim. Vetëvrasja dënohej nga Partia. I kërkova nënës së tij disa fletë të tregimit të pambaruar “Vdekja e Ukshinit”. Në faqen e fundit ishte një njollë gjaku. Aktin e fundit po e nënshkruante me tërheqjen e këmbëzës të tekes së re automatike. Gjuetia po bëhej pasioni i tij i fundit.”<sup>12</sup>

Faiku ishte një krijues tragjik (?!) Një tragjizëm i dyfishtë, që në krijimtarinë e tij shfaqej sa prozator, aq edhe poet, sa poet aq dhe prozator. Duke lexuar tregimin “Shushunjat”, një simbolikë e mbartur dhe e zhvilluar brenda një subjekti të thjeshtë të shfaqet mrekullisht. Por edhe një reflektim i një guximi krijues që përkon me fillimet e para letrare. Tregimi në fjalë është botuar në gazetën “Zëri i rinisë”. E

9 Laço, Teodor: Një jetë e djegur si meteor, gaz. Panorama, 05.03.2016.

10 Ballanca, Faik: Mbama pak pallton, çun! (tregime të zgjedhura), Botimet Toena, Tiranë, 2003; Mendime dhe vlerësime për veprën e shkrimtarit Faik Ballanca, f. 319.

11 Qormemeti (Berisha), Bleta: Faik Ballanca, si e çoi në vetëvrasje plenumi famëkeq i vitit 1973, gazeta Nacional, e diel, 05.03.2017, f. 21.

12 Laço, Teodor: Një jetë e djegur si meteor, gaz. Panorama, 05.03.2016.



përmenda këtë fakt, sepse mendoj, që në zanafillë duhet shqyrtuar dhe interpretuar guximi i tij krijues në trajtimin e problematikave të reja, koha e tregimtarit si mëvetësi, por e zhvilluar brenda kohës letrare dhe e përballur me kohën ekzistenciale e reale. Gjithashtu mendoj, që nocioni i **Kohës merr zhvillime e përpjestime interesante në tipologjinë e këtij shkrimtari**. Merr degëzime të çuditshme e të papritura. Ashtu siç është letërsia e penës së tij letrare dhe profili artistik. Tipologjinë e tij duhet ta kërkojmë sa te bashkëkohësia sa te vizionet, - këto dy margaritarë që i pati vetëm mosha jetëshkurtër e Faik Ballancës. Edhe pse e tillë, ai na la një krijimtari të begatë e fatlume, që duhej kthyer në **Kolanë, si pjesë e trashëgimisë së vyer të letërsisë shqipe në gjinitë e prozës shqipe**.Përse e vyer? Sepse gjatë studimit tim kam evidentuar disa fjalë kyçe, të cilat flasin më mirë se kushdo, si: \*Jetë, dhembje, tragjizëm, vetëpërmbajtje, karakter shpërthyes, serioz, i ëmbël, i respektueshëm, studioz, jo bjerrakohës, vëzhgimhollë, i durueshëm deri në vetëmohim, dritëbutë, i mençur, fjalëkursyer, dashuri, guxim krijues. . \*Trashëgimi, bashkëkohës, befasim, aftësi, talent, personalitet. \*Konflikte të natyrshme e të pastisura, dinamikë e rrëfimit, frymë humane, lëvizje e elementëve të frazës,... etj.

Pasuria e krijimtarisë letrare të Faik Ballancës, ende edhe sot e kësaj dite, ka nevojë për shqyrtime e interpretime të mëtejshme. Sigurisht më të thelluara. Mendoj se ky krijues, në të shumtën e rasteve është vlerësuar si një ‘dashuri pas një fatkeqësie’. Faiku dhe krijimtaria letrare e tij nuk kanë nevojë për lëmoshë, as për fasada të rrejshme, e as për ditirambe. Se emri i Faik Ballancës renditet në aradhën e nderuar të mjeshtërve të mëdhenj të gjinisë sëtregimit të letërsisë shqipe si: Migjeni, V. Prendushi, M. Kuteli, A. Pashku, M. Camaj, N. Bulka, N. Prifti, V. Koreshi, I. Kadare, D. Agolli, Dh. Xhuvani, N. Lera, K. Blushi, Z. Çela, Sh. Tigani, etj. Krijimet e tij mbartin histori, mbartin jetë njerëzish të vendosura në kontekste të caktuara historiko – shoqërore. Autori me shumë ndjeshmëri ka studiuar dhe ka vizatuar karaktere, ka bërë analiza gjer në imtësi të ndjenjave, pasioneve e të idealeve të tyre. Në të shumtën e rasteve rrëfimi i autorit është rrëfimi i personazhit. Personazhet perceptohen e tharmohen nga autori e vendosen në mjedise të caktuara poetike. Janë të mbushura me lëng jete. Janë realë, të besueshëm e të prekshëm. Kanë psikologjinë dhe fatin e tyre. Historia e rrëfyer, edhe pse e distancuar nga koha reale, ruan modulimin e bashkëkohësisë. Në këtë vazhdë, optika e shkrimtarit Aleko Likaj vë disa thekse rreth mjeshtërisë e kontributeve të Ballancës në pasqyrimin e realitetit shqiptar, të cilat janë: “Faik Ballanca vizaton me “penel” mjeshtërisht realitetin dhe krejt ambjentin shqiptar të atyre viteve, me detaje krejtësisht të kursyera, që e bën kështu prozatorin e viteve 70-të, të veçantë e të ndryshëm nga shkrimtarët bashkëkohës në fushën e tregimit shqiptar. Kjo duket edhe karakteret që na jep, tek natyra, që në tregimet e tij nuk ka thjesht një funksion dekorativ, por që është në funksion të vetë krijimit, si një metaforë e beftë dhe krejtësisht e fuqishme, e cila të kujton në strukturën e vet, linjën “çehoviane” të të shkruarit, edhe pse autori parapëlqente shkrimtarë, si: Tomas Mani, Kafka, Kamyja, Dostojevski, etj.”<sup>13</sup>

Për krijimtarinë e Faik Ballancës, kritika letrare ka folur, por jo aq sa duhet mendoj, jo aq sa i takon një zëri kaq të fuqishëm të prozës shqiptare siç është zëri i tij. Dua të them për thellësinë e fjalës së tij, për rrafshet e ligjërimit dhe tipologjitë, apo ‘imazhinizmin’, siç e cilëson dhe thekson studiuesja M. Ahmeti. Megjithatë nuk duhen anashkaluar edhe disa interpretime të studiuesve dhe të kritikës letrare me të cilat jam ballafaquar gjatëleximeve të mia, ku gjej edhe

13 Likaj, Aleko: Ballanca, tregimtari që u shkatërrua nga diktatura, gazeta Nacional, 23.07. 2017.

gjykime, frazime apo përfundime të cilat analizojnë thellë dhe e vlerësojë prozën e Faik Ballancës ashtu siç i takon, si këto: “...kompaktësi naracioni – qoftë si strukturë mendimi, qoftë si sistem shprehës, mandej prania e një dramaticiteti të lehtë psikologjik dhe, në fund, përvetësimi i shpejtë dhe autoritativ i lexuesit që në start, që në fjalinë dhe në pasusin e parë.”<sup>14</sup> Më tej... “...dëshmon forcën e madhe krijuese të shkrimtarit: mundësia për të hetuar tinguj dhe ngjyra dramatiko-poetike te gjërat që i kemi pranë dhe përherë para syve.”<sup>15</sup> Përsëri më tej...” Aftësia e krijuesit për të hetuar lëvizje te pozitat e palëvizshme, për të hetuar klithje te gjërat dhe pozitat e heshtura, për të hetuar dramë, tension, rrëmujë të brendshme te format e qeta, te syprinat e lëmueta, është më në fund natyrë imanente e krijuesit të mirëfilltë.”<sup>16</sup> Po përsëri më tej: “Origjinalitetin krijues e bën më të dukshëm edhe mënyra e të rrëfyerit, me natyrshmëri e rrjedhshmëri, që nuk kërcet, por gurgullon në shtratin e vet, herë e ngadaltë, herë më e vrullshme, herë lirike e herë dramatike, sipas situatave dhe veprimit psikofizik të personazheve, të dramës së tyre dhe dramaticitetit të tyre.”<sup>17</sup>... etj.

Duke respektuar vështrimet dhe gjykimet e të gjithëautorëve të shkrimeve, e shoh tëudhës të qartësoj edhe disa dukuri. Krijimet e Faik Ballancës mbartin kode e shenja të përveçme që nderojnë letërsinë shqipe. Mendoj se ende mungonsa duhet fjala e kritikës letrare për emërtesat, stilemat dhe analizat në qasjen e strukturës së tekstit e të vështrimit stilistikor. Duhet të shenjoj gjithashtu se krijuesi Faik Ballanca ishte një shkrimtar sa lirik aq dhe epik. I gërshtetoi këto ngjyresa, i ruajti këto raporte, sa te fjala, aq edhe te fraza që ndërtoi. I ruajti duke njohur në thelb konceptin e gjinisë, të cilin e njohu mirë, i cili u shkri organikisht me talentin e tij si prozator i fuqishëm. Rrëfimi i tij kishte si tipar themelor hapësirën. Në fakt ishte shpirti i tij që u jipte udhë hapësirave. Në qoftë se në qerthullin e tregimeve dhe të novelave ngjarja ka një domethënie të pasur (veçori e krijuesit), të pasura janë edhe episodet, i pasur është edhe vetë subjekti me brumë jete (përsëri veçori e krijuesit). Të gjitha këto e kanë burimin tek shpirti i njeriut dhe shkrimtarit Faik Ballanca, i cili ishte sa i pasur, aq edhe i vyer stilistikisht. Jo çdo krijues e ka një pajë e stoli të tillë. Ndryshe nuk mund të ndodhte që krijimet e tij të kishin aq bindje e realizëm, aq modernitet e vizion. Dhe studiuesi Vasil Premçi, teksa analizon romanin “Nomeja e largët, si një roman ekzistencialist, shprehet kështu: “Në kohën kur u shestua dhe u shkrua romani, “Nomeja e largët” i Faik Ballancës, rryma filozofike e ekzistencializmit shijonte pranverën e vet të lulëzimit në Francë dhe në disa prej vendeve më të zhvilluara të Europës. Njohja e gjuhës frënge nga F. Ballanca dhe natyra e tij kërkimtare nuk lënë aspak dyshim për njohjen e letërsisë bashkëkohore frënge dhe të veprave të Zhan Pol Sartrit.”<sup>18</sup>

Shkrimtari Faik Ballanca udhëtoi përmes ngjarjeve që thuri. Rrëfeu magjishëm përmes krijimeve të veta tregimtare, novelistike e romaneske. Udhëtoi... përmes rrjedhave të kohës. Pati gjithnjë shënjime e “stacione” nga një etapë udhëtimi, në tjetrën, ndonëse udhëtimi jetësor qe fare i shkurtër, por i kompensuar me vazhdimësinë e veprave të tij letrare, udhëtim e vazhdimësi që ende vazhdon...

E, për këtë vazhdimësi (duke e bërë kohën të tanishme), shkrimtarja Helena Kadare flet: “Kam pasur fatin të kem qenë një nga miqtë e afërt të Faik Ballancës. Ishe një miqësi që nuk kërkonte prova dhe as fjalë të bujshme. Sepse një gjë nuk ndryshoi kurrë tek ai: në të gjitha rastet, sido që të ishin rrethanat, kur gjendeshe në vështirësi, atë mik do ta kishe përherë në krah. Këtë e kanë provuar, pa përjashtim, të gjithë ata që e kanë njohur nga afër. Dhe kjo ishte arsyeja që miqësitë e tij ishin të qëndrueshme. Vetë karakteri i tij, edhe pse fare i ri në moshë, kishte atë cilësi të veçantë, që e kanë të gjithë njerëzit e fortë shpirtërisht: ai rrezatonte besim dhe siguri te të tjerët. Dhe kjo nuk ishte një gjë e vogël për kohën. S’ishte as rastësi. Faiku ishte nga ata njerëz që punonte me një përkushtim prekës, për përsosjen absolute të mendjes dhe të shpirtit të vet. Tërë qenia e tij, krejt fiziku i tij i brishtë iu vihej përherë provave të vështira, për të arritur më të lartën, më të pamundurën.

...

Qysh në tregimet e tij të para dukej që atje tej një tharm i veçantë, që kanë fatin ta kenë vetëm ata njerëz që kanë lindur me dhuntinë e të bërit të artit të madh.”<sup>19</sup>

Faik Ballanca i dha besën letërsisë (krijimit) si akt. Dhe po letërsia (krijimi) ia shumëfishoi këtë besë, po si akt. Akt besimi, mirëbesimi dhe shumëfish besimi!. Sepse shkrimtari Faik Ballanca e artikuloi fjalën përmes një shqipeje të bukur e të pasur. Një pasuri përrallore! Fjalën e kishte të shenjtë. E shenjtëroi! Po ashtu dhe personazhet: me psikologji dhe dramë, me dramë dhe psikologji.

*Shkodër, janar, 2023*

14 Ballanca, Faik: Mbama pak pallton, çun! (tregime të zgjedhura), Toena, Tiranë, 2003; Mendime dhe vlerësime për veprën e shkrimtarit Faik Ballanca, f. 319.

15 Po aty.

16 Po aty.

17 Po aty.

18 Premçi, Vasil: “Nomeja e largët” i Faik Ballancës, një roman ekzistencialist, Gazeta Shqiptare, 05.11.2017, f. 19.

19 Kadare, Helena: Si tani e kam para syve kur më shfaqej Faiku... (rrëfim), MAPO 26-27.12.2015, f. 13.

Letërsia bashkëkohore shqipe, me theks të veçantë ajo që zhvillohej në Kosovë, gjatë viteve '70 e '80 ka arritur zenitin e saj në kuptimin e përparimit në stil, formë, diskurs, në zgjerimin e problematikave, në trajtimin e koncepteve universale si jeta, vdekja, dashuria, dhembja etj. Me aq sa ka pasur mundësi, autorët kanë arritur të depërtojnë përtej një norme të imponuar nga regjimi në Shqipëri e robëria në Kosovë dhe vise tjera që u lanë jashtë trungut amë. Krijuesit nga Kosova, duke shfrytëzuar një mundësi lëvizjeje, ranë në kontakt me letërsinë bashkëkohore perëndimore por edhe atë që zhvillohej në Shqipërinë e regjimit komunist. Pra, ata patën mundësi që ta avancojnë nivelin artistik të krijimtarisë letrare por duke e ruajtur traditën kombëtare që lidhej me lashtësinë dhe të kaluarën si shenjë e kujtesës se autoktonisë dhe përkatësisë etnike e kulturore.

Një nga autorët më eminentë shqiptarë që i siguruan poezisë shqipe një nivel të lartë artistik, është pa dyshim, Ali Podrimja. I lindur dhe rritur në Gjakovën e Rafshit të Dukagjinit, Podrimja u ngrit intelektualisht përmes një tradite që mbeti përgjithmonë në shtresat e vetëdijes së tij duke u reflektuar në krijimet e tij. Autor i mbi njëzetë veprave poetike e eseistike, ai arriti ta lë një krijimtari që qëndron në lartësinë më të madhe të letrave shqipe. Ai la vepra si: *Thirrje, Dhimbë e bukur, Sampo, Torzo, Fundi i gëzuar, Ishulli Albania, Pikë e zezë në blu*, etj. Mirëpo vepra që është subjekt i këtij trajtimi dhe njëherësh edhe një nga kryeveprat e Podrimjes është *Lum Lumi*.

Tërë krijimtaria e Podrimjes është e veçantë për nga brendësia e saj. Duket sikur autori jep në secilën poezi dhe secilin varg të kaluarën e tij, konkretisht duke e përballuar pambarimisht fatin intim e kolektiv. Në të vërtetë, i tillë ishte fati i poetit duke mbetur qysh herët pa prindër, sikundër do ta ndiente të njëjtën gjë edhe për Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, deri në fundshekullin XX. Janë këto dy koncepte, individualja e kolektivja që do ta bashkëdyzojnë krijimtarinë e tij duke shpërfaqur dhembjen, forcën, traditën dhe shumë koncepte tjera sa universale aq edhe unike. Studiuesi Ali Aliu me të drejtë konstaton se: *Në këtë kontekst të fatit të vet dhe atij kosovar, poetin do ta godasë edhe fatkeqësia e quajtur Lum-biri, të cilin ia rrëmben vdekja, në moshën e re. Përballë këtij mozaiku të fatit kosovar dhe podrimjan, poeti Podrimja do të zhvillojë një luftë stoike, me vullnet të ndezur, duke i përballur të gjitha goditjet e fatit individual e kolektiv*<sup>1</sup>. Kjo na jep të drejtë të konstatojmë se poezia e tij ka pasur ngjyrat e misionares: të jetë një zë i dhembjes kolektive që mund t'i ngjasojë shpeshherë misioneve të tipit të Don Kishotit, të llojit të vet, por zëri i dhembjes duhet të jetë thellësisht tronditës dhe bartës i dhembjes së të gjithëve.

Vepra *Lum Lumi*, përvëqë tjerash mund të quhet edhe nevojë e poetit që të plotësohet si krijues, ndonëse ai në vazhdimësi ka arritur ta përsosë formën e përmbajtjen e poezisë. Pikërisht, duke arritur ta plotësojë veten, autori ka synuar ta përsosë edhe veprën në fjalë, duke e rishkruar e ribotur disa herë, siç shprehet edhe vetë: *Kam dëshiruar ta "shpritërojë" fjalën dhe ta mbaj gjallë kujtimin për Lum*<sup>2</sup>. Në rrafshin kompozicional, vepra ndahet në shtatë cikle, të cilat janë shtuar me rishkrimet e ribotimet e veprës: *Buzë ujit të madh, Të jetosh, Vdekja dhe Lumi, Në mbretërinë e humbur, Hyrje në tempull, Pastërti njerëzore dhe Kërkoj njeri*. Autori duke dashur ta mbajë gjallë kujtimin për të birin, e ka rishkruar veprën *Lum Lumi* dhe kështu ai e ka ripërtirë artin poetik, duke e avancuar jo vetëm strukturën e vargut por edhe artin e fjalës. Rrjedhimisht, do t'i referohemi botimit të fundit, të vitit 2012, që u botua pas vdekjes, duke konsideruar se autori tashmë e kishte dhënë fjalën e tij të fundit mbi këtë vepër që prek problematika individuale, kolektive e universale.

Duhet theksuar se kjo vepër është shkruar

# FATI INDIVIDUAL, SI FAT KOLEKTIV NË VEPRËN "LUM LUMI" TË ALI PODRIMJES

Nga Arbër Malota

në pjekurinë më të madhe artistike e poetike të vetë poetit. Ai tanimë, e kishte krijuar identitetin e tij qoftë poetik, qoftë intelektual. Shpeshherë poetët, duke e përshkruar një dukuri që ka prekur vetëm personalitetin e tij ose dikë që e ka pasur epitetin e të veçantit, kanë gjetur shpjegimin mbi dukuritë dhe ngjarjet që mund ta kenë goditur, ose në të njëjtën kohë, ose më herët, ose më vonë, tjetrin, shoqërinë dhe botën me të cilën rrethohemi. Zgjidhja është parë te fati, si vulë e përrjetshme që e etiketon qenien njerëzore, si mëkati i rrjedhshëm apo edhe si fundi i domosdoshëm, deri në kalimin e qenies në forma e dimensione tjera të ekzistencës ose drejt zhbërjes materiale, për t'i ngjasuar zanafilës. Për Podrimjen, shpirti nuk ka të bëjë me qenien materiale, sepse qenia i nënshtrohet fatit, ndërsa shpirti e siguron përjetësinë. *Kjo vepër shënoi një moment kthese në poezinë e sotme kosovare*<sup>3</sup>.

Andaj edhe kjo vepër, edhe përkundër vdekjes së të birit, mbi kujtimin dhe jetën e të cilit është shkruar ajo, synon ta shtjellojë këtë gjë, pra përjetësinë, duke trajtuar fatin si komponenten kryesore që mund ta zgjidhë dilemën e ekzistencës. Rikthmi i kujtesës, që korrespondon me ribotimet e veprës dhe ndërhyrjet e poetit, na shpjegon se Podrimja ka dashur ta bëjë një vepër lapidar të një vuajtjeje atërore.

## 1. Dhembja njerëzore njëjtësohet me dhembjen e kombit

Vepra prek e shtron dilemën e ekzistencës. Studiuesi Sali Bashota me të drejtë shprehet se: *Duke zbërthyer poetikisht kuptimin ekzistencialist të jetës, poeti gjithnjë i situon shenjat e fatit të qenies njerëzore. Dhe ideja, motivi, tema etj., herë metaforizohen, herë simbolizohen përmes shtresash ironike për të mbërritur kulmin e protestës, të zemërimit poetik të përsëritur më vonë te poetët tjerë në poezinë e sotme shqipe*<sup>4</sup>. Së pari vepra bëhet zotëruese e dilemës hamletiane, ku vihet në peshore ekzistenca dhe mbarimi i jetës mbi maksimumin e veçantë: *Të jesh a të mos jesh?!*. Kësaj i përgjigjet poezia *A do të ketë kohë*, ku autori jetën dhe vdekjen i sheh të pandara brenda qenies së tij por ekzistencën e kësaj qenie e sheh të zotëruar nga një forcë supreme e një fuqie të mbinatyrshme, në duart e të cilës e dorëzon fatin e tij:

*Përtej sime frymë, ati le të më shpjegë,  
A do të ketë kohë*<sup>5</sup>

Ciklin e parë të poezive *Buzë ujit të madh*, e përcjell vazhdimisht lufta e paepur, brenda vetes së poetit, mes jetës dhe vdekjes, veçse vdekjen, poeti, nuk e sheh thjesht si dekompozim material e mbarim i trupit, por kalimi i shpirtit nën zotërimin e një force absolute, Hyjit, ku do të rrijë i paprekur dhe i pambaruar ashtu siç mëton ta paraqesë të paprekur dhe të pambaruar edhe Lumin e kujtimin për të.

Duke kujtuar se poeti ishte notues i mirë, ai poetin e quan edhe zhytës e notues, si

shpjegim ndaj kërkimit të vazhdueshëm që e ka poeti mbi të vërtetën dhe jetën. Edhe këtu ai e ka një dilemë përderisa i lë vargjet:

*Uji i Madh e zi  
Rrjeta, rrënjë dhe gjumë  
Koha e notuesve a përfundo?*

Roli i notuesit është i njëjtë me atë të misionarit. Podrimja e luan polotësisht këtë rol përmes poezisë së tij për shumë arsye. Duke i takuar Qarkut Kulturor të Prishtinës, qark ky që nuk ishte i kufizuar vetëm rreth zhvillimit të jetës kulturore, por edhe të përcaktimit të fatit politik të kombit shqiptar në Kosovë, Podrimja e ka reflektuar edhe në këtë vepër dhembjen e kombit. Duke jetuar në një kohë të pasigurt, poeti e trajton pasigurinë e jetës së të birit, lëngesën e tij, njëjtë sikur pasigurinë dhe lëngesën e një populli, ndaj të cilit (sikur edhe ndaj Lumit) po binin padrejtësitë dhe ironitë më të mëdha të jetës. Prandaj, edhe titulli i veprës *Lum Lumi* lehtë mund të rrëshqiste në një titull si *Tmerr Tmerr*. Poeti e kishte përjetuar represionin serb qysh në rininë e tij, me të ashtuquajturin "Aksioni i armëve" por edhe duke qenë i vetëdijshëm për fatin historik të shqiptarëve të Kosovës, të mbetur jetim jashtë trungut amë. Andaj edhe kthimi në kujtesë është një pjesë e rëndësishme edukimit, që përmes porosive që ia jep të birit, ai aludon në një porosi të madhe që ia jep kombit se: vdekja nuk është thjesht fundi i jetës.

Tërheqja në vetmi, është një shenjë tjetër e dilemës. "Fati na la?" – pyet poeti. Kjo tërheqje, artistikisht është një qetësi para stuhisë, ku autori në përsiatjet e tij mbi jetën, mbledh forcat e veta dhe e jep kumtin e madh mbi dhembjen dhe fatin, që nga një fat individual po rrëshqiste në atë kolektiv. Si një baba i plagosur shpirtërisht, ai bart në qenien e tij sëmundjen dhe fatin e jetës së të birit dhe niset me të, drejt kalvarit të mundimeve. Është ai shpirt i prindit që është refuzues ndaj vdekjes. Ai refuzon fundin, ndonëse është i vetëdijshëm për të. Përderisa fluskon pak jetë brenda një qenie, vdekja nuk është fjala e fundit. Njëjtë do të thoshte poeti edhe për fatin e kombit, përderisa të ekzistojnë vetëdija dhe përpjekjet e tij për ta sublimuar arspiratën shekullore të tij. Duke lëvizur nga një qytet botëror në tjetrin, për të gjetur shërim, autori si një kasandër paralajmëron lëvizjet e elitës sonë intelektuale nëpër kryeqendrat më të mëdha të botës për ta ndiçuar kauzën politike e shoqërore të popullit tonë.

Stilistikisht vepra ndërtohet mbi një figuracion të pasur stilistik, ku përmes metaforës, simbolit, antitezës, ironisë etj., shpërfaqet emocioni i poetit dhe drama jetësore e tij përmes vuajtjes së Lumit. Ndaj, qysh në fillim autori e shkruan dedikimin: *Dhembjes sate, Lumi*. Autori është cilësuar edhe si një novator dhe ky epitet është mëse i merituar, duke e parë nivelin artistik dhe risitë që ai i ka sjellë në poezinë e sotme shqipe, duke u bërë model për poetët që do të vinin më vonë.

Cikli i dytë, *Të jetosh*, është pa dyshim nga më të bukurat e veprës por edhe vargu është



më i strukturuar. Studiuesi Ramadan Musliu konstaton se poezitë e këtij cikli kushtëzojnë dy procese: defigurimi i gjuhës poetike dhe neutralizimi i kuptimit dhe i shtresës emocionale të verbit poetik. Kjo arrihet kur struktura ligjërimore e vargut dhe sistemi figurativ modifikohen në tërësi dhe pësojnë në planin figurativ dhe kësisoji vjen deri te defigurimi i gjuhës. *Tashmë figura poetike si njësi themelore poetike i nënshtrohet parimeve të funksionalizimit përbrenda njësie më të mëdha tekstore, duke u kompozuar kështu në semantikën integrale të tekstit*<sup>6</sup>. Meqë sikurse edhe thamë se vepra ndërtohet mbi dhembjen dhe në formë elegjiake i flet asaj, autori në asnjë moment nuk i ka lënë vend elementeve banale a patetike të shpërfaqjes emotive. Ai esencialisht godet elementet që lidhen me dhembjen universale e kolektive dhe asnjëherë me atë personale. Personalen e ka zëvendësuar me individualen. Këtë të fundit e ka unifikuar me dhembjen kolektive që lidhen në hallkën e zinxhirit që e tërheq koncepti më universal në vepër, fati.

Një nga poezitë e këtij cikli, që mund të themi se është kryefjala jo vetëm e ciklit por e tërë veprës është *Deri në fund*. Këtë poezi, poeti e ka përpunuar nga viti 1979 kur e shkroi për herë të parë e deri më 2003. Është pikërisht momenti ku poeti nuk arrin ta shohë dritën në tunel rreth fatit të të birit dhe shfaq frikën e tij për fundin e jetës së të birit. Megjithë pesimizimin dhe ligjërimin elegjiak, në poezi ka nota moralizimi, që janë një kamuflim i dhembjes, një tejkalim i qëllimshëm i zymtësisë, ku poeti merr forcë dhe e këshillon të birin thuasë ai do ta fillojë jetën që nga ai moment:

*Ti mëso të duash vogëlush,  
Mëso të ecësh me këmbët e tua,  
Mbi të keqën, mbi të mirën,  
Mendo me kokën tënde,  
Kurr mos pështy në dashuri as në pleh,  
Mallkim i fisis*<sup>8</sup>.

Është një ligjëratë morale e prindit dhe një aluzion në ligjërimin e përgjithshëm moral mbi të mirën dhe të keqen; mbi rrugëtimin e qenies njerëzore në labirinthin e jetës kur shpesh ajo qenie përballet me luftën e pakompromis të forcave të kundërta, për të triumfuar mbi të. Mbi zjarrin e zjarmisë së të birit dhe skuqjen klinike të syve, ai e sheh yllin, zjarrin e qiellin dhe aspiroon lundrimin drejt hapësirës, e cila nxjerret si një habitat që tani i përket amshimit dhe prej nga mund të takoheshin dy qeniet: njëra e shkëputur pa të drejtë (Lumi) dhe njëra që domosdoshmërisht do ta ndjek pas tërë jetën (poeti). Ai duke e këshilluar të birin jep mesazh te të gjithë mbi frikën dhe frikakakët që edhe në art i quan vrasës dhe mjeshtërinë e tyre dhelpepërinë si simbol të dinakërisë. Po ta përcjellim me vëmendje, në shumë krijime të tij, Podrimja e ka një luftë me frikakakët dhe dinakët. Në fakt, poeti duhet të jetë i tillë, një shpirt që nuk krijon strehë për forcat e errëta. Kujtesa është elementi i fundit që Podrimja do ta marrë me vete kur ta lërë spitalin mbi Danub dhe do t'i

<sup>7</sup> Ramadan Musliu, *Mbindërtimi poetik, Rilindja*, Prishtinë, 1990, f. 152.

<sup>8</sup> Ali Podrimja, *Lum Lumi, Koha*, Prishtinë, 2012, f. 42.

<sup>1</sup> Ali Podrimja, *Vepra 1, ASHAK*, Prishtinë, 2013, f. 8.

<sup>2</sup> Ali Podrimja, *Lum Lumi, Koha*, Prishtinë, 2012, f. 7.

<sup>3</sup> Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini*, Pejë, 1997, f. 453.

<sup>4</sup> Ali Podrimja, *Lum Lumi, Koha*, Prishtinë, 2012, f. 10.

<sup>5</sup> Po aty, f. 21.

<sup>6</sup> Po aty, f. 25.

dezinfektojë jo vetëm rrobat, por edhe fjalët dhe ëndrrat.

Ky lloj trajtimi gjendet edhe në poezinë *Ekzistenca*, që përshkruan fjalëpërfjalëshëm një gjendje kritike, ku autori përmend çdo pjesë të trupit dhe organeve jetësore të Lumit, të cilave u kërkon që të funksionojnë si një trup i vetëm në një trup të vetëm. Ai e ka bindjen se urdhëri i babait do të gjejë gatishmërinë e bindjes së të birit dhe do t’ia dalë. *Dhoma 512* dhe *Dhoma e Vdekjes* janë poezitë ku autori përjeton gjendjen tipike të individit i cili para se të dorëzohet preferon të lutet. Ngjan me lutjen e Krishtit në kopshtin Gjetseman që Hyji ta largojë nga ai kelkun e vuajtjeve, por i nënshtrohet vullnetit të tij. *Nuk ka bërë asgjë për lumin*, është poezia tipike për detyrën e prindit, detyrë të cilën ai nuk e quan kurrë të kompletuar, nga dashuria e madhe për krijesën e tij. As për kombin nuk është kurrë mjaft, thotë poeti. Andaj gjendet një dozë jo e vogël e fajësimit të vetes së tij dhe paradoksalisht përmes këtij fajësimi kërkohet shfajësimi dhe kjo na jep të besojmë se autori e jeton secilin varg që në letër dhe çdo copëz e mozaikut e ka vendin e saj.

Cikli i tretë *Vdekja dhe Lumi*, është një homazh për të birin dhe një rikthim në kujtesë, që nxitet nga nevoja e brendshme e krijuesit por në rastin e poetit, siç shprehet edhe ai vetë, nga frika e mosndryshimit të gjërave: *Kur nuk kam çka të bëj, trazoj mbretërinë time të vdekshme/ droj nga sendet që nuk ndërrojnë/ një herë në 100 vjet*. Pra kemi një bashkëdyzim sistemesh brenda një qenie, të jetës dhe vdekjes. Mbi këto dy sisteme, autori ngreh çadrën e tij dhe aty evokon kujtime dhe lutet si një pelegrin i vetmuar.

Cikli i katërt, *Në mbretërinë e humbur*, ka një vazhdimësi me ciklin e tretë, veçse këtu autori i shkruan vdekjes. *Ikja e të birit, ende fëmijë dhe ngadhnjimi i së keqës që në shumë poezi poeti nuk mund ta pranojë si realitet, në poezinë. Në mbretërinë e humbur, ky largim duket i vërtetë dhe së të gjallët nuk i lë të qetë edhe pse ai deklamon se trimat nuk vajtohen<sup>9</sup>*. Poeti e quan vdekjen fundin e dhembjeve trupore njerëzore. Ai i drejtohet Lumit me fjalët: *Je më i sigurt aty Lumi, për besë nuk të gjenë një e zezë*. Tani mbetet Lumi vetëm në poezinë e babait, i cili siç thotë poeti – hyri pa trokitur.

Cikli i pestë, që mban titullin *Hyrje në tempull*, që mund të aludojë me hyrjet e lashta në tempuj, të profetëve, perandorëve, mbretërve etj. Tani hyn poeti në tempullin e fjalëve, në tempullin e arritjes së lavdisë përmes ligjërimit poetik.

Cikli i gjashtë, *Pastërti njerëzore*, janë poezi të kushtimit, që e shkëpusin nga realiteti i momentit, duke i dhënë një plotësim më të madh veprës, që sikurse thamë, nuk trajton vetëm fatin individual por e bashkon me atë kolektiv. Ka poezi që i kushtohen Armenisë në kontekstin e atëhershëm kohor, Pasternakut etj.

Cikli i shtatë, *Kërkoj njeri*, që mban dy poezi të cilat e lidhin rrugëtimin e individit drejt kërkimit të njeriut, të shpirtit apo të një dimensionit tjetër të jetës dhe përfundon me poezinë që fundin e ka të fshehur në gjirin e e saj dhe që titullohet *Gjumi i tokës*. Gjumi mund të quhet si një gjysmësimbol i vdekjes, apo i mbarimit të universit sikundër shprehet edhe vetë autori.

Së këndjemi, tërë vepra është një revoltë, një zë i lartë proteste mbi konceptet antagoniste me njëra-tjetrën; mbi fati dhe fatkeqësinë, mbi të drejtën dhe padrejtësinë, mbi jetën dhe vdekjen, mbi sigurinë dhe dilemën dhe mbi frikën e humbjes dhe lumturinë.

Rexhep Ismaili e definon qartazi veprën në fjalë: *Qysh nga Lum Lumi e tehu, ai solli në poezinë e tij reflekshe ekzistencialiste, dilema për qenien, vrojtime të vetmisë, përballje me refleksin për frikën, për vdekjen, shtroi dilema për fatin e njeriut dhe njerëzimit, por edhe*

*përvojën dhe nevojën e marrjes së distancave*<sup>10</sup>. Secili autor, në një pikë të caktuar të veprimtarisë së tij, e lë veprën jetësore që është dyzim i jetës së tij personale dhe i përvojës jetësore duke lundruar në detin e pafundëm të letërsisë, duke u ndikuar nga magjia e fjalës. Lumi i Podrimjes, është shkrië nga një krijesë e prekshme e mishit dhe gjakut, në një krijesë që si shpirt dhe botë të brendshme e ka fjalën, atë që autori e dezinfekton qysh kur e lë spitalin, atë fjalën magjike që do ta mbajë përherë të gjallë për të dhe jo vetëm. Ai do të krijojë një mrekulli letrare që fatin e Lumit dhe të njerëzimit do ta trajtojë në dimesionet më të larta të komunikimit dhe jetës.

Podrimja, duke krijuar një vepër jetësore, arrin ta ndërtojë një standard të ri letrar dhe poetik. Këtë standard, sigurisht e kanë ndjekur brezat që kanë ardhur më pas, por e kanë vazhduar edhe bashkëkohanikët e tij.

## 2. Shtresimet e traditës në poezinë e Podrimjes

Jo vetëm në veprën *Lum Lumi*, por në tërë krijimtarinë e tij, autori ka përmendur elementet e traditës, e me theks të veçantë kullën, kultin e të parëve, fisin, totemët e ndryshëm, që jep të kuptohet se ai ka qenë tërësisht i zhytur në të kaluarën dhe ka dashur ta kultivojë atë duke e ngritur, bashkë me të edhe nivelin artistik të poezisë. Ky është një tregues i qartë se autori nuk shpërfaq vetëm ndjenjat personale por ai aludon në fatin dhe pikëpamjet universale mbi jetën, vdekjen, traditën, qëndresën dhe etninë.

Kulla, e cila është një nga elementët të cilën e gjejmë në poezinë podrimjane, e ka simbolikën e shumëfishtë: origjinës, strehës, qëndresës, familjes dhe përkatësisë. Po t’i referohemi studiuesit të shquar, Sabri Hamitit, ai e jep një përgjigje se pse shumë shkrimtarë e

kanë si pikë referente të kaluarën: *Shkrimtarët gjithherë e kanë pasur më lehtë të shkruajnë për të kaluarën ngase në këtë rrugë e kanë pasur ndihmesë të mirë fjalën shpirtërore të shumicës, fjalën e popullit dhe fjalën artistike para tyre, mbi një kohë të shkuar*<sup>11</sup>. Tutje, ai shton se shkrimtari nuk e ndërton këtë kullë për dëfrime por për qëndresën e njeriut, dhe për më shumë, të kombit. Hamiti konstaton se poeti qysh moti e ka emrin babë, e përgjithëson me kuptimin komb. Babai është ai që ndërton, pra kombi është ai që ndërton modelin e tij të jetës dhe qëndresës.

Kulla te vepra *Lumi Lumi*, e ka pikërisht këtë kuptim, të qëndresës. Kulla duhet të personifikohet me qëndresën e të birit për t’i rezistuar vdekjes, ashtu siç kulla i reziston shekujve e furtunave të fatit e historisë. *Mbyllet syri, dhe frëngjia në kullë* – thotë poeti duke përshkruar fundin tragjik të të birit që bashkë me të bart edhe fundin e një qëndrese. Një element tjetër i qëndresës është edhe figura legjendare e Gjergj Elez Alisë, ku Lumi krahasohet me të duke u matur me plagë, me vuajtje dhe më shikimin kah horizonti i vdekjes. Megjithatë, të dy, edhe Gjergji edhe Lumi kanë misione tjera të mbrojtjes së jetës dhe zgjidhjes së një dileme të pazgjidhshme, që çon në dëshifrimin e një enigme që paraqitet si një zinxhir ku hallkat që lidhen me njëra-tjetrën janë jeta dhe vdekja.

Simbol të vdekjes përveç korbit, që është simbol i përgjithshëm i zisë që lidhet me vdekjen, autori e paraqet ujkun. Edhe te *Hija e tokës, Sampo, Torzo* ashtu edhe te *Lum Lumi*, ukju paraqitet si grabitqar i jetës, sikundër edhe njihet në mitologji, por edhe në jetën e përditshme si predator i pakompromis. *Tri herë uluroi ujku rreth shtëpisë sonë* – do të thoshte Podrimja duke iu referuar tri morteve në familjen e tij, të prindërve që e lanë të njomë në moshë dhe tanimë edhe të të birit po

<sup>11</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia bashkëkohore*, sh.b. Konica, Prishtinë, 2002, f. 179.

ashtu të njomë në moshë. Letërsia jonë, qysh në atë gojore e deri në atë bashkëkohore, ka trajtuar figurën e ujkut si krijesë të zotin për të rrëmbyer atë që e do. Prandaj, edhe vdekja është më e fortë se përpjekjet për jetën dhe autori këtë e pranon, ndonëse lufton me vetën deri në fund për ta refuzuar si diçka faktike. Ai përmes figurës së ujkut, përshkruan ulurimën shekullore të një historie të pandryshuar, të një cikli që përsëritet vazhdimisht (assesi një qarku të mbyllur), që do ta marrë në mbretërinë e errët shpirtin e shpirtit të poetit. Kjo e keqe i kanoset edhe popullit, apo masës kolektive, nëse ai nuk krijon mekanizma mbrojtës për ta siguruar ekzistencën.

Kujtojmë se duke ia kushtuar nje poezi Altimarit, Podrimja duke u personifikuar me arbëreshin thotë: *Po qe se më vret mua, more i gJORë, kush do ta vrasë ujkun? Mjerë kopeja*.

Përveç elementeve që prekin traditën, autori aludon në elemente apokaliptike si zjarri, uji etj., që doemos lidhen me fundin e Lumit, që për poetin e ka peshën e fundit apokaliptik. Herë i jep Lumit fuqinë e kreshnikëve të lashtë e herë atë të elementeve galaktike, megjithatë nuk i mohon të metat tokësore ku fati i njeriut i gjunjëzohet një fuqie të përhershme si vdekja.

Rrjedhimisht, Podrimja nuk pranon assesi që të trajtohet ndryshe përveç si pjesë e pandarë e trungut të fisit, e përkatësisë etnike shqiptare për të cilën ai ka dashuri e krenari deri në dhembje.

### Përfundim

Me tërë atë krijimtari, edhe përkundër faktit se ai e kishte arritur një standardizim poetik, Podrimja nuk do të plotësohej pa *Lum Lumin*. Misioni i shkrimtarit është kurdoherë enigmatik përderisa ai zhytet vazhdimisht në kërkim të magjisë së fjalës. *Përderisa zhytësit notojnë, poezia më e mirë as nuk është shkruar e as nuk do të shkruhet* – deklamon poeti ynë. Asgjë nuk do të plotësohej pa Lumin, tani gjithçka u krye. Dhe autori e dorëzon fatin e tij para krijuesit (*ati le të më shpjerë, a do të ketë kohë?*). Pra tani në kërkim të magjisë së fjalës, Podrimja e ka gjetur atë magji: ai përmes vargut zbulon se fati individual rrëshqet te ai kolektiv. Jetën në këtë univers, që është sa interesant aq edhe enigmatik, e sheh si përpjekje e vazhdueshme për t’i dhënë përgjigje pikëpyetjeve rreth ekzistencës si detyrë elementare dhe jetësore e individit. Mirëpo, me një gjë nuk do të pajtohet kurrë poeti, me panatyrshmërinë e një fundi ndonëse të pritshëm.


Pa pretenduar asnjëherë se i kemi thënë të gjitha, vepra në fjalë është një konglomerat vizionesh e projeksionesh deri buzë një parabole që lidhet me perspektivën. Duke qenë dëshmitarë të ngjarjeve që kanë rrjedhur në Kosovë, ndaj të cilave poeti nuk ka qëndruar indiferent, ngjarje këto që vërtetë e kanë çuar popullin shqiptar buzë mohimit të ekzistencës, atëherë kjo vepër është prelud i këtyre ngjarjeve. Këtë e mbështesim te shpirti krijues e vizioni i pashembullt i poetit, që fatin e tij e njëjtëson me fatin e kombit të tij. Ai ishte pambarimisht i lidhur me organiken e shoqërisë, me kulturën dhe traditën tonë.

Vepra *Lum Lumi*, ende ngërthen në vete mister dhe së këndejmi gjithmonë do të ketë hapësirë për trajtime e studime rreth saj, siç do të thoshte Podrimja: përderisa zhytësit ende notojnë.

### Bibliografia

- Podrimja, Ali, *Vepra 1, ASHAK*, Prishtinë, 2013.
- Podrimja, Ali, *Vepra 3, ASHAK*, Prishtinë, 2013.
- Podrimja, Ali, *Vepra 4, ASHAK*, Prishtinë, 2013.
- Podrimja, Ali, *Lum Lumi, Koha*, Prishtinë, 2012.
- Elsie, Robert, *Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini*, Pejë, 1997.
- Hamiti, Sabri, *Letërsia bashkëkohore, Konica*, Prishtinë, 2002.
- Musliu, Ramadan, *Mbindërtimi poetik, Rilindja*, Prishtinë, 1990.
- Bexheti, Vebi, *Magjia e fjalës poetike, Arbëria Desing*, Tetovë, 2018.

<sup>9</sup> Vebi Bexheti, *Magjia e fjalës poetike, Arbëria Desing*, Tetovë, 2018, f. 214.



«Sërish në tokën e etërve. Është e çuditshme! Ndonjëherë, sa më shumë të duash të arratisesh, aq më shumë të thërret toka jote».

[«Di nuovo nella terra dei padri. È strano! A volte, più tu vuoi fuggire e più la tua terra ti chiama».]

*I nipoti di Scanderbeg*

Shkrimtaria e Artur Spanjollit, aktiv që nga fillimi i viteve 2000 dhe autor produktiv i romaneve në gjuhën italiane, duket se kurrë nuk është larguar realisht nga vendlindja. Në shumë raste, zëri i saj ka gjetur një vendbanim natyral në një hapësirë të banuar nga disa arketipe të së shkuarës shqiptare dhe atje është ndalur, thuajse donte t'i sodiste, sikur e vetmja mundësi për ta rikthyer në jetë atë të kaluar të ishte nëpërmjet rrëfimit nga afër duke përdorur një ekspertizë prej reporteri. Nëpërmjet analizave progresive dhe të mirëstrukturuara, ka ditur të na dhurojë, në rrjedhën e një veprimtarie të zhvilluar deri më tani në harkun kohor të konsiderueshëm të njëzetë viteve, disa portrete shumë efektive, të prejardhura nga një shoqëri arkaike, thuajse primordiale, e shkëputur nga historia, ku dimensionit i mitit dhe ai i klanit bashkëjetonin në një ndërthurje të pazgjdhshme. Në këtë lloj konteksti na shfaqen figurat e preferuara nga Spanjollit, të gjitha magjepsëse: patriarkët e urtë e të ndritur, të pajisur gjithmonë me sens mase dhe ndjenjë ataviste drejtësie; vajza e humbur si pasojë e instinktit natyror të provuar përkundrejt lirisë; jetimi plot mirësi dhe kurajo në dialog misterioz të vazhdueshëm me botën e të vdekurve; i riu mendjemprehtë, i aftë për të lexuar përherë realitetin ashtu siç është; matriarkja punëtore dhe e palodhur e cila ia kushton jetën fëmijëve dhe ruajtjes së rendit familjar. Në këtë galeri portretesh të mirëpërcaktuara, gjithmonë larg dimensionit kufizues të skicës, Spanjollit ka shpërfaqur armët më të mira të arsenalit të tij stilistik, duke rrëfyer rrënjët e veta përmes adoptimit të një këndvështrimi etnografik që vendos cilësitë e rrëfimitarit të vërtetë mbi ato të historianit.

**Dimensioni narrativ i kronikës dhe kuptimi i saj në fillim të viteve Dymijë. Trilogjia e Klanit Cialliku.**

Artur Spanjollit jeton prej shumë kohësh në Firenze, qyteti im i lindjes, meqë u përmend, vendi ku kam kaluar një pjesë të rëndësishme të jetës dhe ku jam formuar më së shumti, falë një mjedisi urban krejtësisht të jashtëzakonshëm. Kur kam rënë në kontakt me Arturin, kemi bërë shaka shumë herë për këtë transferim fatësh, që sikur na ka këmbyer vendet, duke na caktuar në mënyrë të kryqëzuar vendndodhje tepër të largëta – në pamje të parë – nga ato ku kishim lindur.

Por, të jetosh në Firenze, përveçse të transferon ditë pas dite një impuls natyror drejt një standarti absolut bukurie, presupozon gjithashtu një ndërgjegjësim instinktiv mbi prezencën e një koncepti mbizotërues: atij të traditës. Besoj se në rastin e Spanjollit ka ndodhur pikërisht kjo, sidomos për një zhanër që në Firenze është ndërtuar me ngulm që në epokën e komunës. E kam fjalën për kronikën (*cronica*), një formë rrëfimi e nënkuptuar si rindërtim i fakteve të shquara që ndërthurnin histori personale me ngjarje të mëdha komunitare. Përpara se të ktheheshim në sferën e historiografisë së vërtetë, asaj të formuluar nga greko-romakët, ekzistoi një periudhë e gjatë në të cilën historitë e Giovanni Villani fillimisht dhe Francesco Guicciardini më pas, synonin të izolonin episode dhe protagonistë të së tashmes dhe së shkuarës së qytetit të Firences për t'u sjellë njerëzve shembuj të virtyteve që duheshin ndjekur.

Sigurisht, nuk shkoj aq larg sa të argumentoj se rifillimi i atij modulariteti dhe i asaj tipologjie tregimi – i kufizuar në një kontekst të saktë letrar dhe vërtet i largët nga ditët tona – është i ndërgjegjshëm dhe i dëshiruar te Spanjollit, por është fakt që formulimi i tij është shpesh ai i reporterit, një figurë e ngarkuar për të mbledhur dhe për

## UDHA E DORËS: EPISODI I SHTATË KRONIKË DHE ETNOGRAFI NË SHKRIMTARINË E ARTUR SPANJOLLIT.

*Nga Dr. Fabio M. Rocchi*

t'u përcjellë pasardhësve disa ngjarje që ia vlen të përmenden, disa ngjarje me karakter shembullor. Përtej distancës së dukshme kohore që e bën të pamundur një paralele në kuptimin e plotë, paradigma e vërtetësisë dhe autenticitetit të fakteve të rrëfyera më duket gjithsesi një tipar që duhet veçuar për të kuptuar një metodë shkrimi. Ashtu si në kronikat fiorentine, rrëfimtari i Spanjollit është shumë i pranishëm, qoftë si entitet i gjithëdijshëm, qoftë si funksion i aftë për të organizuar fabulën. Ai njeh faktet, i komenton me mbiemra vlerësues e me një qëndrim të qartë që synon të dallojë të mirën nga e keqja, dhe i vendos në sekuenca të renditura kronologjikisht. Një zë *over*, i cili shfaqet si vëzhgues i vëmendshëm dhe adhures i së vërtetës, i etur për të ndarë me lexuesin ngjarje që mund të kujtojnë një periudhë tashmë të humbur të komunitetit shqiptar në këtë rast, dhe personazhe të veshur me personalitet dhe ashpërsi morale.

Pra, reporteri për Spanjollin është sinonim i rrëfimtari. Dëshiron që zëri i tij të dëgjohet, pa u fshehur tepër në rrudhat e tregimit dhe duke i dhënë një fuqi gjithëpërfshirëse. Kjo fuqi, ndonjëherë ndërhyrëse, edhe pse e balancuar mirë, siç do ta shohim nga disa masa paraprake të marra gjatë fazës së redaktimit, i rrjedh nga të qenurit ai vetë një lloj dëshmitari, gjithmonë në dijeni të gjërave në cilësinë e një depoje të së vërtetës. Në një kontekst narratologjik që apelon drejtpërdrejt figurën e kronistit-narrator, nuk mund të mos vijnë në mendje faqet mjeshtrërore të shkruara në këtë linjë nga Walter Benjamin në vitin 1936. Në fakt, Benjamin në atë vit botoi një nga esetë më të famshme kushtuar kësaj figure, një ese e vendosur në kufirin midis artit të tregimit dhe reflektimit filozofik. Titullohej: *Il Narratore. Considerazioni sull'opera di Nikolaj Leskov*. Ama, për rusin Leskov dhe për veprën e tij Benjamin fliste shumë pak. Ishte arti i rrëfimit argumenti i vërtetë i esesë. Ky i fundit, sipas filozofit, po zhdukej pak nga pak në Europën e cila në mënyrë të pashmangshme po shkonte drejt Luftës së Dytë Botërore. Vështirë se dikush mund të tregonte mirë një fakt që kishte edhe vlerë njohëse, veç asaj digjetike. Në fakt, Benjamin e dinte shumë mirë se rrëfime tepër bindëse po ndotnin epokën e tij. Si hebre,

ai kishte paguar personalisht për disa prej tyre. Po atëherë pse e shpallte të vdekur aftësinë për të rrëfyer? Sepse, sipas këndvështrimit të tij, letërsia e kishte tradhtuar dhuntinë e vet. Nuk kishte një etikë të fortë që ndriçonte historitë bashkëkohore, përkundrazi, ato ishin gjithmonë tendencioze dhe të frymëzuara së pari nga arti i bindjes, dhe, më tej, nga ai i demonstrimit. I vetmi model narrativ i mundshëm – një narrativë autentike, reale, e pa kompromentuar nga pushteti totalitar – ishte për Benjamin ai i shoqërive arkaike. Pra, një mënyrë tregimi në të cilën përvoja, etika dhe komuniteti ishin, për nga natyra, të pandashme.

Artur Spanjollit duket se do të nisë nga ky model në vitin 2003, kur pas një procesi editorial mjaft të përpunuar, arrin në botimin e tij të parë në Itali me romanin *Cronaca di una vita in silenzio*, falë mbështetjes së shtëpisë botuese Besa të Livio Mucit. Bëhet fjalë për një sagë të vërtetë familjare, që do të pasohet në vitet në vijim nga *La Teqja* (2006) dhe *Preludio di autunno* (2018). Në këtë sagë Spanjollit kryen, nëpërmjet rrëfimtari të tij tipik, një rrugëtim të gjatë nëpër kujtesën historike të Shqipërisë, në përpjekje për të mbajtur në ekuilibër peripecitë e klanit Cialliku dhe patriarkut të tij Lala-Meta, unazë e vërtetë lidhëse mes së tashmes dhe së shkuarës në të tre romanet. Ambientimet luhaten midis ekstremeve të shekullit të Nëntëmbëdhjetë për të mbërritur deri në vitet e mbretit Zog, e më tej, deri në periudhën e gjatë të dominuar nga Enver Hoxha, në një bastisje kohore që ka për qëllim të ngrejë në model drejtësinë morale të disa anëtarëve të sistemit të ndërlkuar të personazheve. Përveç Lala-Metës, paraardhës i një brezi fëmijësh që rrëfihen individualisht në Prelud, gjejmë shumë figura pozitive, të afta të mishërojnë vlerat e një shoqërie të virtytshme të përkushtuar ndaj punës dhe lutjes, si dhe ndaj respektit për të tjerët. Është rasti, mes të tjerësh, i Rasulit të braktisur, një falltar jetim në gjendje të theërsë shpirta të mirë, si dhe i Hysenit, njeri i mençur e mbartës i një kulture të thellë, asaj të jugut shqiptar mysliman, që Spanjollit mbron në shumë raste me krenari ndaj thjeshtimeve të stilit perëndimor.

Është një opinion i përhapur në botën e

kritikës letrare italiane dhe ndërkombëtare se në fund të viteve Nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, qëndrimi postmodernist që kishte karakterizuar mënyrën e tregimit të atyre kohërave, hyri në një krizë të pakapërcyeshme, i zëvendësuar nga një rikthim i dukshëm në realitet. Në atë kontekst, duke nisur nga disa romane të mëdha të zonës amerikane (*Underworld* i Don DeLillo dhe *American Pastoral* i Philip Roth, të dy të vitit 1997, të pasuar nga *The corrections* i Jonathan Franzen në vitin 2001), zhanri i romanit familjar, e bashkë me të sugjestionin për të gërrshetuar ngjarje private përgjatë një linje kohore të zgjeruar që shpesh përkonte me disa nyje kyçe të historisë politike, përfaqësoi një zgjidhje fatlume dhe të shpesh përdorur, e aftë për të risjellë kuptimet e thella të lidhura me aktin e të treguarit. Spanjollit, me projektin e trilogjisë Cialliku, gjen një rrugë shprehjeje origjinale duke dimostruar të dijë të dialogojë me një stinë në të cilën letërsisë i besohet sërish një vlerë interpretuese. Ai arrin të krijojë, ndonëse në shenjë ndryshimi, një vazhdimësi me një strukturë narrative të rikthyer papritmas në modë në fillimshekullin e ri. Domethënë, ai përdor romanin historik, në variantin e tij familjar siç përmenda, të lidhur me ecurinë e brezave, për t'i dhënë liri imagjinatës së tij. Në vend të së tashmes, ai kthehet në drejtim të së kaluarës arkaike të tokës së tij, në kontrast të plotë me përvojat e shumë bashkëmoshatarëve të vet, autorë italoфонonë të cilët kishin zgjedhur dëshminë dhe ndonjëherë edhe shpërfaqjen e përvojës personale, për t'u shfaqur në tregun botues. Prandaj do të doja të përpiqesha të kushtoja një reflektim të mëtejshëm në lidhje me arsyet dhe implikimet e kësaj zgjedhjeje.

**Mes kronikës dhe etnografisë. Toposi i nuses së mallkuar.**

Frekuentimi nga ana e Spanjollit i botës folklorike proto-shqiptare dhe në përgjithësi ballkanike, është këmbëngulës dhe fitimprurës. Një rrjet kompleks marrëdhëniesh socio-kulturore rindërtohet me aftësinë e etnografit në tregimet e vëna në skenë nga autori, duke treguar se sa e thellë është lidhja midis llojit të komunitetit që ai preferon të rrëfejë – duke filluar siç e pamë nga saga e familjes Cialliku – dhe bashkësisë së arketipeve që burojnë nga lashtësia e këtyre trojeve. Kur flitet për letërsi shqipe, dhe rrjedhimisht për imagjinatë narrative që përdoren si referenca për këtë lloj tregimi, haset gjithmonë një lloj kontradikte në terma: nga njëra anë jemi të vetëdijshëm se Shqipëria traditën e shkruar e krijoi me vonesë të dukshme krahasuar me vendet e tjera të zonës europiane; nga ana tjetër, megjithatë, nuk mund të anashkalojmë pasurinë e trashëgimisë gojore. Është i njëjti pasazh që kryhet që prej gjysmës së dytë të shekullit të Njëzetë nga një mjeshtër i romanit si Kadare: duke qenë se vendit i mungonte zakoni shekullor i të shkruarit, traditat popullore kanë përfaqësuar një rezervuar të sigurt nga ku mund të nxirrej një burim i jashtëzakonshëm frymëzimi drejt të cilit shkrimtari mund të orientohej, edhe me synimin për të ndërtuar ura që kapërcejnë kohën dhe krijojnë lidhje me situata historike dhe politike analoge të botës bashkëkohore. Bëhet fjalë – si në rastin e Spanjollit i cili në këtë aspekt ka ripërshkuar nga afër gjurmët e më të mirit Kadare – për t'iu referuar një



imagjinari gjerësisht të përhapur e konotuar në drejtim të vlerave thellësisht identitare. Për këtë arsye – më lejoni një digresion mbi sensin më të thellë të trashëgimisë që figura kryesore e referimit e letërsisë shqiptare është në gjendje t'i lërë brezave të ardhshëm – shkrimtaria e Kadaresë ka qenë lumturisht hibride që nga fillimi i viteve Gjashtëdhjetë të shekullit të Njëzetë, e rrënjësuar në kujtesën e kohëve më të lashta e njëkohësisht e futur në mënyrë të përsosur në një klimë bashkëkohore dhe ndërkombëtare, deri në atë pikë sa për ta kuptuar nevojiten mjetet e kritikës letrare si dhe ato të studimit të folklorit.

Spanjolli, me saktësinë e një kronisti që i qëndron besnik fakteve, futet në hullinë e thellë të gjurmuar nga Kadare, duke treguar se është i aftë të lërë një shenjë personale, si provë e një imagjinari individual të pasur me shpikshmëri dhe figura të denja për t'u mbajtur mend. Nga ripërdorimi nga ana e tij i materialeve të frymëzimit popullor, vihet në dukje një Shqipëri e ndalur në kohë, ose më saktë, e mbrojtur nga kalimi i stinëve të ndryshme historiko-politike. Një Shqipëri që mund të përkufizohet si e përjetshme, e lidhur më tepër me ndërrimin e cikleve natyrore dhe e frymëzuar nga thirrja misterioze e dimensionit të botës tjetër më shumë sesa nga elementi kalimtar i pushtetit politik. Mbreti Zog, në këtë skenar, është njësoj si Hoxha ose si drejtuesit demokratë që do të pasojnë momentin emocionues të rënies së regjimit; një sfond i thjeshtë, i cili nuk ndikon në zhvillimet e ngjarjeve personale, të konsideruara më të rëndësishme dhe mbizotëruese në lidhje me planin e historisë së madhe. Te *La sposa rapita* (2011) Spanjolli kryen, në kuadër të magjisterit kadarean, një operacion kulturor dhe narrativ mjaft interesant, duke rikuperuar temën e njërës prej baladave ballkanike më të përhapura dhe me më shumë variante – asaj fantastiko-mitologjike të kortezhit të dasmës së nuses së ndjerë – dhe duke e hibridizuar me sugjerime *noir* dhe *giallo*, njësoj siç kishte ndodhur me kryeveprën e vitit 1979 *Kush e solli Doruntinën*. Historia është arketipale: do t'i kthehem më në detaje më vonë, por romani fokusohet në temën e njohur të çiftit të ri, Asllanit dhe Lulietës, të cilët nuk mund të dashurohen në dritën e diellit për shkak të një vullneti atësor i cili ka vendosur për një martesë të rregulluar nga familjet. Nëse epilogu është tragjik, siç mund të pritej, nuk duhet anashkaluar këndvështrimi përmes së cilit Spanjolli zgjedh të rrëfjë historinë. Mënyra e organizimit të tregimit përkon me një filter etnografik, që parashikon një studim të thellë të zakoneve dhe traditave shoqërore të ndjekura që nga kohërat e lashta. Nuk është rastësi që në një moment shfaqet figura e një studiuesit dhe fotografit francez, Alain, i cili udhëton nëpër Ballkan me synimin për të dokumentuar përmes materialeve të pabotuara më parë zakonet e një bote rurale ende pak të studiuar në Perëndim. Pas kësaj pranije të huaj qëndron vështrimi etnografik i Spanjollit, i cili synon t'u japë zë aspekteve që kanë mbetur të fshehura në rrudhat e një oraliteti të humbur sot.

#### Veçantia e montazhit narrativ

Veprat e Artur Spanjollit shquhen për një sens të jashtëzakonshëm strukture. Nëse, që me triologjinë e tij autori u dimostrua i aftë të zhvendoste në disa libra një projekt të një shkalle të gjerë, i pasur në referenca mes grupeve përsonazhesh të ndryshëm dhe rrethanash të vendosura në distanca të largëta kohore, është po ashtu e vërtetë që ndërgjegjësimi mbi një mekanizëm narrativ që ruhet e që përbëhet nga detaje tepër koherente takohet në të gjitha romanet e tij. Po përmend si shembull përsëritjen e numrit nëntë, një lloj obsesioni kabalist që përshkon shumë nga veprat e Spanjollit: nëntë janë rrëfimtaret në çerek orëshin e heshtjes në funeralin e të ndjerit në *Cronaca di una vita in silenzio*; nëntë janë mbrëmjet në të cilat lexohet ditari i tolerancës dhe të drejtit Hysen Cialliku në *La Teqja*; nëntë janë shoqëruesit e Daljallisit kur hapin me forcë derën e mullirit pasi kanë organizuar arratinë e Lulietës në *La*



*sposa rapita*; nëntë janë engjëjt që fluturojnë në ëndërrën me sy hapur të Eduartit. Pa dashur ta teproj me ushtrimin steril të virtuozeve të kritik, është mirë të kujtojmë se që nga kohët e lashta numri 9 ka qenë numri që aludon për trinitetin dhe ciklikitetin e jetës, në një shumë të kthyeshme të numrit të përsosur. Tregon një gjendje që kthehet gjithmonë në atë të mëparshmen pa u transformuar kurrë deri në fund, duke ruajtur një status të pandryshueshëm.

Përtej këtij sqarimi, ngelet domethënësi fakti që një detaj i vogël narrativ arrin të transmetojë në mënyrë trasversale në shumë vepra një ndjenjë të tillë koherence të brendshme. Por, është në teknikën e montazhit që Spanjolli tregon një kujdes të pazakontë jo vetëm për vendosjen e rrafshëve të rrëfimit, por, dhe mbi të gjitha, një ndërgjegjësim gjithnjë të ri për përzgjedhjen e tensionit. Në fakt, shumë shpesh, ngjarjet fillimisht dekompozohen dhe hiqen nga sekuenca kohore progresive me qëllim që të rrëfihen në mënyrë të zbërthyer dhe që vëmendja e lexuesit të mbetet vigjilente; atij i kërkohet të përcaktojë momentin *para* dhe *pas* ndodhisë, pa kërkuar bashkëpunimin e hapur të rrëfimtari. Në mbështetje të këtij vëzhgimi, po përmend teknikën me të cilën kryhet montimi i kapitujve te *La sposa rapita*. Këtu aftësia për të çmontuar, të cilës iu referova, bëhet e jashtëzakonshme, duke e bërë leximin tej mase tërheqës. Siç e pamë, dy protagonistët, Lulieta dhe Asllan, e duan njëri-tjetrin fshehurazi nga vullneti i familjeve dhe arratisen në kërkim të një strehimi riparues. Ndërkohë, dasma me shkuesi e Lulietës me bashkëshortin e saj zyrtar, të cilit i është premtuar që në fëmijëri, është në prag festimi. Njëkohësisht, gjatë arratisjes së të rinjve krijohet një ngërç i stilit meksikan, ku, brenda një mulliri gjysmë të rrënuar, klanet të cilave i përkasin dy të dashuruarit përballen me njëri-tjetrin në një negociatë të armatosur të drejtuar nga i mençuri Kadri, plaku i fshatit.



Mirë. Tre segmentet rrëfyes shkrihen në një dialog të vazhdueshëm; variablat kohorë mbivendosen duke eliminuar marrëdhënien shkak-pasojë mes *para* dhe *mbra*. Rezultati është një paraqitje kinematografike që rezulton e efektshme edhe në faqet e librit, për të cilën teknika e fushave të gjata, e planeve-sequencë dhe e planit të parë ndjekin njëra-tjetrën në një lojë perspektive me të vërtetë të suksesshme. Por, është përpara përfundimit tragjik – i dhimbshëm, por në gjendje të rivendosë ekuilibrin shoqëror të shkelur nga dashuria klandestine e të rinjve – që Spanjolli vendos të na dhurojë një goditje të fundit teatri. Në kulmin e tensionit, futet një kapitull që në dukje nuk ka lidhje me historinë kryesore, i cili tregon për natën e seksit të përjetuar me disa vajza në haremën e tij nga i pangopuri dhe i pakëndshmi Halit Beu. Edhe një herë, vetëdija e lexuesit shkon krah për krah me fabulën, e gjitha në përfitim të plotë të rezultatit përfundimtar të tregimit.

#### Beharet e Eduartit dhe Andit.

Shkrimtaria e Spanjollit, siç dëshmohet nga artikulet e karrierës së tij letrare, rrallëherë ka dashur të përzihet me rrëmujën e së tashmes. Përkundrazi, ajo ka gjetur një dimension të pëlqyeshëm në të kaluarën, duke ruajtur një marrëdhënie intensive me ato tradita gojore që kam përmendur disa herë më sipër. Është megjithatë e vërtetë se në të paktën dy raste ai tenton një manovër diversioni në lidhje me këtë interes, i cili ngelet mbizotërues në vlerësimin e përgjithshëm të shkrimeve të tij. Përkatesisht në vitet 2005 me *Eduart* dhe 2012 me *I nipoti di Scanderbeg* gjejmë ambiente shumë më afër bashkëkohores, me skenarë që e bëjnë edhe më të artikuluar leximin e këtij autori. *Eduart*, i vendosur në periudhën e tranzicionit pas rënies së regjimit, rrëfen një situatë perfekte për një roman psikologjik dhe intimist, tradita e shekullit të Njëzetë e të cilit ka hasur gjithmonë pak fat



në Shqipëri. Eduarti i ri është i dashuruar me Eugjeninë, më shumë një prani virtuale dhe e idealizuar sesa një figurë femërore me mish e gjak. Falë talentit të tij letrar dhe poetik, ai arrin të largohet nga vendi për t'u zhvendosur në Perëndim, ku bën përvojat e veta dhe pasuron bagazhin kulturor. Por mendja e tij kthehet gjithmonë te Eugjenia, një simulakër e vërtetë e një stine rinore të përfunduar shumë shpejt. Dhe pikërisht për këtë arsye, gjatë një vere në të cilën vendet e fëmijërisë i duken pothuajse të panjohura, Eduarti, sapo kthehet në shtëpi, takon për herë të fundit, në një ëndërr sentimentale me sy hapur, Eugjeninë, në një dialog ku sugjestionimeve kulturore e piktoreske të shekullit të Nëntëmbëdhjetë u mbivendoset, në një përzierje të arrirë, muzika pop e mbërritur tashmë edhe në Shqipëri për të kolonizuar shijet dhe preferencat dëgjimore.

Dikush mund të shkojë madje aq larg sa të lexojë në figurën e idealizuar të Eugjenisë dhe në marrëdhënien e pashijuar të dashurisë, një projektion alegorik. Eugjenia është – mund të lexohet – vetë Shqipëria postkomuniste; një premtim i përcaktuar bukurie dhe dashurie për brezin e njëzetvjeçarëve të fillimviteve Nëntëdhjetë. Një ëndërr, një përqaftim i pambërritur kurrë për ata që zgjedhën të shpërngulen diku tjetër dhe të provojnë fatin e tyre në vende dhe kultura më të gatshme për të pranuar dëshirën për sfida dhe ringritje personale të këtyre të rinjve.

Së fundmi, me *I nipoti di Scanderbeg*, Spanjolli i rikthehet kronikës, këtë herë e nëkuptuar më shumë në derivimin e saj gazetaresk. Romani tregon me një vështrim mjaft aseptik aventurën e Andit dhe të mijëra personave që, pasi hipën në bordin e anijes Vlora në portin e Durrësit, ngelen të bllokuar në Stadiumin e Barit, në pritje që autoritetet italiane të vendosnin t'i riatdhesonin. Është e premte, 9 gusht 1991. Ajo fundjavë e zjarrtë dhe e padurueshme, përshkohet nga protagonistit dhe uni rrëfimtari me një përzierje konsideratash personale dhe mikro ngjarjesh që arrijnë të transmetojnë gjithë dramën e atyre momenteve, të ngelura të gdhendura përgjithmonë në kujtesën historike të popullit shqiptar. Andi është uni rrëfyes, njëkohësisht dëshimtar i asaj tentative eksodi të pasuksesshme. Ai dëshiron mbi të gjitha të kuptojë. I ulur në shkallët e stadiumit pret artikuj nga gazetatat, dhe, me ndihmën e një fjalori, provon të depërtojë një gjuhë që nuk e ka bërë ende të vetën.

Ëndrra e Vëndit të Mrekullive, përcjellë nga ikonat kombëtare popullore të kohës (Pippo Baudo, Albano Carrisi, Lucio Dalla, Renato Zero, Scorpions) përplaslet me mbylljen e një shoqërie që duket se mbrohet dhe tregon anën e saj më armiqësore pasi nuk është ende gati të mirëpresë valën e grupeve etnike që po fillonte pikërisht në atë moment të ndryshonte ekuilibrat identitarë për siç i kishin njohur vetë italianët deri në atë moment. Nga rrëfimet e shumta të asaj faze kalimtare, *I nipoti* përfaqëson padyshim një dokument efektiv dhe joretorik, në të cilin pjesëmarrja është më e racionalë sesa emocionale, dhe për rrjedhojë edhe më e çmuar në kuadrin e kuptimit të veprës.

Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e veprave të Spanjollit e bëjnë atë një nga zërat më interesantë të skenës italofone, të vetmin të cilit i është kushtuar një monografi ekskluzive në bibliografinë kritike, shkruar nga profesor Karol Karp nën titullin *Viaggio, cultura e identità: La Produzione Migrante Di Artur Spanjolli* (Roma, Aracne 2016). Arturi prej disa vitesh i është rikthyer rrëfimit në gjuhën shqipe. Shpresoj që kjo zgjedhje krejtësisht legjitime të mos jetë tregues i humbjes së interesit dhe besimit tek publiku lexues në gjuhën italiane. Kemi ende nevojë të lexojmë historitë e tij, si dhe të zbulojmë se deri në çfarë mase një imagjinari kaq i pasur me sugjestionime është në gjendje të përtërihet përballë sfidës së një periudhe bashkëkohore, e cila sigurisht përshkohet nga instanca të ndryshme kulturore krahasuar me momentin në të cilin Spanjolli filloi të shkruante.

*Përktheu nga italishtja Kriselda Beqaj*

## Midis Columbus dhe Amsterdam-it në 74-ën

1.

Në xhamishtet anë udhës po pushojnë krokodilë,  
sytë s'u duken nën kapakët se po vdesin, se po flenë,  
se po rrojnë e s'po tregojnë nën ujëngrohtë të s'lëviz,  
fatur bishtat midis tokëzash dhe në zava ngecur luspat,  
gërma-numrat rreth e rreth nuk e thonë gjithë të vërtetën,  
jo se s'duan, por se s'mundin që të duan pa u zgjuar,  
mahmûr gërmat rrjedhin muresh si një zift që po kthen  
mendje,  
si qyteti që për avull bëhet gati t'avullojë  
si një re e bardhë vapori që do niset për s'diku,  
të mbushë qiellin plot me re dhe me avuj metropolesh,  
diku lart që të takohen Roma, Praga dhe Tirana,  
të ngarkuara me gjuhë mbi ca pllaja pavetore  
shkrepëtimën eks ta kthejnë e të bien si një shi  
në pavende e askunde, një qytet të ri të mbjellin  
me rrebeshet e pasditës...

2.

Ca gëzime prej hienash lanë karkasa prej sedanësh,  
gjak i hijes me rrëkeza gri mbi lulet ja po thahet,  
kore' hijes ngadalë bie dhe me dregëza mbushet rruga  
gati për të reja plagë, tokmakë hapash të parreshtur  
trotuarëve që rrëshqasin të lëkurtë kundër ecjes,  
kalimtarë të njëjtë baresin, venë pa shkuar, shkojnë pa  
ikur,  
ndërsa mua s'më merr rrjedha, se kam mbirë si dru pahiri,  
anë rrugës që të shoh mos ti vjen e mos ti shkon,  
mos një njomë më dërgon,  
por kjo rrugë kursen inxhitë, i mban ndryrë me krokodilë  
e qen racash të xhan xhinit dhe qepenët e pasmuzgut,  
koka fati, flokë dyshimi, trungje sjell një lumë i ngurtë,  
si proverb kinez një bregu e kap çastin siç më kap,  
me faninë tënde të vjetër, gjerdan perlash në qafë ujku,  
valëvi mëndafshi verdhur nëpër ditë më të mira  
ku unë sqeshë, por ku do desha që të isha posi kulpra  
mbi një mur të ftohtë mosdashjesh,  
gishta-gjethet duke prehur para se t'mi presë era,  
tek ti shkon duke ikur, i zgjas krahët pa dobi,  
gijotin' e qoshit k'puti fillin tënd, vëthin e gjatë  
filigram mbi karrotidë, dhe sedefi yt rruezash  
firon xhepave të udhës,  
humbje' dekretuar trungut tim prej rrapi për fermane,  
s'të ndjek dot, mallkim i drurit, fort më mban lidhur për  
dheri.

## Kafene e NYU-së

Kafene e NYU-së ku kuptova të plakurit  
Në mes të ca studenteve që dot s'u vardisesha,  
Gjermë atë çast më duhej veç të doja,  
Syri filxhan më pa në sy:  
Je ende i pëlqyeshëm, tha,  
Çfarë ke?  
Si i dënuari kapital gjellën e fundit  
Doja edhe një dashuri të lehtë,  
Ku si lumturia dhe trishtiti  
S'ta kanë seriozisht,  
Ajme, qe vonë,  
Një bordero më kish futur në kllapat e veta,  
Kufizë të varur nga të tjera kufiza,  
Tani kish vetëm mërzi të vërteta  
Matematike  
Dhe parvaze që kuptonin  
Uritur për bërlylat e tu,  
Mëllaga që aq mirë dinin të dëgjonin.  
Starbucks i NYU-së  
Që gjithë karbonet m'i gjysmëzbërtheve,  
Më dëfteve gjysmën e jetës,  
Ajme, atë më të bukurën!  
Kafene e NYU-së ku kuptova të plagurit.

## West

Një han i mbuluar nga pluhura mikash,  
Sini e hënës pjerrur  
Derdh një rërë sedefe,  
Kaktusë të habitur me çudi prej plaku:  
Të thatët u ftoh  
Dhe eshtra e savanës është krisur diku.  
Jakia rrjedh e çelët në përrenj bizonë,



# Shkëlqim Çela Shtegu Apalash

Është vonë, është vonë.  
Kjo rrafshnaltë ngjan si Kolorado kështu,  
Veç vjen ca më e hequr.  
Karvane me allçi të ngrira anë shuajsh,  
Si imitim dëbore,  
Nuk duan të ndalojnë.  
Në parvaz dritareje një muri pjesor,  
Se dhome, se avllije,  
Një mëllagë plastike bleron e paepur:  
Kësaj here qytetërimi pat metropole gri,  
Dhe metafora ujëse.  
Shoh si ikin format,  
Përmbysjet e mëdha  
Vijnë dhe si pragje hanesh  
Ku nuk bujt njeri,  
Besoj në katastrofat – madhështi prej gunash  
Përmbi evolucion,  
Në kohën mbledhur shuk  
Flakur pa kujdes,  
Si tash e padobi.  
Avionet janë pa kthim,  
Koha plak më shpejt  
Një pleqëri të thatë, si pyetje pa vend.  
Emrin? Ljapunov.  
Haxhiu është dyshues. Priste Çehov.  
Një katastrofë pa rus  
Nuk është katastrofë.  
Arratitë të gjitha  
Drejt zonash kohore,  
Bizoni i fundit mbetur këtu  
Na përket me rusin  
Plot me histori  
Që vlejnë të rrëfihen  
Një herë të fundit.  
Edhe pse, a mbase shi sepse,  
Në gjuhë të pakuptueshme.

## Shtegu Apalash

Në Blue Ridge Mountains, ku nisin malet,  
Djaloshin tek rripat shtrëngoi unë pashë,  
Po nisej për rrugën me muaj të gjatë,  
Po nisej Shtegut Apalash.

Do ikte në këmbë udhë e pa udhë,  
Vetëm me drurët dhe zogitë larashë,  
Po nisej djalosh të soste si burrë,  
Po merrte për Shtegun e gjatë Apalash.

Doja t'i thosha kujdes e këshillë,  
Por diç më mbajti dhe gjë nuk i thashë,  
Unë udhë në jetë kisha bërë shumë,  
Po jo ama Shtegun pa fund Apalash.

Kur dola në botë u shfaq viktimitë,  
Të zgjoja keqardhje, mëshirë, Karitas,  
Argasur rrugicash me mure të grirë,  
Por jo ama Shtegut të gjatë Apalash.

Mësuar të shaja mexhllis-shoqërinë  
Isha, dhe zyrat e shtetit abrash,  
Në mbrëmje tek ktheja shaja shtëpinë,  
Ama s'flija nën yje dhe pyje përjashtë.

Për këmbët e lagura doja mangall,  
Për gjumin viran rrëfenjë të avashtë,  
Kur e kur zëmekur e kur e kur tellall,  
Bir thashethushi e bir-llafe-grash.

Bir në zarin pafat nëpër tavlla  
Duhani, lektisur për kollën e vrazhdë,  
Në pragje veremi, ankim e pallavra,  
Ripërtypës kuitjesh mbi kashtë e nën grazhd.

Lidhëse nuk kisha të shtëngoja këpucë,  
Çizme marshimi e rripa të trashë,  
Një sprovë të nderhme që në qofsh burrë  
Përshkoje i vetëm Shtegun Apalash.

Nga vendi me forë se vija u mburra,  
Ku ferrit i bien, siç thonë, pash më pash,  
Ku veç mbijetohet, por kund s'mbërrin kurrë,  
Si burrat e bërë Shtegut Apalash.

Doja të lidhja kapistall e ushkure,  
Çantën e shpinës, udha-mbarë e mirë-ardhsh,  
Veten ta masja me vlerë lëkure,  
E tëmthi e zemre Shtegut Apalash.

Më mbajti një fre, një thinjë e surdinë,  
Një zgjedhë e vjetër prej kau balash,  
Një pendë qe që tërheqin një këmbëz martinë,  
Dyfeku i plasur, patickë a kallash.

Në Blue Ridge Mountains, ku nisin malet,  
Veten që dot s'u bëra unë pashë,  
Po nisej për rrugën me muaj të gjatë,  
Po nisej Shtegut pa fund Apalash.

## Pier i - Upper West Side

Një lule' rrëzuar  
Po rikthehet në degë... oh jo!  
Ish një flutur e bardhë.  
(Moritake)

Statujë e lirisë pishtarin  
shuan në ujëra të kripur,  
në klorure botësh prish magji të zeza.

Të mbytet kjo hënë mbi Hudson pa të iki;  
ndryrë mes brigeve brerës të shteteve ujët  
valëza llurbe si fjalëza turpe përvjel;

lëpin këmbët hamalle përveshur në gjunj të urës  
që lëkundet mbi valët e shtangëta,  
një rrugë e egër fluturon mbi krye -  
duket po ndërrojnë stinët në Riverside Drive.

Ngjyrën e sotme të Empire State Building deshifrojmë,  
argjendin e reve tej mbi Harlem...  
Çudi si bie nata mbi gollgane gurësh ciklopikë e s'vritet,  
në qiejt e rrokur nga llërë të xhamta  
shuhet pa mbarim një mall i zbehtë prusie.  
Bluja na shkon me keqardhjen flu.

Pista ecën penduar në det si krah pa qafim,  
unë plotës i saj, përqaftim pa krah.

Në ka një çështje, ajo është gjithnjë diku gjetkë:  
erdhi një muaj mes shkurtit dhe marsit,

koha që duhej t’ishim të arrirë,  
edhe qemë,  
si fjalë e qëlluar në një lajm të djeshëm.

Versaja feks ndërsa myk i mërzisë përthith bodrumet.  
Sheshet na përkisnin shkretisht,  
si stok i keq u rrëgjua luks’ i vetmisë,  
flori i nxirë që nuk e mban premtimin çdo perëndim.

Harresa ia behu si Mikelanxhelo i lodhur,  
qytetin e mbushi monumente;

pranë pa prani, një kafe të fortë  
si për mjeshtër, o për vaki,  
si kur vdes njeri.

Ajo globin shkuli nga rreth i Kolombit,  
statujën e radhës e nguli aty,  
dy fasha drite nga sytë e hienës  
e fshikën që prej hyrjes qeshire të Parkut Qendror.

Xhadë mermeri! Murmur sytë.  
Mbi dashurorët e thjeshtë në pikëpjekje  
hedh shikimin e vrerët nga ligësi e cimirët  
e gurit në zemër.

Leaving Los Angeles

Më tej se atje nuk kishe ku shkoje  
Pa ndërruar univers dhe specie.  
Avioni largohet si blea nga lulja e kaktusit.  
Katër korda qiellore kaptuar do mbetet pas diku në ije të  
dheut  
Përskuqur si gjak a rubin,  
Shumë luksoz si plagë dhe shumë plagë si luks, LA.

New York State of mind

Lokomotivat tona u nisën në drejtime të kundërta  
Duke djegur qymyr të zi.  
S’kish nevojë për gjeometri joeuklidiane:  
Tre këndet e pubisit nuk bënin 180 gradë.  
Orët e bukura  
Të dikurshme,  
U strukën  
Hebrenj të trembur postpubertarë  
Që shkruanin ditarë.  
SS shfaqej në shqip mohim i mohimit,  
Dialektike çizmesh binomiale.  
Në pikëhyrjet  
E shpirtit,  
Mbyllur me trarë të rëndë sedrash,  
Kujtimet, hileqarë,  
Bënin doganierë të korruptuar.  
Nga sqetulla e dimrit  
Shpërtheu  
Pranverisht një nespull,  
Por unë qeshë i lodhur,  
Një re shtatzënë,  
Krah i mollës në vjeshtën e vonë,  
Afishë e një filmi të vjetër që nuk e heq kush,  
Trupi i një rrugice nate  
Që don të flerë, po sytë e pëllgjeve s’e lënë.

Postë e parfumuar? Jo më. Pres letra me antraks.  
Shakatë nuk shkojnë si kostume Charitas-i:  
Si mund të ngrihesh kur Dou Xhonsi ulet?  
Molla e Madhe që bie  
Zbulon  
Veç rënien e lirë  
Gravitacionale të bursës  
Sot;

Uashingtoni dhe viagra bëhen shoqërim idesh.  
Shakatë vazhdojnë më pavend se këshillat e Suz Orman-it:  
Të pabesa vajzat dhe aksionet.  
...E megjithë fushatën anti-abort kjo ditë dështoi,  
Era mbledh retë e përflakura rrëmuqshëm  
Si pastruesja e klinikës kirurgjike garzat e përgjakura,  
Fletushkat e fushatës zgjedhore,  
Aksionet e zhvlerësuar  
Që nesër do zhvlerësohen prapë,  
Ta bëjnë të sotmen dështake  
Sukses  
Para mynxyrës që vjen.

Mori bursë, moj mizore,

Shumë u duke, pak na dole,  
Kurvëzohen bakshishet për kamarierët,  
Bujaria tek e fundit s’qenkësh karakter por ekonomi,  
Distrikti financiar merr befaz diçka armiqësore  
Në rrugicat as drejtvizore, as numerike, po me kalldrëm  
Të kohëve kur Ingliterra ish Mbretëreshë e Detrave.  
“Sa e mbajti lulja erën  
Aq e mbajti stoku vlerën”,  
Askush nuk këndon,  
Gavroshi nuk dinte inglishtet,  
Thjesht një këngë e vjetër gabelësh  
U përkthye nga googlat e trurit:  
“Sa e mbajti bari vesën  
Aq e mbajti jevgu besën”...  
Oh, një stok të zhvlerësuar  
Vërma mbi të çarën e zemrës  
Për leukoplast.

Çdo urë bëhet një mundësi për arrati,  
Jo për bashkim.  
Dhe sa paskam nevojë për arratisje!  
Sidomos nga kujtimi yt  
Numizmatik,  
Që dot nuk e zhvlerësoj  
Me gjithë grykësinë time  
Egoiste,  
Edhe pse dashurinë ta besova  
Si kredit të keq.

\*\*\*

Çdo krizë kujton se është epokale,  
Ja si më mbështjell natë e tetorit,  
Jorgan i zi,  
Stavë mbyttëse;  
Epokale - ja,  
Pas kohës tënde  
Me skllavëri,  
Zinxhirë përkushtimesh,  
Behu mesjeta  
Me robëri malli,  
Mbasdite feudale,  
Kulla ngujimi e manastire guri,  
Ku krenitë i ruheshin  
Dobësive gjakse;  
Pastaj kapitalizmi  
Qartësoi:  
Prangat - e vetmja pasuri  
E vlerë për t’u humbur;  
Pa vargonj malli -  
Zero komuniste,  
Postmoderniste,  
Flokët lyer me sarkazëm  
Të ngrirë  
Antigravitacioniste;

Arratisem  
Të t’harroj  
Në dhomën e motelit të parapëlqyer  
Diku në upstate,  
Gazeta është e djeshme  
Mbi komo,  
Dhe vajza është e djeshme,  
Mbi kanape,  
Lajme të shtrydhur,  
Gjoks i lexuar,  
Magma u ftoh,  
U ngurtësua  
Në shtrat granitik,  
Çarçafët të shtangët vrasin bërrylat dhe gjunjtë,  
Gjithë pikat inf(l)ektive të trupit,  
Ndërsa dysheku është shkëmbi amnor  
I gjithë të këqiave  
Tokëformuese.

Shije dheu acid.  
Ndaloj një taksì,  
Të sëmurë me verdhëz,  
Veç që t’i përgjigjem me mllef pyetjes “për ku”,  
Al Paçino dhe Migjen  
Njëkohësisht:  
To Hell!  
E di që jam vonë për atje  
Si pasagjeri me xhetleg  
Që s’kupton kush ia vodhi orët,  
Ato orët  
Që duhej t’ishin të lumtura  
Pikërisht ngaqë u vodhën.

Botim i ri nga Minerva

ETHAN KROSS,

ZËRI NË

KOKËN TONË:

PSE ËSHTË I RËNDË-

SISHËM DHE SI TË

PËRFITOJMË PREJ TIJ?

Zëri në kokën tonë

Pse është i rëndësishëm

dhe si të përfitojmë prej tij?

Ethan Kross

Minerva

“Një kryevepër. Kjo është një pikë referimi që do të ndryshojë mënyrën e konceptimit tuaj për natyrën njerëzore.”  
– Angela Duckworth, autore e librit “Forca e karakterit”

“Një udhëzues praktik për të normalizuar ankthin dhe për t’u distancuar prej tij.”  
- Harvard Business Review

“Në zërin tonë të brendshëm zbulojmë diçka thellësisht misterioze, madje të mahnitshme. Autori ofron ide të shkëlqyera për menaxhimin dhe kontrollin e zërit të brendshëm.”  
– The New Yorker

“A ka mënyra të drejta dhe të gabuara për të komunikuar me veten? Nëse po, a ka teknika që mund të përdoren në mënyrë të dobishme nga ata që i shqetëson monologu i brendshëm? Autori Ethan Kross hedh dritë mbi këto dilema. Është momenti i duhur për të botuar këtë libër.”  
- The Guardian

“Në këtë libër shqyrtohet fuqia që zotërojmë për të përfituar nga mendimet tona pozitive dhe negative përmes bisedave që bëjmë me veten.”  
- CNN

*Qortova veten se si nuk kam gjetur ngenë të shkruaja në mos tjetër një artikull kundruës për ligjërimin e prurjet e shkrimtarit Ylljet Aliçka si porozator e si skenarist nga më prodhimtarët. Dhe, si e ka thënë bukur populli ynë i urtë: "Më mirë vonë, se kurrë!"*  
(Prej librit "Kundrime për ligjërimin artistik të disa shkrimtarëve të sotëm")

### Fjalë hyrëse

Më 16 dhjetor isha në përrurimin e librit "Gegë e Toskë" të Mustafa Nanos në UET. Kur dolëm, mbasi mbaroi përrurimi, teksa unë me time shoqe po prisnim autobusin e linjës "Qendër-Porcelan", padyshim edhe me një farë ndjesie disi të pamirë se vetëm unë nuk kisha makinë, kurse pjesëmarrësit e tjerë, përpos disa studentësh, kishin veturat e tyre, duke shikuar se mos arrinte autobusi, kalon para nesh në biçikletë dhe na përshëndet me mirësi Ylljet Aliçka, me të cilin para pak minutash kishim qenë ulur në radhët e sallës "Aula Magnia" ku u bë përrurimi i librit. Thashë me vete, me një ndjenjë disi të papërcaktueshme: "Paska edhe intelektualë të tjerë pa makinë, madje edhe të nivelit kaq të epërm ditunor e profesional" ..., por, duke sjellë në mendje, jo vetëm 49 vitet që ai ka punuar si mësues, profesor universiteti e diplomat dhe ambasador i Shqipërisë në Francë, përveçse është edhe një nga shkrimtarët më prodhimtarë e të vlerësuar të sotëm. Qortova veten se si nuk kam gjetur ngenë të shkruaja në mos tjetër një artikull kundruës për ligjërimin e prurjet e tij si porozator e si skenarist nga më prodhimtarët. Dhe, si e ka thënë bukur populli ynë i urtë: "Më mirë vonë, se kurrë!" Sapo mbërrita në shtëpi, hapa kompjuterin edhe i dhashë një sy jetëshkrimit të tij.

Fillon si mësues në fshatrat e rrethit Matit (1973-1981), pastaj jep ndihmesa të rëndësishme si ekspert didaktik e autor në Shtëpinë Botuese të Librit Shkollor (1981-1992); më pas, në periudhën mbas shndërrimeve demokratike e ndërrimit të sistemeve, Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve (1992 -1997); pastaj Përgjegjës për informacionin dhe komunikimin pranë Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë (1998- 2007); Ambasador i Shqipërisë në Francë, Portugali, Monako dhe UNESCO, përfaqësues personal i Presidentit të Republikës pranë Orgnizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (2007-2013); Profesor në Universitetin Evropian të Tiranës (2013 - 2020) dhe në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë dhe Universitetin e Arteve.

Fitues i shumë çmimeve dhe mirënjohjeve (1999 - Çmimi i parë, seksioni shkrimtar i huaj, Konkursi ndërkombëtar i tregimit, Teramo, Itali; 2000 - Çmimi i dytë, International competition Art e Letters de France, Bordeaux, France; 2001 - Penda e Argjendit, prozë, libri "Kompromisi" Ministria e Kulturës Shqiptare, Tiranë; 2002 - Prix de la francophonie, Ministria e Cështjeve Evropiane dhe Punëve të Jashtme, Tiranë; 2009 - Special prize, VII Premio Letterario Nazionale, Rome, Italy; 2012 - Penda e Argjendit, romani *Valsi i lumturisë* Ministria e Kulturës Shqiptare, Tiranë). Ylljet Aliçka është gjithashtu personaliteti i anëtarësuar në një numër të madh shoqatash e akademish, si: Anëtar themeltar i shoqatës kulturore "Fabrizio De Andre" Milano, Itali; Qytetar nderi "LA REPUBLIQUE DE MONTMARTRE", Paris, 2011; Anëtar i Akademisë Franceze "Berry-Georges Sand", Paris 2010; Anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve Frankofonë, Paris, 2012; Anëtar i Shoqatës së autorëve dramatikë dhe audiovisualë, SACD, Paris, 2006.

### Disa mbresa e shënime që duhen vijuar

Po i kthehem zakonisht tim të përvitshëm: në prag të Krishtlindjeve, zakonisht e shkruaj nga një kundrim për poetë a shkrimtarë që më pëlqejnë. Kam shkruar parëvjet për prurjet ligjërimore në poezitë e Skënder Buçpapajt, si dhe për ligjërimin poetik të Agim Vincës, para do kohe kam mbajtur një "Fjalë përruese për librin e Kadrush Radogoshit "Palimpsest Orfeik 2", botuar nga Shtëpia Botuese NACIONAL, Tiranë,

# KUNDRIME DHE SHËNIME RRETH PROZËS SË YLLJET ALIÇKA

## Nga Akademik Gjovalin Shkurtaj

2018, 131 faqe; vjet shkrova studimin "Metaforika origjinale dhe pasuria ligjërimore në poezinë e Gjekë Marinajt", që e botova më vonë dhe te "ExLibris" dhe, i trimëruar nga mirëpritja e referatit tim "Mustafa Nano adhures dhe hulumtues i zellshëm i vlerave historike e etnokulturore të shqiptarëve (Kundrime dhe vlerësime për librin i tij "Gegë e Toskë", UETPRESS, Tiranë, nëntor, 2022, 383 f.), po ma ka anda ta vijoj traditën me një kundrim për prurjet leksikore e risimet kuptimore e frazeologjike në prozën e Ylljet Aliçkës.

Në rrjedhë të moteve kam lexuar disa prej librave të tij, por në raftin e bibliotekës sime nuk i kam të gjithë. Ai ka tregime, novela e romane në gjuhën shqipe, po edhe të përkthyer në gjuhë të huaja. Në gjuhën shqipe, me sa di unë, ka botuar: *Tregime* (1998) Onufri; *Kompromisi* (2001) Onufri, *Rrëfenjë me ndërkombëtarë* (2006) OMSCA; *Parullat me gurë* (2007) Toena; *Rrëfenjë me ndërkombëtarë* (2008) Toena; *Koha e puthjeve* (2009) Toena, *Valsi i lumturisë* (2012) Toena, *Metamorfoza e një kryeqyteti* (2019) Onufri. Ndërkaq, po shkruan edhe vepra për dramatike. Pak javë më parë, Teatri Eksperimental i kryeqytetit shfaqti me sukses dramën "Luda", të cilën e pashë me shumë ëndje.

Pra, një studim për gjuhën dhe stilin e sidomos për prurjet leksikore e risimet kuptimore e frazeologjike në prozën e Ylljet Aliçkës do të kërkonte kohë të gjatë dhe përmaset e një studimi monografik për doktoraturë, që unë, me gjithë shpirt, do të uroja ta ndërmerrte ndonjë nga studiuesit e rinj, disa prej të cilëve i pashë me kënaqësi në sallën e UET-së ku u bë përrurimi i librit "Gegë e Toskë". Pashë aty, ndër të tjerë, ish-studentin tim, poetin e studiuesin Ermir Nika. Kushedi, kur ta lexojë këtë shkrim timin, mbase i prin e mbara e ia hyn një punë të tillë, të cilën unë, në shkrimin tim vetëm sa po e përpajnoj. Kohët e fundit,

meqë edhe pesha e gati 80 viteve që kam mbi supë rëndojnë, më duket se unë (po dhe krejt brezi i studiuesve tashmë jashtë "ringut") e kemi për detyrë, madje edhe për mision, të ideojmë edhe fusha e tema të rëndësishme për t'ua bërë të lakmueshme doktorantëve të rinj. Hartimi dhe botimi i studimeve të gjera filologjike për shkrimtarin e autorëve të letërisë sonë të mëparshme e të sotme është një detyrë me rëndësi dhe me vlerë për njohjen e prurjeve e prijeve të shqipes së shkruar. Sikundër ka bërë, ndër të tjerë, profesoresha Shefkije Islamaj me monografitë e saj të gjera "Gjuha e Jakov Xoxës-Veçori leksiko-semantike dhe stilistike", Prishtinë, 2000, 422 faqe; "Gjergj Fishta -Gjuha dhe stili", Prishtinë, 2012 në dy vëllime me 1100 faqe) dhe, pak muaj më parë, edhe me monografinë e gjerë "Ligjërimi, gjuha dhe stili në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2021 (829 f.).

Teksa po shfletoja librat e Ylljet Aliçkajt, ku kam shënuar fjalë, togfjalësh e frazeologjizma të veçanta, në një skedë brenda librit "Parullat" kisha shkruar me bojë të kuqe: "Fati i njeriut është një nga çudirat më të padeshifrueshme të jetës!" Dhe, ndërsa po kërkoja e rrëmoja në shënimet e mia, m'u dha të dëgjoja intervistën e Ylljetit në "Refleksione" te ABC-News dhe, ndër të tjera, ai tha se te ai roman dhe përgjithësisht në shkrimtarinë e tij ka mbështetje të madhe në përjetimet e në biografinë e vet. Ndër të tjera, ai tregoi se si veprohej për shkruarjen e parudhave në fshatin ku ai punonte si arsimtar. Natyrshëm, ashtu duke folur me vete, pa zë, përsërita thënien e urtë të italiane "Non ogni male viene per nuocere" (Jo çdo e keqe vjen për të keq.) Në vitet (1973-81) kur, ashtu si shumë intelektualë të tjerë nga Kryeqyteti, në përputhje me kriteret e punësimit të asaj kohe, autori ynë shërbeu si mësues në zonën e Matit, ku do të shihte



nga afër e me sytë e vet se çfarë ndodhte në "fshatin socialist", ndonëse atje nuk e kishin emëruar për të mirë, megjithatë, ai ka parë dhe njohur nga afër shumëçka, përjetoi dhe vetë ai, po sidomos u regj së vërejturi mundimet e përjetimet e pamira të atyre njerëzve që e fitonin bukën e gojës jo vetëm duke përballuar vështirësitë e vendit e të klimës, po edhe, mbi të gjitha, duke qenë nën trysinë e pashembullt të një politike e ideologjie pak të thuash nga më të mbrapshtat në Evropë. Kështu, ndonëse e padëshiruar dhe e padëshirueshme, ajo periudhë e qëndrimit disavjecar në një fshat malor i shërbeu shkrimtarit të ardhshëm si një "minierë floriri" për të nxjerrë edhe së andejmi tema, motive, mënyra të thëni dhe për ta vënë gishtin e vet pikërisht në plagën e madhe, ndoshta edhe të pashërueshme, të shkakuar në shpirtin e shqiptarëve nga ai sistem dhe nga qeverisja e pushtetarëve të pashpirt, të pandershëm e të pandreqshëm.

I urtë, i butë, i sjellshëm dhe, mbi të gjitha vëzhgues i vëmendshëm dhe me atë njohje që fitoi gjatë tetë viteve që qëndroi në fshat "në gjitin e popullit", Ylljeti nuk kishte udhë tjetër veçse të mbante mend, të shkruante në rrudhat e ballit e në zemrën e tij të ndjeshme se si po zvetënohej shpirti i popullit jo vetëm në kryeqytet e në qendrat e mëdha urbane, po edhe në malësitë e largëta, se si i ngriheshin idhuj të rremë "jetës së re" e "njeriut të ri" ndërsa shembeshin përditë kisha e xhamia dhe traditat e doket e hershme e të bukura të shqiptarëve. Me "hejbetë" plot me përjetime e përvoja të hidhura, ai do të kthehej në kryeqytet dhe do të priste kohën e përshtatshme që të nxirte së andejmi temat e romaneve të tij, duke nisur me "Parullat në gurë" (2007) e duke vazhduar me "Rrëfim me ndërkombëtarë" (2000 e ribotim 2006) e për ta përthekuar madhërisht me "Metamorfoza e një kryeqyteti" (2019) që del (ndoshta dhe enkas) si homonim me veprën e Franc Kafkës dhe u jep lexuesve paraqitjen e jetës së kryeqytetit shqiptar (dhe më gjerë të krejt jetës së shqiptarëve në harkun kohor të dy sistemeve (të socializmit dhe të "demokracisë") një aso paraqitjesh që e kanë lexuar vetëm në libra rënqethës si "Arkipelagu Gulak" i Boris Pasternakut; kurse brenda hapësirave shqiptare, ky roman mund të krahasohet me filmin "Vdekja e kalit" të regjisorit Sajmir Kumbaro dhe me veprat më të mira të letërsisë bashkëkohore me tematikë të ngjashme.

Nuk më takon mua të jap cilësimin për vlerat letrare e artistike të romaneve të këtij prozatori, sepse ajo u takon kritikëve e studiuesve të letërisë dhe, në fakt, sikundër del edhe nga çmimet, mirënjohjet dhe nga shkrimet e botura në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaja, proza e Ylljet Aliçkës është nga më meritoret në letërsinë e sotme shqiptare. Prandaj, më mirë, duke kujtuar thënien e urtë "Këpucar, mos shko përtej këpucëve!", le të ndalemi te vlerat gjuhësore, duke ravijëzuar disa prurje e prije ligjërimore e stilistike që nden proza e Ylljet Aliçkës dhe që, pa synuar të bëjmë një analizë shteruese, mund të cilësohen si të atilla që e karakterizojnë stilin mjaft origjinal të këtij krijuesi, pa dyshim nga më meritoret në letërsinë e sotme.

**1. Fjala i rrjedh si një lum i gjerë.** Nga leximi i romaneve të Ylljet Aliçkës lexuesit



i bie në sy rrëfimi i shtruar, i thjeshtë dhe i matur, që rrjedh i denjtë si lumenjtë në pjesën fushore, pa dallgëzime e pa zhurmim, pa rropamë. Proza e Ylljetit është e tipologjisë “fiction”, por mbështetet gjerë në fakte e prurje të kohës, të dokumentuara e të ditura nga kushdo që e ka përjetuar atë periudhë të jetës shqiptare, por ai ka zotësinë që rrëfimin e bën të atillë që ka në shtrat ironinë dhe paraqitjen satirizuese. Shkrimtari ynë na shfaqet si një “protokolist” i palodhshëm i shoqërisë shqiptare në një hark kohor që përfshin më se gjashtëdhjetë vjet të jetës sonë, tregon dhe fakton, duke u mbështetur në radhë të parë në përvojën e vet apo, sikundër e ka pohuar në një intervistë të “Refleksion”, mbi 80 për qind të atyre që tregon në romanet e tij i ka të jetuara, janë pjesë e jetës së tij e kanë, pra, karakter autobiografik. Kjo i jep prozës së tij jo vetëm vërtetësi, po edhe e bën të jetë një dokumentim i një periudhe që, po të mos fiksohej në vepra kësojore, edhe mund të harrohej dhe të dukej e pabesueshme. Dhe, gjithandej, me një zotësi të madhe, tekstin e romaneve të tij e shoqëron një nëntekst i këndshëm me një theksim ironik, që shkon bukurazi deri në satirë e sarkazëm therëse, që të bën të qeshësh. Natyrisht është ajo një e qeshur edhe therëse, djegëse e që ka një shtrat të qartë shërues. Krejt ashtu si barnat (ilaçet) e mira: janë të hidhura kur i pi, por me atë hidhërim e përmbajtje që kanë, e shërojnë sëmundjen, e shpëtojnë të sëmurin.

**2. Ligjërimi i personazheve dhe ngjyresa e mjedisit dhe e kohës.** Gjuha e vetë autorit është e thjeshtë, e rrjedhshme, e pasur por pa tepri figurash e pa stërzgjatje, po edhe ligjërimi i personazheve është po ashtu i pangarkur me fjalë e terma të rrallë, dialogu jepet i natyrshëm dhe pa e tepruar “me kripë e piper” krahinorist a vendorist e profesional. Gjithmonë autori synon të japë aq ngjyresa e përftesa stilistike sa duhet, pa tepri dhe në një ngërthim sintaksor e stilistikor që, mbi bazën e ironisë e të satirës, të bën t’i mbash duart në ije që të mos vdesësh së qeshuri. Unë vetë, një mbrëmje, teksa po nënvizoja fjalë e mënyra të thëni nga “Metamorfoza” e mora në telefon Ylljetin dhe i thashë se kaq bukur i ka përmbledhur e përfshirë në rrëfim parullat e kohës, sa që jam shkrië së qeshuri apo, sikundër thonë në anët e Mbishkodrës, gati kam pas dekë prej gazit”.

Natyrisht, për brezin e lexuesve të moshës së tretë, që janë versnikë me personazhet e ngjarjet e romaneve e skenarëve të filmave të Ylljetit, të qeshurit është i hidhur, i zyrtë apo, si do të thuhej me një frazeologjizëm të arbërishtes “qeshin si delja në hedh”, kurse për brezin e ri, po të mos ishte pjesa e dytë e “Metamorfoza e një kryeqyteti”, ato që rrëfen, përshkruan e sjell autori do të dukeshin të pabesueshme. Pjesa e dytë, gjithashtu, është e atillë që të vë në mendime, ka një nëntekst të fuqishëm e kushtimues dhe që, për fat të keq të shqiptarëve e të shqiptarisë, ka si nëntekst fjalën e urtë franceze “histoire se repet” (histora përsëritet).

Autori shkon me “kutin” e traditës më të hershme e më të mirë të krijuesit që thuhet në maksimën latine “con granis aris” (duke shoshitur e situr).

Si të gjithë njerëzit e urtë e të ditur, Ylljet Aliçka, edhe mbasi do të kthehej në kryeqytet, edhe mbasi t’i shndriste ylli i suksesit me botime të pëlqyeshme e të vlerësuarra me çmime, edhe mbas emërimit në detyra të rëndësishme si diplomat e deri në shkallën më të epërme diplomatike të ambasadorit, ka mbetur po ai burri i urtë, i qetë e i shkueshëm dhe i dashur me miqtë, i buzëqeshur e dashamirë më këdo.

Lexues të nderuar! E tillë, e qetë, e shtruar, e natyrshme dhe pa asnjë përpallje e rropamë vjen edhe gjuha e romaneve të Ylljet Aliçkës.

**3. Disa shembuj ilustrues.** Një nga cilësitë më të vlerësueshme të prozës së shkrimtarit Ylljet Aliçka është ngjyresa e kohës, nëpërmje mënyrave të të thënit dhe parullave e ligjërimuit të personazheve, duke pasqyruar natyrshëm, gjymtimet dhe shtampëzimet që kishte pësuar prej trysnisë ideologjike të kohës. Ja disa prej tyre, të cilat

nuk kanë nëvojë për komente.

“Frymë e theksuar dshfatiste, që jo vetëm nuk lë hapësirë për shndërrimin e dhembjes në forcë, por ngjall njëkohësisht ndjenja të theksuara ligështimi.”

“I përqendruar te puna e lodhshme, qëllonte që ai të pikaste në gishtërinjtë e armiqve ndonjë unazë të punuar me shije të hollë. Në kësi rastesh, ai u thyente gishtërinjtë armiqve për t’u marrë unazën e për t’ia dhënë më pas gruas së vet e cila, në shenjë respekti për të shoqin, e ruante dhuratën si kujtim të ndier.”

“I lutem Partisë që me shpatën e saj të mprehtë të presë nga rrënjët pjesën e keqe të jetës sime dhe të më konsiderojë si ish-birin që ka gabuar rëndë, në mënyrë që të vete në varr jo si armik i Partisë e popullit, por si qytetar i thjeshtë patriot.”

“Të nesërmen u zgjua nga të qarat e çiliminjve në çerdhen ngjitur me derën e tij. Lau sytë me currilin e paktë të një ibriku para derës së çerdhes dhe pasi hëngri pjesën e ushqimit të mbetur nga mbrëmja, u paraqit te zyrtar e Këshillit, ku i caktuan vendin e punës: stalla e lopëve, atje ku do të mbulonte detyrat e ushqimit të lopëve, leximin e shtypit dhe pastrimin e stallës.”

“Leterisë i ka mjaftuar përfundimi i një shkolle të mesme për t’u punësuar shefe kuadri në ndërmarrjen e rrobaqepësisë, ku vigjilonte ruajtjen pastër të vijës së Partisë, sa herë zbulonte ndonjë punëtorë që sabotonte shtetin duke qepur shtrembër kostumet e dokut apo duke mbajtur fundin pak mbi gju. Leteria acarohet edhe kur nuhaste ndonjë vajzë që bënte dashuri para martese. Në kësi rastesh, ajo merrte masa të ashpra ndaj “fatkeqes, së cilës i kishte marrë koka erë”. Por, po u zëmë besë punëtorëve të rrobaqepësisë, ajo është, si të thuash, një shefe kuadri shushkë.”

“Erdhi një kohë kur një pjesë e mirë e shqiptarëve u bindën se në demokraci paratë mund të fitohen edhe pa punuar, thjesht duke i futur ato nëpër fondacionet piramidale që kishin nisur të shfaqeshin në vend, falë disa kapterëve largpamës në fushën e biznesit.

Por, sapo njerëzit kishin futur gjithë ç’kishin, duke shitur edhe shtëpitë, rastisi që skemat piramidale u shembën, duke marrë me vete edhe ato që qeveria e kohës i cilësoi si kursimet e ndershme të shqiptarëve. Si pasojë, në vend pllakosi kriza e tmerrshme e vitit 1997 që u shpalosi shqiptarëve mundësi të pafundme për t’u vrrarë e kacafytur me njëri-tjetrin.

Ndodhka, pra, që një vend mund të mbetet edhe pa polici, pa ushtri, pa qeveri, pa gjykata, pa burgje; me sa duket, historia njerëzore nuk është e huaj ndaj këtyre të papriturave.”

“Andrean, e takova para nja një viti. Ra biseda për librat, e di si më tha: “Eh, librat, tani i kemi sa të plasim, i shkelim me këmbë e s’i lexojmë. Le që, kush çan kokën sot. Qoftexhiu i lagjes sime i mbështjell qoftet me fjet e holla të Biblës, kurse me faqet e Uliksit të Xhojsit bëjnë kaush për të shitur caracë e hide. Jo, or mik, jo, kush ua ka ngenë librave sot.”

Në variantin më të gjerë, që do të botohet në faqet e librit tim “Kundërime për ligjërimin artistik të disa shkrimtarëve të sotëm”), natyrisht, do të jepen edhe disa shembuj te tjerë, duke përzgjedhur nga një ose dy fraza të tilla prej librave të tjerë: “Parullat në gurë”, “Valci i lumturisë” dhe, nga ndonjë prej skenarëve të filmave dhe nga drama “Luda”.

Iuroj autorit frymëzim e vlagë pune dhe për vepra të tjera në prozë e në dramë dhe skenarë filmash, si dhe, sikundër e shpreha më lart, do të gëzohesha shumë nëse ndonjë nga filologët e rinj do të ndërmernte një studim monografik të plotë për prurjet leksikore e frazeologjike dhe përgjithësisht për gjuhën e stilin e shkrimtarit Ylljet Aliçka, duke jetësuar kështu porosinë e vyer e të pavidrë të Dritëro Agollit, i cili me të drejtë kërkonte që “në faqet e shtypit letrar dhe të shtypit profesional të gjuhësisë, të ketë artikuj studimorë për evoluimin e gjuhës artistike në prozën tonë të viteve të fundit, në romanin, novelën, tregimin.”

Tiranë, dhjetor 2022-shkurt 2023

# YLLJET ALIÇKA NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT NË KAJRO

Për herë të parë Shqipëria merr pjesë në Panairin Ndërkombëtar të librit në Kajro, i dyti në botë për nga madhësia, si dhe takime me Presidentin e Panairit në lidhje me bashkëpunimin mes dy panaireve, Tiranë-Kajro. Njëkohësisht u organizuan disa takime e biseda për letërsinë shqipe me Presidentin e International Cairo Book Fair, Dr Ahmed Bahi Aldin Alassasy. Në prezantimin e letërsisë shqipe mori pjesë një prej shkrimtarëve më të njohur të botes arabe, Ahmed Mourad.



# AMELIA ROSSELLI

## TËRË BOTË ËSHTË E VE

*Përgatiti dhe përktheu Arben Dedja*

Poetja trigjuhëshe Amelia Rosselli lindi në Paris më 1930 dhe vrau veten (u hodh nga dritarja) më 11 shkurt 1996 në Romë. Sylvia Plath, që bashkë me Emily Dickinson-in ishte poetja që Amelia deshi më shumë (të dyja i përktheu gjerësisht), kishte vrarë veten edhe ajo më 11 shkurt (1963). Amelia ishte vajza e një kuejkëre angleze dhe e Carlo Rosselli-it, hebre italian antifashist që, bashkë me të vëllain Nello, themeloi në Paris lëvizjen “Giustizia e Libertà”. Amelia fliste italisht me prindërit, anglisht me kujdestaret, teksa në shkollë përdorte frëngjishten. Por idili i jetës së saj u fik më 9 qershor 1937, kur vëllezërit Roselli u vranë pabesisht në një pritë të organizatës parafashiste franceze Cagoule (e financuar nga qeveria italiane). Gjyshja heroike Amelia Pincherle Moravia (halla e Alberto Moravia-s; poetja kishte, pra, emrin e të gjyshes) mbledhi rreth vetes dy nuset dhe shtatë jetimët e vegjël dhe mori atëbotë në dorë frenat e familjes. Ngaqë nuk ndiheshin të sigurt as në Francë, familja e zgjeruar emigroi sërish: Zvicër, Angli dhe, në fund, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas lufte Amelia Rosselli u kthye në Europë. Në Itali shkante vetëm për pushime, ndërkohë që studionte në Londër kompozim dhe organo. Vetëm kur më 1949 i vdiq e ëma vendosi të jetojë në Itali, Romë. Filluan t'i shfaqen çrregullimet e para mendore (kujtonte se ishte Beethoven-i). I përcaktuan edhe diagnozën: “skizofreni paranoide”; John-i, vëllai i madh, u emërua tutor. Gjatë gjithë jetës iu desh të shtrohej vazhdimisht në psikiatri (në Kreuzlingen, Romë, Londër...) dhe t'i nënshtrohej terapive të ashpra të kohës: elektroshokut, shokut insulinit, terapisë së gjumit etj. Kushëriri i saj Alberto Moravia e prezantoi në botën e letrave, por salloneve

të borgezisë romane Amelia ndihej keq. Jetoj ca kohë në Paris, ku studioi muzikën e Béla Bartók-ut. Poeti Rocco Scotellaro e njohu me Jugun e Italisë dhe, saje atij, Amelia iu përkushtua etnomuzikologjisë. Nisi të shkruajë poezitë e para herë në frëngjisht, herë në italisht e herë në anglisht (fillimisht në anglisht). Këto të fundit u përmbledhën shumë vite më vonë në vëllimin “Sleep” (1992). Temat kryesore ishin dy: dashuria si dëshirë dhe raporti me zotin, të dyja në sfondin e një tëhuajëzimi të skajshëm. Gjithashtu filloi të botojë artikuj mbi muzikën, duke filluar me “La serie degli armonici” (studimet muzikologjike iu përmbledhën vetëm pas vdekjes, më 2004, në librin “Una scrittura plurale”). Ndërkohë që shtrohej në klinika psikiatrike projekttoi një organo që t'i lejonte thellimin e studimeve në teorinë e dodekafonisë aplikuar në muzikën popullore, si edhe një makinë shkrimi që të hidhte në letër fjalë e nota bashkë. U lidh ngushtë me avantgardën muzikore europiane të viteve gjashtëdhjetë, kurse debutimi poetik në italisht erdhi vetëm më 1963 në revistën “Menabò” të Elio Vittorini-t: njëzet e katër poezi, shoqëruar nga një introduktë e Pasolini-t. Vitin pasardhës doli libri i saj i parë poetik “Variazioni belliche” (1964), një nga librat më të rëndësishëm të krejt poezisë moderniste italiane të shekullit XX. Aty magma gjuhësore e poetes bën që fjalët të shkrihen, të shpiken nga hiçi apo thjesht të përdoren fjalë arkaike ose të shtrembëruara nga ajo vetë. Duket sikur gjithë traumat e konfliktit të fundit botëror i përshkojnë tragjikisht ato vargje.

Në vijim panë dritën e botimit përmbledhje të tjera poetike, ndër to më të rëndësishmet dhe risoret janë:

“Serie ospedaliera” (1969), dhe “Documento” (1976). “Serie ospedaliera” është libri i shtrimeve në spital, i shtrimeve biografike, por edhe atyre gjuhësore e letrare, libri i një uni lirik krejt të izoluar. Kurse “Documento” lind si një libër këngësh dashurore, njëfarë parodie e tingëllimës petrarkiane. Në vitet nëntëdhjetë boton “Diario ottuso”, libri i saj i vetëm në prozë (përveç studimeve), një prozë tejet e zymtë dhe eksperimentale. Mania e persekutimit e ndoqi tërë jetën (në fund të viteve tetëdhjetë, për shembull, i kërkoi stehim politik Gorbaçovit), deri atë 11 shkurt fatal të vitit 1996.

### [Fui, volai, caddi tremante nelle]

Qeshë, fluturova, fërgëlluese rashë në krahët e Zotit, dhe kjo ofshamë e fundme qoftë tërë qenia ime, dallga e shtyftë, ngërthyer në lidhje të vështirë, gjakun tim, dhe nga kjo rrenë e epërme vdekja e bërë ngjyrë këna të më jepet, dhe unë që nga grindjet ngashëryese të shokëve shqisja ankthin për të vdekur do të gëzoj, tekefundit, – shekullin e arsyes; dhe tërë lulet e bardha të rivierës, dhe tërë pesha e Zotit trokitshin burgjeve të mia.

### [Perché io non voli, purché tu non]

Që të mos fluturoj, mjaft ti të mos biesh, mjaft që drita të bëhet tërë një univers, fjetsha, në lamtumirën e gunduar. Dhe petku yt hokatar prej Dhëndri të mbështjelltë, qoftë si për Shenjtët e Vetmja Darkë, ofshama jote pa somniferë. S'ka dritë pa lavdi, dhe s'ka skëterrë pa përgojim. Horizonti shterp është lojë hijesh: mos e ndiq, mos hidh gurin në ujë, – gjithçka u bëftë vetiu, dhe në heshtjen që jep grahamën.

### Sleep

lehtësisht e pështirosur çdo të qare rashë në gjumë harraq, oh virgjinitat njomëzake të rrezikshme majë mali përgojnë një gjumë jo imi ngaqë shtrati rrezatues i tokës më mbulonte si myshk. Jam i mbaruar thërriste peshkshiti dhe mbronte kështu natyrën e tij të vërtetë. Jam burri harraq majë peme briti kryeduka qejfin pushkë që pat fjetur me hyjni. Jam britma nëpër natë klithi autori tek i ra libri. Dielli fjeti në një dush resh si pikë dielli, toka e qarkoi. Çdo e qarë është një masakër kur gjumi është virgjina; arsyeja humbi kur çdo padurim u mospërfill.



Banaliteti i mbarë eprorëve është me rrezik për mysafirin. Leshelitë e jetës së oborrit janë rreziku. Unë jam rreziku i një masakre oborri, klithi virgjina majë peme teksa pema ra, roitur kalbëzim. Gjumi zbriti, arsyeja shkoi, mysafirit iu kujtua që kish harruar pushtetin dhe lavdinë.

(Nga "Sleep. Poesie in inglese", 1992)

[Tutto il mondo è vedovo se è vero  
che tu cammini ancora]

Tërë bota është e ve nëse vërtet ti ec ende tërë bota është e ve nëse është e vërtetë! Tërë bota është e vërtetë nëse vërtet ti ec ende, tërë bota është e ve nëse ti s'vdes! Tërë bota është imja nëse vërtet ti s'je gjallë por veç fener je për këto sy syllë. E verbër mbeta nga lindja jote dhe pesha e ditës së re s'është veçse nata e largesës sate. E verbër jam që ti t'ecke ende! e verbër jam që ti ec e bota është e ve e bota është e verbër se ti ec ende i ngecur në sytë e mi hyjnorë.

(Nga "Variazioni belliche", 1964)

[Propongo un incontro col teschio,]

Propozoj takim me rrashtën,  
sfidë rrashtës  
ruaj të patundur të qëndrueshme  
strukur besës së pamundshme  
sedrën  
e shtazëve.

Përdita e ekzistencës së saj të pashpjegueshme  
fjalë t'heshtura në rresht.

[I fiori vengono in dono e poi  
si dilatano]

Lulet vijnë dhuratë dhe pastaj bymehen  
një mbikqyrje e thekshme i heshton  
kurrë mos lodhesh dhuratash.

Dhëmb i shkukur është bota  
mos pyetmëni përse  
sot qenkam kaq e kaq vjeç  
shiu është steril.

Synuar kah tharmet rrënoja  
lidhja e venitur ishe që kërkoja  
t'i vjedhësh zemrën tjetrit për t'ia përdorur pastaj.

Shpresa është dëm ndoshta përfundimtar  
monedhat vrazhdë tringëllojnë mbi mermer  
të dorës.

E bindja përbindëshin të veçohej  
në dhomat e fshira të një bujtine imagjinare  
gjendeshin pyjesh nepërka t'balsamosura.

U grimova priftëreshë e poezisë  
por isha e vdekur për jetën  
rropullitë që humbasin  
në një rrokopujë  
vdes i përllarë fare nga shkenca.

E ngadalshme hollake është bota:  
ca elefantë vërdallen, topitur.

(Nga "Documento", 1976)

## DY TREGIME NGA NEVIANA SHEHI

### KËNGË ME CICËRIMA ZOGJSH

Tek qëndroj në dhomën time, ia ndiej frymëmarrjen dhe klorofilin që lëviz nëpër tërë trupin tim. Është një ndjenjë magjike. Në fakt, shtëpia ku unë jetoj dhe pylli kanë të njëjtën mushkëri dhe të njëjtat rrënjë... Sa herë që qëndroj në dritare shoh dru prej ere, degë prej fëshfërime dhe ketra që rrisin veten, duke ecur drejt majave të druve dhe që duken se qëndrojnë varur në kaltërsinë e qiellit.

Diçka më pëshpërit: të shumta janë rrezet e dashuruara dhe fëshfërimat e gjetheve...

Ka kohë që kam nisur ta pikturoj portretin e tij dhe nuk arrij ta përfundoj asnjëherë. Po pra, nuk arrij ta vë pikën e fundit. Jam e bindur se kjo ndodh, sepse dashuritë e mëdha gjithmonë tronditin. Ndonëse ai akoma nuk ka ardhur (e dashuritë e mëdha gjithmonë tronditin), unë i shkrova mirëseardhjen mbi krahët e bletëve dhe bëra një këngë me cicërima zogjsh, sepse akoma mendoj se ardhjet e tilla kthehen në festa.

Rruga nëpër të cilin do të duhet të kalojë ai, ndoshta mund të mbulohet edhe me shi mjalti, mbase gjithçka është e mundur. Nëse asgjë tjetër, atëherë asaj rruge (magjitë gjithmonë janë të mundshme) do të dëgjohet gurgullimë përroi, mbushur me gurë dhe shkumë. Mjafton ta duash, ta shikosh dhe ai të del përpara për ta shuar etjen.

O Zot, prapë dikush më pëshpërit: preke, e ke kaq afër. Dy - tri hapa përtej dëshirës tënde, aty ku do ta ndjesh një kërcim dreri, ku papritmas të paraqiten drutë prej ere dhe përjetësia prej uji...

Shtëpia dhe pylli nuk jetojnë pa njëri tjetrin. Unë rri në dhomën time dhe pres të hapet dera e të vijë ai që kalon nëpër rrugën e mbuluar me gjethet që vallëzojnë sa herë që ndjej frymën e atij, portretin e të cilit akoma nuk e kam përfunduar...

### PËRJETËSISHT FËMIJË..!

Gishta i përrallës së vjetër që gjithmonë m'i përkujton netët e dimrit të gjatë, por edhe gjyshen që na mbante pranë, është vizitori im i përnatshëm. Gjen një të çarë në dritaren e fëmijërisë sime dhe hyn brenda meje për t'u argëtuar me lodrat dhe rrengjet e tij të panumërt. Edhe pse ka kaluar gati një shekull nga lindja e tij, çuditërisht ai s'është rritur. Ka mbetur i njëjti. I vogël sa një gisht dhe asnjë milimetër më shumë (me gjithë kapelën me maje prej harrakati).

Të gjithë vogëlushët rriten, them në vete, vetëm ky djalë mbeti i vogël, si në ditën e parë të krijimit. Ç'inat mund të ketë pasur krijuesi me këtë vogëlush të pafajshëm, vallë, dhe pse gjithë ky ndëshkim?

Pas pak kujtohem që krijuesi i tij nuk është ai që njohim të gjithë, që rri në qiell dhe na ka krijuar të gjithëve, mua, ty dhe të tjerët, por dikush tjetër, një njeri i zakonshëm, me trup dhe fytyrë si kjo jona, një përrallëtar.

Një vrull inati më hipën në çast dhe me zor e mbaj veten. Më vjen t'i përvishem me fjalë përrallëtarit krijues, por ca zëra të beftë më fryjnë në vesh, për të më qetësuar.

-Po sikur Gishta të jetë i dashuruar përjetësisht në fëmijërinë e tij çapkëne dhe të mos ketë pranuar vetë të rritet!?

Po, ne të gjithë kemi mall për fëmijërinë tonë të bukur, pëshpëriti zëri. Vetëm Gishton nuk e mundon kjo gjë, sepse ai përjetësisht është një fëmijë...



## Ato të Diela Dimri

Edhe të dielave im atë ngrihej herët,  
Vishej në terrin blu, në të ftohtë,  
Pastaj me duart e çara që i dhimbnin  
Nga puna e përditshme dhe moti ai ndizte  
Zjarrin brambullues. Kërkush nuk ja diti.

I zgjuar mbaja vesh si thërmohej ftoma, se si  
thyhej...  
Kur dhomat ngroheshin, ai më bënte zë,  
At'herë unë ngrihesha ngadalë, vishja rrobat  
Tërë frikë nga inatet kronike të shtëpisë.

I flisja fare ftohtë atij që jo vetëm  
kish përzënë të ftohtit  
Por edhe kish lustruar këpucët e mia të mira  
Çfarë dija unë, çfarë dija unë?  
Nga zyrat pa dekor e plot vetmi të dashurisë.

## O Dedalus, Fluturo Drejt Shtëpisë

Përhapin aromë pishat e Xhorxhias,  
Trumpeta lëkure, banxho jubilesh,  
Matildë e bukur kërce me mua.

Nata është xhuba, nata është Kongo,  
Matildë e bukur, kërce me mua.

Nata, një shaman Afrikan,  
Mpleks një dëshirë me një ankth,  
Të endë dy flatra.

Oh fluturo për shtëpi, fluturo.

A e kujton Afrikën?

Oh çaje ajrin dhe fluturo!

Unë ja njoh gjithë yjet Afrikës.

Hap flatrat e mia dhe çaj në erë.

Im gjysh fluturoi për në Afrike  
Thjesht hapi krahët dhe iku drejt shtëpisë.

Nata po bie mbi pishat në erë,  
Nata, një e qeshur, nata, një dëshirë.

## Zambakët e Ujit nga Moneti

Teksa lajmet e fundit nga Selma dhe Saigoni  
Helmojnë sot ajrin si pluhur radioaktiv,  
Unë vij sërish ta shoh  
Kryeveprën serene, tablonë që dua.  
Këtu hapsira dhe koha egzistojnë si dritë  
Syri, si syri i të devotshmit, beson.  
E ndeshura më parë, e njohura  
Ndron ngjyrë nga kënd' i vështimit, bëhet  
Ind iluziv i dritës  
që nuk ishte, ishte, përherë do të jetë.

O dritë që vjen si e përthyer lotëve  
Ti na fal breroren e një bote  
që kushdo e ka humbur së paku njëherë  
Hijen e haresë së saj sjell këtu.

## Frederik Dagllas

Kur bëhet më në fund e jona, kjo liri, ky çlirim,  
kjo bukuri  
e llahtarshme, jetike për njeriun si ajri,  
e dobishme si toka; kur ju përket, më në fund, të  
gjithëve,  
kur është vërtet instikt; punë për mendjen, venë  
dhe aortë,  
akt reflektiv; kur më në fund fitohet; kur është  
më shumë  
se sa lustër fjalimesh nga politikanë fanfarash; ky  
burrë,

## ROBERT HAYDEN

O Dedalus, Fluturo  
Drejt Shtëpisë

Përktheu nga anglishtja Gëzim Basha

Lirika e Robert Hajden (1930-1980) reflekton jetën e Afrikano Amerikaneve si eksperiencë njerëzore, pa etnocentrizëm. Mjeshtër i madh i teknikave formale, Hayden shquhet veçanrisht për poezinë me shumë zëra duke bërë kombinuar historiken me personalen. Në vitin 1976 u përzgjodh Poet Laureat i SHBA-së.



ky Dagllas, ky ish-skllav, ky Negro  
i rrahur në gjunjë, i përzënë, me vizionin e një bote  
ku askush nuk ndihet i vetmuar, i huaj, askush nuk  
përndiqet,  
ky burrë, superb në dashuri dhe logjikë, ky burrë  
do të mbahet mend gjatë. Oh, jo me retorikë lapi-  
darësh,  
as me legjenda, poema dhe kurora mbi bronx,  
por me jetët e shpërthyer prej jetës së tij, jetëve që  
leshonjë  
reflekset e ëndrës për atë gjënë e mrekullueshme,  
jetike.

## Rabini

Ende fëmijë e shihja përherë  
Rabinin e lagjes, të zbehtë e serioz,  
Me rrobat fetare të lutjeve  
Nxitonte për Sinagogë.

S'e di në pahitej me hi dhe a qante  
E hidhte mbi supe vallë shallin e dhirtë?  
Ai kurë nuk më la as të shihja  
Mbajtësen e artë ku digjte qirinjtë.

Mezuza, Peisak, Hanuka<sup>1</sup>  
Mësova ti them me timbër  
Shumë gjëra i kapa me sy,  
Mësova të them dhe Schuarce<sup>2</sup>.

Lumi i alkolit të blerë me kredi  
Nga Schwarcet tek Xhu Bejbi,  
Gajaste ironikët që thoshnin,  
Ky shitës do t'ja kalojë dhe Rotshildit,

Nga kjo zdërrhallje të Shtunash.  
Ndërkohe Hirshell, Molli dhe unë  
Ndanim hallvën dhe farat, luanim  
Kukamshehtas dhe Fu Mançu. .

Tani Sinagoga s' është më  
Në kishën, Kalvari i Ri, u kthye  
Rabini iku, mi mori dhe shokët  
Në bohçen e bërë me shallin e lutjeve.

## Soledad

(Dhe unë, unë nuk jam më i asaj bote)

I zhveshur ai shtrihet në dhomën grillambyllur  
Pi cigare, përkundet nga droga, nga xhazi  
Siç s'e përkundi kurrë ndonjë kurm dashurie.

Mail Deivis këndon vetëm për të  
Bluzin flamingo, O Peña negra  
Myshk i kuq, i shndritshëm zëri i Zonjës Ditë.

(Zonja e manjolave puro të zeza)  
Vajton zinë e humbjes, i lë lamtumirën  
Qan pa lot dhimbjen, gardianët e pabesë

E lanë të lirë por veç për pak kohë.  
Frikrat dhe vetja e tij e paarrirë  
E presin pa ngut në rrugë ngado.

U fsheh nga ana e errët e hënës  
Mërgoi në qelinë me xham të lyer,  
Në atdhe kristalesh pa sahate, fluturoi.

Hija e Zonjës Ditë ja di vendndodhjen. Vetëm  
Ajo, dhe vetëm muzika. Ai po kërcen  
Ah si kërcen! Matanë tani krejt i pavdekshëm.

<sup>1</sup> Fjalë hebraike

<sup>2</sup> Emër përçmues në jidish për Afrikano-amerikanët.



# KATËRDHETË E PAK

*poezi nga Viora Ademi*

Te vëllimi i Viora Ademit që keni në dorë, jo veç temat, por edhe qasjet janë të larmishme: thellime dhe përvoja jetësore, mbresëlanëse e bindëse, që karakterizojnë një ardhje të qëllimshme në poezi, si formë sintetike mendimi e shtesimi letrar. Viora Ademi ka prirjen dhe shënjestrat e sigurta kah poezia spirituale, kah përvojat e thella dhe intimiteti. Ajo ban kërkime poetike në drejtim të përcaktimit të një identiteti të thellë të gruas universalisht. I intereson së tepërmi me e rrokë qenien e vet dhe homogjeninë e saj, me ditë kush asht, kah vjen e ku shkon, cili asht misioni i saj personal në harkun e ekzistencës dhe cilat janë rrugët e realizimit optimal e maksimal të vetvetes në paqe me shoqërinë e me vetveten. Pra, temën e preferueme e ka individualizmin dhe shtigjet produktive të tij.

**Primo Shllaku**  
*Pjesë nga parathënia*

## Viora Ademi Katërdhetë e pak



OnufriPoezi

### KATËRDHETË E PAK

Tash që jam katërdhetë e pak,  
sa po i tutem patyhes.

### K'SHTU T'DUE

Sa herë  
të ndiej prej larg,  
ninulla djepi  
m'përkundin  
andrrave t'kahmotshme  
për me t'pa  
t'praruem  
me u magjepsë mbas teje  
si mbas fluturave,  
n'hap t'parë  
me shkelë fije bari t'njomë,  
me e pasë ma t'bukurin  
e ma t'bardhin zambak  
njomë me stërpikat  
e po t'bardhit lum.

Po,  
k'shtu t'due,  
t'bardhë  
t'hirshëm  
me tana rrudhat e ballit  
e kalldrëm t'shkelun  
cep m'cep  
për me t'i njohtë  
t'ligat  
t'largëtat  
t'moçmet  
mshefë rrugicash t'ngushta  
e trenëve  
randue vitesh  
që i mbartin mbi supe  
si tjegullat e daluna boje.

Po,  
k'shtu t'due,  
pështetë  
ngurë t'kalasë  
ku e kam  
n'pëllambë dore  
gjithë madhështinë tande,  
me minare e kupola  
si kurtizanë mesjete  
n'megjë tundimi  
n'mes  
t'ezanit  
e tingujsh kumbonash  
që t'lypin për vete  
në t'njajtin dakik  
për me i kalue  
lirshëm  
tana urat e gurta  
e me ju ngjitë shtegut t'thanave  
tue t'i numrue thinjat  
në kah një.

Po,  
k'shtu t'due  
me tana hiet  
e vrragët  
e shekujve  
lanë  
mbi Ty  
gjurmë lavdesh  
që nurit t'ia shtojnë hijeshinë  
sa me m'pasë zili  
secila majë mali  
që t'rrethon  
pse shputë e imja  
shejon  
aq prajshëm mbi Ty.

Po,  
k'shtu t'due,  
se shpirti pezull m'rrin  
sa herë largohem prej Teje,

dhe ditën që do t'i ngjitem  
qiellit përjetë,  
ruhin ma mbaj shpatullave  
e kryet ndërrasë pështetë  
se sikur n'shpatullën tande  
n'asnji tjetër shehër bote  
t'ngrohtit e diellit nuk e kam gjetë.

### DIMNAT E FËMINISË

Kam me t'ecë kalldrëmit t'rrugicave,  
zdashë,  
me i mbledhë do dimna t'fëminisë  
nëpër ty, që pa dashje m'bekove me ngjyrën e tyne.

Qysh atëherë e bardha më grishi për andrra ngjyrë bore.

Ia prisja errin ditës  
me i pa t'kapuna për dore hijet e akujve  
vjerrë trinës.  
M'bahej se (t'kureshtuna) edhe ato neve na i përgjonin  
hijet  
dhe gjithmonë të dielave i braktisnin çatitë.  
U fiksova mbas simetrisë së fjollave  
dhe hanimit përmbi të bardhën e borës.

Nisa me i dashtë pulëbardhat,  
zambakët,  
retë,  
kokrrat e fasules  
dhe arijtë polarë.  
Mbyllja sytë me ftyrën kah qielli  
me ua ndie t'ngrohtit kallnorëve;  
veç atyne ua besojë dëshirat (e lutjet)

Mbaj mend, shallin shpesh e hiqja qafe  
borën me të me mbulue.

Kujtoja, edhe dimnat mërdhasin.

Dikur zunë me u shkurtue,  
vinin ma vonë,  
iknin ma herët.  
Mendoja, i trishtonte rrita ime.

Tre dimna rresht pata veshë pallton e kuqe,  
veç që ende t'u dukesha e vogël.  
Kur nisi me m'pëlqye e kuqja,  
kuptova se e vogël kish mbetë veç palltoja.

Andrrat zunë me u ngjyruet ndryshe  
e unë nisa me i dashtë krahët e shqiponjës,  
drandofilat e verdhë,  
lisat në vjeshtë  
dhe brinat e kaprojeve.

Mbasandej,  
(nuk m'kujtohet mirë kur)  
nisa mos me pa andrra ma.  
Nisa me e dashtë veç ngjyrën e flokëve të tu  
Tash veç ata m'ngajnë me dimnat e fëminisë.

### KTHIMI

Dikur  
dimnit e vishja pallton  
me fjollat e borës vallzoja nëpër natë  
ndigjoja "I'm sailing..." kur udhëtoja larg  
dhe dëshirën m'e pushtue lirinë  
ia kallxoja veç arushit jeshil.  
Sot  
e kuqja m'ngjan në pafajësinë e lojave t'fëminisë  
dhe frikën e qortimit

Dhe prap kthehem për pak atje

Kthehem  
sa me u matë me besnikinë e arushit  
të bardhën e borës  
dhe ngjyrën e lirisë.

Akoma e kam të gjallë në mendje herën e parë që takova René Angélil-in, njeriun që, gradualisht, do të zinte një vend aq të rëndësishëm në karrierën, në jetën dhe në zemrën time. Ai kishte veshur këpucë ngjyrë kafe dhe një xhakëtë po ngjyrë kafe. Në qoshen e zyrës së tij, pas derës, kishte një fushë *backgammon*<sup>1</sup> dhe pranë dritares kishte një sistem zëri të madh. Por historia është treguar aq shumë herë dhe nga aq shumë njerëz saqë sot është e vështirë për René-në, mamanë, dhe mua - që e përjetova - për të kujtuar gjithçka që ndodhi në të vërtetë. Secili nga ne ka variantin e tij apo të saj në lidhje me ngjarjet dhe një vizion për vendet.

Mbaj mend se zyra ishte pak si e errët dhe e zymtë. Mbase ishte dita jashtë e tillë, sepse kishte dritare të mëdha nga dukeshin çatitë, por megjithatë shumë pak dritë hynte në zyrë. Diagonalisht, matanë rrugës, mund të shikoje një ndërtesë në formë kutie e cila ishte zyra qendrore e “Télé Métropole”, ku janë studiot televizive. Më tutje, struktura madhështore e hekurt e urës “Jacques-Cartier” dukej sikur sapo kishte mbirë në qytet. Zyra kishte një aromë të mirë, të freskët.

René-ja qëndronte pas tavolinës së tij. Ai gjithashtu dukej i zymtë. Ishte shumë i sjellshëm - “një xhentëlmen”, siç tha mamaja ime. Por ai nuk po buzëqeshte. Na tha që të uleshim por vetë qëndroi në këmbë, me kurizin nga dritarja. Kjo e bëri të vështirë të shikuarit e fytyrës së tij. Mbaj mend se dukej sikur ai po ia adresonte fjalët më shumë mamasë sesa mua. Ai tha se i kishte dëgjuar kasetat dhe mendonte se zëri im ishte shumë i bukur. Dhe atëherë, papritur, u ndjeva tmerrësisht e frikësuar.

Njeriu që po e thoshte këtë gjë për zërin tim, ishte po ai që unë e kisha parë disa herë në TV apo në gazeta. Në vitet gjashtëdhjetë, René-ja kishte qenë një yll i madh i këngës me grupin që quhej “Baronets”, e që kishte qenë versioni francez i Bitëllsave. Nuk i njihja edhe aq mirë “Baronets”, që për mua ishin një histori e kohës së lashtë, por si agjent i artistëve kebekas, René Angélil-i ishte një pjesë e së tashmes. Gruaja e tij, Anne-René, ishte gjithashtu e mirënjohur si këngëtare dhe si e ftuar e televizionit.

Më në fund, ai u ul dhe më pyeti nëse doja të këndoja për të - pikërisht aty, në zyrën e tij, pa muzikë. Edhe mamaja gjithashtu po më shikonte. Pati një heshtje që zgjati e m'u duk sa një shekull. Pastaj Maman tha: “Ajo, në të vërtetë, nuk është mësuar që të këndoje kështu, pa një mikrofon.”

René-ja më dha një stilolaps të stërmadh dhe, me një zë shumë të butë, tha: “Le të supozojmë që ky është mikrofon i yt, në rregull?”

Ai akoma nuk po buzëqeshte. Mua më ngjante si i trishtuar, por zëri i tij kishte një ëmbëlsi qetësuese, shumë i ngrohtë, shumë i butë.

“Na këndo këngën tënde, mirë? Sikur të ishe duke kënduar në ‘Place des Arts’.”

E kisha bërë këtë me qindra herë përballë pasqyrës së dhomës time të gjumit. Por aty nuk mund ta shikoja veten duke kënduar, dhe kisha kasetat si shoqëruese. Gjithashtu kisha kënduar shumë herë në konkurse amatore dhe kënde lojërash. Por asnjëherë nuk kisha kënduar në një hapësirë bosh, përballë dy njerëzve, pa muzikë, karshi një njeriu me pamje të trishtuar që pothuajse nuk e njihja fare. E dija që thjesht duhet ta bëja këtë, të filloja të këndoja. Nuk kishte zgjedhje tjetër.

U ngrita dhe qëndrova përpara derës së zyrës, për të pasur sa më shumë hapësirë që të ishte e mundur, përballë meje. Mamaja ishte kthyer për të më parë. E afrova stilolapsin te buzët dhe fillova të këndoja.

*Në një kopsht magjik humba,  
në një ditë të magjishme u zgjova.*

Krejt papritur po ndihesha shumë mirë dhe e sigurt në vetvete.

Siç duket (të paktën sipas mamasë dhe René-së), unë këndova sikur të isha vërtet në “Place des Arts”, sikur të isha duke shikuar publikun në karriget e tyre, po i shikoja ata drejt e në sy, shikoja orkestrën, platenë, lozhat. Nganjëherë madje shikoja atë, René Angélil-in. Këtë e mbaj mend mirë. Sepse në një moment pashë se ai kishte lot në sytë e tij. Atëherë i thashë vetes se e kishim fituar atë. Nuk kam parë kurrë një burrë të qajë ndërkohë që dëgjon dikë duke kënduar. Mendoj se edhe mamaja, gjithashtu, ishte vërtet e habitur.

Kur mbarova, ishte radha ime që të prisja përmes një shekulli heshtjeje. René-ja fshiui sytë. Pastaj tha, sikur ne të mos kishim parë asgjë: “Ti më bërë të qaj”.

Unë akoma nuk e njihja, por e ndjeva që kjo i shprehu të gjitha.

\*\*\*

Pasi René-ja e pranoi që kishim rënë në dashuri, ne folëm mjaft për muajt kur ishim aq të dashuruar por pa e shprehur këtë.

“E mban mend kur erdhe të më merrje në Duvernay. Dhe sa u habite kur më pe.”

1 Backgammon (angl.) - Një lojë me dy lojtarë. Luhet në një fushë të ndarë me 12 hapësira në secilën anë. Çdo lojtar ka 12 figura të cilat lëvizin sipas hedhjes së zarit.

*Fragmente nga libri me kujtime i këngëtares së famshme*

# Celine Dion

## JETA IME SI NJË ËNDËRR

*Përktheu nga anglishtja Afërdita Cesula*



“A e mban mend se çfarë momenti të bukur patëm në krahët e njëri-tjetrit në Esterel kur ti këndove me Dan Hill-in për ata të CBS-së?”

“E di që asnjëherë nuk e kam harruar atë mbrëmjen e trishtueshme në restorant, në Paris, kur ti vendose të krijoje një distancë ndërmjet nesh.”

“E di që unë asnjëherë nuk do të harroj atë sfilatën e modës që ti bërë në dhomën e zyrave të Radio Canada. Mund të përshkruaj secilin prej kostumeve që ti veshë.”

“Edhe ato që ti mendoje se ishin shumë të guximshme për televizionin?”

“S'do të harroj asnjëherë atë herë kur të zuri gjumi në supin tim, në aeroplanin me të cilin po largoheshim nga Parisi.”

“Po mua nuk më kishte zënë gjumi në supin tënd, i dashur. Unë shtiresha sikur flija.”

E kisha lënë kokën të rrëshqiste përgjatë supit të tij sepse ndihesha mirë dhe sepse po shpresoja që mundësisht ta joshja atë. Shikoja duart e tij, që më emociononin aq shumë, duart të forta me thonj që gjithnjë ishin të mbajtur me kujdes. Ai kishte një aromë të mirë, të freskët. Kisha një dëshirë të tmerrshme të merrja dorën e tij, të vendosja buzët e mia në të.

“Sikur vetëm ta kisha ditur,” më tha ai.

“Nuk do të kishe bërë asgjë. Ti e dije se unë të doja për një kohë të gjatë dhe nuk bërë asgjë.”

Ndryshe nga ai, nuk kisha pasur kurrë as hijen e dyshimit. Atë ditë, në aeroplanin me të cilin po largoheshim nga Parisi, e dija se kisha rënë në dashuri me të përgjithmonë dhe se diçka do të ndodhte shpejt a vonë. Nuk kisha eksperiencë (përveç asaj teorike) në dashuri, por isha shumë e vendosur. René-ja kishte shumë eksperiencë, por, në atë kohë,

ai veproi si një adoleshent i frikësuar, njëqind herë më shumë i trembur seç do të kishte qenë përballë një gruaje të moshës së tij. Ai kishte frikë nga ajo çfarë do të thoshin njerëzit, kishte frikë se mos më lëndonte, i frikësuar se në moshën tridhjetëvjeçare do ta gjeja veten me një burrë pesëdhjetëegjashtëvjeçar.

Por unë e dija se e kisha fituar atë. Dhe prita. Më në fund erdhi.

Ndodhi në Dublin, në atë ditën e paharrueshme të 30 prillit të vitit 1988, mbrëmjen e festivalit të Eurovizionit, në të cilin, edhe pse kanadeze franceze, unë përfaqësoja Zvicrën! Dhe këndoja një këngë të shkruar nga një italian dhe një turk.

Mamaja kishte bërë një operacion me zemër të hapur<sup>2</sup> disa javë më parë. Doja që ajo të pushonte ca. Nuk doja më që ajo të vinte me mua në turne, veçanërisht nëse përfshinte një udhëtim jashtë.

Atë ditë pasiguria ishte e pabesueshme. Deri në minutën e fundit, ne mendonim se çmimi i parë do t'i jepej interpretuesit që përfaqësonte Anglinë. Mbaj mend se kënga e tij titullohej “Shko”, numri im me fat në japonisht. Këtë e pashë si një ogur të keq. Për më tepër, nuk më pëlqente edhe aq kënga që do të interpretoja. Më dukej shumë e fryrë.

Pasi e kisha kënduar këngën, po qëndroja në prapaskenë bashkë me konkurrentët e tjerë. Po shikonim drejtorin e televizionit dhe të skenës që po u shpjegonte anglezëve të vegjël si të dilnin në skenë kur fituesi të shpallej. Dukej se ai kishte fituar. Për mua ishte shënuar që të humbja. Vetëm diçka më dukej urgjente: doja të gjeja René-në, që do të ishte ndoshta i shkatërruar. Do ta përjetonim dështimin tonë të parë së bashku. Do ta ktheja në një fitore personale. Do t'i mbaja lotët e mi dhe do ta ngushëlloja; do të kujdesesha për të.

Por juria e dy apo tre vendeve nuk i kishin shpallur zgjedhjet e tyre akoma. Në fund, fitova vetëm me një pikë diferencë.

Ndërsa shkova të merrja çmimin tim, shpërtheva në lot përpara publikut në Simmoncourt dhe qindra-miliona evropianëve që po e ndiqnin ceremoninë e çmimeve përmes televizionit. Bëra falënderimet e mia pak a shumë në mënyrë koherente dhe u largova nga skena pothuajse me vrap. Kur e gjeta René-në, u hodha në krahët e tij, akoma duke qarë, e përqafova fort dhe e putha në qafë. Isha aq e lumtur sa ç'mund të jetë e mundur.

Ai e lejoi që të ndodhte. Ai po qeshte.

Si zakonisht, u kthye në dhomë bashkë me mua dhe filloi të ritregonte ditën që kishim kaluar bashkë. Sa i frikësuar kishte qenë. Më kujtoi se sa e rëndësishme ishte kjo fitore, sepse, sipas tij, më bënte mjaft të njohur në Evropë. Të paktën për herë të njëqindtë në dy javë, ai më tha se spektakli i Eurovizionit, pas Lojërave Olimpike dhe çmimeve “Oskar”, ishte programi televiziv më i ndjekur në botë. Më foli gjithashtu për pjesëmarrësit e tjerë që kishin kënduar mirë dhe që nuk do të shkonin shumë larg. Dhe pastaj... nuk e mbaj mend se çfarë tha. Në të vërtetë, nuk po e dëgjoja. Thjesht e kisha lënë veten të përkundesha nga zëri i tij.

Isha ulur te koka e krevatit, me këmbët e mbështjella nën mbulesa. Isha e lumtur për faktin që isha vetëm me burrin që doja. Dhe kisha një plan mjaft të saktë.

E kuptova që kishte ndaluar së foluri, dhe që na mbështillte heshtja. Ai qëndronte aty, i ulur në mbështetësen e karriges, shumë afër krevatit tim, pa thënë asnjë fjalë. E vështrova me buzëqeshjen time të një gruaje të pjekur. Mendoj se në atë çast ai e kuptoi që nuk kisha qenë duke e dëgjuar që prej njëfarë kohe dhe se po mendoja për gjëra të tjera. Ai uli sytë. Mund ta ndieja se e kisha prekur emocionalisht. Drejt e në zemrën e tij. Ai u ngrit, bëri drejt derës dy apo tre hapa, sikur t'i shpëtonte ndikimit tim mbi të, dhe më uroi natën e mirë.

Nuk mund ta lija të ikte ashtu.

Çdo natë, që nga turneu ynë i parë tre vjet të shkuara, ai më kishte uruar natën e mirë duke më puthur në të dyja faqet. Për disa muaj, veçanërisht gjatë turneut “Incognito”, kisha përshtypjen se puthjet e tij çdo ditë rrëshqisnin disa milimetra më afër buzëve të mia, derisa nganjëherë gojët tona preknin njëra-tjetrën.

Dhe në këtë natë lavdie dhe fitoreje, ai ishte gati të largohej pa më puthur fare!

Tashmë e kishte hapur derën. Rrëshqita nga krevati dhe eca drejt tij; u mbështeta pas tij.

“Ende s’më ke puthur, René Angélil.”

E mora kokën e tij midis duarve të mia dhe e putha në buzë. I vendosa krahët rreth qafës së tij... Ai më shtrëngoi fort, dera ishte ende e hapur pas tij. Pastaj i largoi krahët e mi. Fluturoi për në dhomën e tij. Qëndrova aty për një çast krejt e vetme, me zemrën që rrihte, e trembur dhe e shtangur.

E dija se kisha fituar. Ai fluturim ishte një pohim i kësaj.

Rrëmbeva telefonin dhe formova numrin e dhomës së tij për t'i thënë: “Nëse nuk kthehesh këtu menjëherë, do të vij të trokas në dhomën tënde.”

Por nuk pati përgjigje.

Ishte ai që më telefonoi disa minuta më vonë nga holli i



Celine Dion me René Angélil, menaxherin dhe bashkëshortin e saj

hotelit, për të më pyetur nëse isha mirë. Pastaj më tha: “Nëse ti vërtet do, unë do të jem i pari.”

Dhe unë iu përgjigja: “Ti do të jesh i pari. Dhe i vetmi.”

\*\*\*

Dy ditë më pas, kur arritëm në aeroportin “Mirabel”, jashtë Montrealit, u përshëndetëm nga turma gazetarësh, fotografësh, kameramanësh dhe njerëz të tjerë të industrisë muzikore. René-ja u kishte sjellë gazetat angleze dhe irlandeze, dhe ua lexoi. U tregoi fotot time dhe titujt e artikujve. Pastaj u kujtoi gazetarëve sa i rëndësishëm ishte Eurovizioni, edhe pse ishte vështirë që ndokush të dinte për të në Kanada.

Nuk mund të rezistonte pa u thënë se sa kisha qarë unë. Të gjithë qeshën kur ai u kujtoi se sa kohë e gjatë kishte kaluar që unë nuk kisha qarë në mënyrë të tillë.

U tregoi çdo detaj të konferencës për shtyp që kishte ndjekur konkurrimin dhe se sa e jashtëzakonshme mendonte ai se kisha qenë. Ai gjithashtu tha se të gjithë gazetarët nga e gjithë bota - “gjashtëqind apo shtatëqind”, deklaroi ai, që mua m'u duk ca e ekzagjeruar - u habitën kur mësuam se unë isha më e vogla e katërmëdhjetë fëmijëve nga një vend kënetor që quhej Charlemagne.

“Më pas”, vazhdoi René-ja, “i kërkonin autografe kudo - në hotel, në aeroportin e Dublinit, në aeroplanin me të cilin u larguam nga Londra. Piloti madje lajmëroi se ajo ishte në bord dhe të gjithë duartrokitën.”

Gazetarët u magjepsën nga të gjitha këto, por për mua lajmi më i madh - që më jepte kënaqësinë më të madhe - ishte se ne kishim rënë në dashuri. Unë llamburitja dhe jam e sigurt se të gjithë ata mendonin se shkaku ishte suksesi në Dublin. Kjo në fakt kishte të bënte shumë pak.

René-ja u kujtoi gazetarëve se CBS-ja na kishte premtuar një incizim në gjuhën angleze, me të cilin kishim filluar të punonim në vjeshtë, pas turneut “Incognito”.

“Me drejtorin më të mirë, autorët e kompozitorët më të mirë dhe me kushtet më të mira që ju mund të imagjinoni,” tha ai. “Do t’ju lërë me gojëhapur.”

Një gazetare pyeti nëse ishim të lumtur bashkë, nëse ende shkonim mirë bashkë. Mendova se ajo kishte zbuluar gjithçka. Në të vërtetë, më vonë ajo më tha se e kishte marrë me mend. Por René-ja iu përgjigj përpara se unë të mund të përgjigjesha: “Unë nuk do të hiqja dorë për asgjë në botë,” tha ai. “Celin ndihet po ashtu, jam i sigurt. Ne ndajmë të njëjtën ëndërr, të dy.”

“Dhe të njëjtin shtrat,” u tundova të thosha.

Por nuk isha e lejuar ta bëja këtë. Një ditë më parë më kishte bindur që të mos tregoja për dashurinë tonë.

“Për sa gjatë,” e pyeta.

“Aq gjatë sa të jetë e nevojshme.”

“E nevojshme për çfarë?”

“Duhet t’ju tregojmë njerëzve tanë të afërt për këtë, të afërmve të tu në fillim.”

Kishte të drejtë, si zakonisht; ai gjithmonë mendonte për gjithçka. Vetëm se, në atë kohë, unë nuk e imagjinoja se “aq gjatë sa të jetë e nevojshme” do të ishte aq patolerueshmërisht e gjatë sa doli të ishte.

U dhashë gazetarëve përgjigjet e përshtatshme për të qenit e lumtur me shoqërinë profesionale të René-së. Për shtatë vjet, ai kishte marrë të gjitha vendimet që kishin të bënin me karrierën time. Dhe asnjëherë nuk e kishte pasur gabim.

“Kam besim të plotë tek ai.”

Por një gazetar bëri një përpjekje tjetër.

“Sapo keni mbushur njëzet, Celine. A nuk ke një të dashur? Të gjitha vajzat e moshës tënde kanë një të tillë.”

Imazhe më kaluan në kokë. E pashë veten pak më parë, duke qëndruar e mbështetur pas murit të dhomës sime pasi René-ja ishte larguar, me gjunjët që më dridheshin aq shumë sa thuajse u rrëzova. M'u kujtua tingulli i zërit të tij përpara kësaj, si në një ëndërr: “Nëse ti vërtet do, unë do të jem i pari”. Dëgjova veten të përgjigjesha, në buzë të lotëve: “Sigurisht që dua... Ti do të jesh i pari. Dhe i vetmi...”

Duke reaguar ndaj heshtjes sime, gazetari pyeti përsëri: “A ke një të dashur, Celine?”

I gëlltita ndjenjat e mia, pastaj qetësisht u përgjigja me një buzëqeshje, ndërsa René-ja po më shikonte: “Jo, nuk kam kohë për të, karriera ime është prioriteti kryesor. I kushtoj çdo gjë asaj.”

Ishte e para e serive shumë të gjata dhe shumë të dhimbshme të gënjeshtreve. Po filloja një periudhë të lumtur por sidoqoftë të trazuar të jetës sime, periudhën e lidhjes sime dashurore sekrete. Do të më sillte një lumturi të madhe; por pavarësisht suksesit profesional, burgu i gënjeshtreve ku duhej të mbyllja veten do të prishte herë pas here gjithë kënaqësinë time.

Nga ana tjetër, në familjen time gjërat u qetësuan mjaft shpejt. Unë isha, në fund të fundit, njëzet vjeç. Prindërit e mi tani e kuptuan se unë nuk do të hiqja dorë nga një dashuri që po më bënte të lumtur. Ne njihnim çifte të tjera shumë të suksesshme, si Eddy dhe Mia, me një diferencë moshe prej pesëmbëdhjetë, njëzet, madje tridhjetë vjetësh. Ishte shembulli i Charlie Chaplin-it dhe Oona O'Neill-it, që ishin të lumtur së bashku për më shumë se tridhjetë vjet. Ata kishin krijuar madje një familje të fortë dhe të bashkuar.

René-ja më tha se kur e kishte kuptuar se po binte në dashuri me mua, ai ishte përpjekur të më harronte. Ishte larguar për në Las Vegas sa herë që i ishte dhënë mundësia. Kishte shkuar në Paris dhe kishte takuar Eddy Marnay-n, të cilin gjithnjë e kishte konsideruar si një baba dhe një person tek i cili mund të kishte besim

“Ti e njeh Eddy-n. Ai dhe unë ecëm për milje të tëra përmes Parisit ndërsa i flisja për ty.”

“Çfarë të tha ai?”

“Më tha: ‘A e do me të vërtetë atë?’”

“Çfarë i the ti?”

“I thashë: ‘Çmendem për të. E shikoj atë kudo. Mendoj për të gjithë kohës.’”

“Dhe ai tha?”

“Ai tha: ‘Nëse e do, nuk ke pse të frikësohesh. Nuk mund ta lëndosh.’”

“Kjo është edhe ajo që unë të kam thënë.”

Por René-ja po mendonte gjithashtu edhe për karrierën time. Ai mendonte për të më shumë se ç'mendonte për lumturinë tonë, një ide që vërtet më shpartallonte në disa momente. Ai mendonte se në qoftë se njerëzit do të merrnin vesh që ne kishim rënë në dashuri, gjithçka që kishim ndërtuar do të shkatërrohej.

Kështu që për një kohë të gjatë e dashuruam njëri-tjetrin vetëm në fshehtësinë dhe intimitetin e familjeve tona. Mendoj se ata u mësuam me këtë mjaft mirë. Por jo unë. Vuajta dhe vajtova, mbase sepse isha më e vogla. Dhe gjithashtu sepse ishte dashuria ime e parë. Doja që të thërrisja për këtë nga majat e çative që ditën e parë. Të dashurohesha nga René Angélil-i ishte më e bukur se çdo gjë tjetër që kisha provuar në jetën time. Për shkak të dashurisë, në të vërtetë, sepse ai ma kishte kërkuar këtë - për ta kënaqur atë - unë rashë dakord që të heshtja. Vetëm se ishte për një kohë mjaft të gjatë.

2 Open-heart surgery (angl.) - Një operacion në zemër, gjatë të cilit gjaku qarkullohet nga një aparat mekanik.

# JEROEN OLYSLAEGERS



# UILLI

Ky roman të vendos para  
një dileme egzistenciale; kush prej nesh  
do të rrezikonte jetën për një person tjetër,  
apo për hir të parimeve..!

— *The Guardian*

## ROMAN

OMBRA GVG  
di Isgras

